

**DOKUMENT I BANKËS EUROPIANE  
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**

**STRATEGJIA PËR SHQIPËRINË**

**2009-2012**

**E miratuar nga Bordi i Drejtorëve, më 17 nëntor 2009**

## Tryeza e Lëndës

1. PORTOFOLI I BANKËS .....	10
1.1 Pamje e përgjithshme e veprimtarive të deritanishme .....	10
1.2 Zbatimi i Strategjisë së Bankës së fundit .....	11
1.3 Efekti i tranzicionit dhe mësimet e nxjerra prej tij .....	13
1.3.1 Sektori i Ndërmarrjeve .....	14
1.3.2 Sektori Financiar .....	16
1.3.3 Infrastruktura .....	17
1.3.4 Bashkëpunimi Teknik .....	18
1.4 Raporti dhe cilësia e portofolit .....	19
2. MJEDISI I PUNËS .....	19
2.1 Mjedisi i përgjithshëm i reformave .....	19
2.1.1 Zhvillimet politike .....	19
2.1.2 Mjedisi i biznesit .....	20
2.1.3 Çështjet sociale dhe të punës .....	20
2.1.4 Çështjet mjedisore .....	21
2.1.5 Mjedisi Ligjor .....	22
2.2 Ecuria në fushën e tranzicionit dhe reagimi i ekonomisë .....	23
2.2.1 Kushtet Makroekonomike që lidhen me operacionet e Bankës .....	23
2.2.2 Sukseset dhe sfidat e tranzicionit .....	24
2.3 Mundësia e marrjes së kapitalit .....	28
3. ORIENTIMET STRATEGJIKE .....	29
3.1 Prioritetet e Bankës për peridhën e mbuluar nga strategjia .....	29
3.2 Sfidat sektorale dhe objektivat e Bankës .....	30
3.2.1 Infrastruktura dhe energjitika .....	30
3.2.2 Sektori i Ndërmarrjeve .....	32
3.2.3 Sektori Financiar .....	33
3.2.4 Dialogu për Politikat .....	35
4. BASHKËPUNIMI ME DONATORËT DHE IFN TË TJERA .....	35
ANEKSI 1 - Vlerësimi Politik .....	38
ANNEX 2 – Vlerësimi i Ligjeve Shqiptare për Shoqëritë Tregëtare .....	42
ANEKSI 3 – Sfidat e Tranzicionit .....	51
ANNEX 4 – Tregues të Përzgjedhur Ekonomik .....	57
ANEKSI 5 – Çështjet Mjedisore dhe Sociale .....	58
ANEKSI 6 – Projektet e Bankës për Bashkëpunim Teknik 2006-2009 .....	69
ANEKSI 7 – Asistenca shumëpalëshe dhe dypalëshe .....	73
ANEKSI 8 – Aktiviteti i TAM/BAS në Shqipëri .....	82

## Lista e shkurttimeve

ABA	Banka Amerikane e Shqipërise
AKEP	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare në Shqipëri
AREF	Fondi i Kapitalit për Rindërtim të Shqipërisë
ARMO	Shoqëria Shqiptare e Rafinerisë së Naftës
ASPBM	Shoqata Shqiptare për Mbrojtjen e Shpendëve dhe Gjitarëve
BAP	Plan Veprimi për Biodiversitetin
BAS/TAM	Sherbime Konsulente për Biznes/Programi i Rimekembjes së Manaxhimit
BEEPS	Studimi i Mjedisit të Biznesit dhe i Performancës së Ndërmarrjeve
BIA	Banka Italo-Shqiptare
BOO/BOOT	Ndërtoj-Zotëroj-Punoj / Ndërtoj-Zotëroj-Punoj-Transferoj
BSEC	Bashkëpunimi Ekonomik i Detit të Zi
CAS	Strategjia për Asistencën e Vendit
CCUP	Programi për Njësine të Ndryshimit Klimaterik
CEB	Banka për Zhvillim të Këshillit të Europës
CEI	Nisma e Evropës Qendrore
CEZ	Shoqëria Energjitike Çeke
CITES	Konventa për Tregërinë Ndërkombëtare për Speciet në Rrezik
CPI	Indeksi për Llogaritjen e Korrupsionit
DISCO	Shoqëri Shpërndarëse
PMKPU	Programi për Menaxhimin e Katastrofave dhe Përgatitjen e Urgjencave
BEI	Banka Evropiane e Investimeve
EC	Komisioni Evropian
EU	Bashkimi Evropian
IHD	Investimet e Huaja Direkte
FNC	Komunikimi i Parë Ndërkombëtar
AMF	Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare
GDI	Treguesi i Zhvillimit Gjinnor
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
GEF	Linja Globale e Financimit të Mjedisit
GES	Gaz i Efektit Serrë
GRD	Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve
GRECO	Grupi i Shteteve të Këshillit të Evropës Kundër Korrupsionit
GSM	Sistemi Global për Telefoninë Celulare
GTZ	Bashkëpunimi Teknik Gjerman
HII	Instituti i Sigurimit të Shëndetit
HPP	Hidrocentral
BNRZH	Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore)
GJPN	Gjykata Penale Ndërkombëtare
SHNZH	Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (Banka Botërore)
KFN	Korporata Financiare Ndërkombëtare (Banka Botërore)
IFN	Institucion Financiar Ndërkombëtar
SNRF	Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
INSIG	Instituti i Sigurimeve

INSTAT	Instituti i Statistikave
IOSCO	Organizata Ndërkombëtare për Komisionet e Letrave me Vlerë
IPO	Oferta Fillestare Publike
IPS	Sistemi i Integruar i Planifikimit
BJBN	Banka Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar
KESH	Korporata Energjitike Shqiptare
KfW	Kreditanstalt für Eiederaufbau
LEF	Linja e Financimit të BERZH-it dhe Qeverisë Italiane për Ndërmarrjet
Lokale	
KTL	Kerkimi për Treguesit Ligjorë
LTT	Grupi i Tranzicionit Ligjor
LMB	Linja Mesatare Bashkëfinancuese
SZHM	Synimet e Zhvillimit të Mijëvjeçarit
MEI	Infrastruktura Bashkiake dhe Mjedisore
MoEFË	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Ujrave
MTBP	Programi i Buxhetit Afatmesem
NMVM	Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme
PVK	Plani i Veprimit Kombëtar
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
IFJB	Institucionet Financiare Jobankare
BKT	Banka Kombëtare Tregëtare
NEAP	Plani i Veprimit Ndërkombëtar Mjedisor
NPL	Huatë e Këqija
SKZHES	Strategjia Ndërkombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social
PPP	Partneritet Privat-Publik
PRGF	Linjë Financimi për Uljen e Varfërisë dhe Rritjen Ekonomike
PRSP	Dokumenti i Strategjisë për Uljen e Varfërisë
OCE	Zyra e Ekonomie Kryesore
AZZH	Asistenca Zyrtare për Zhvillim
OZHBE	Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik
OSBE	Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë
PD	Partia Demokratike
PS	Partia Socialiste
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit
AZZHB	Agjensia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SECI	Nisma për Bashkëpunimin Juglindor
SECO	Sektretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike
NVM/NMV	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme/Ndërmarrjet Mikro dhe të Vogla
SMET	Sistemi i Monitorimit për Efektin në Tranzicion
VNT	Vlerësimi i Nevojave Teknologjike
OST	Operatori i Sistemit të Trasmetimit
BU	Banka Union
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNEP	Programi Mjedisor i Kombeve të Bashkuara
UNFCCC	Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimin e Klimës
UNICEF	Fondi për Femijët i Kombeve të Bashkuara

USAID Agjensia për Zhvillim Ndërkombëtar e SHBA-ve  
VPP Termocentrali i Vlorës  
WeBSEDFP Programi i Financimit të Drejtpërdrejtë për Energjinë e Qëndrueshme  
në Ballkanin Perëndimor  
WeBSEECLF Programi i Linjës së Kredisë për Eficencën e Energjisë së Qëndrueshme  
për Ballkanin Perëndimor  
WBIF Sistemi i Investimit në Ballkanin Perëndimor  
OBSH Organizata Botërore e Shëndetësisë  
OBT Organizata Botërore e Tregëtisë

#### Monedhat

ALL Leku shqiptar  
EUR Euro, Monedha e Bashkimit Evropian  
SDR Special Drawing Right, “monedha” e FMN-së  
USD Dollari amerikan

#### Norma e këmbimit valutor

1 EUR 130.76 ALL  
1 USD 92.73 ALL

## **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

Shqipëria po vijon t'i plotësojë kushtet e paracaktuara në Nenin 1 të Marrëveshjes së Themelimit të Bankës.

Shqipëria ka vazhduar të përparojë në reformat kryesore strukturore dhe institucionale, që synojnë drejt integritimit në BE dhe institucionet e tjera Euro-Atlantike. Ajo është një nga shtetet e para në rajonin e Ballkanit Perëndimor që ka miratuar Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit (MSA) me BE dhe e ratifikuar nga të gjitha shtetet pjesëmarrëse dhe që është në fuqi aktualisht. Përparimet e Shqipërisë për përfshirjen në BE arritën kulmin me aplikimin e saj zyrtar në prill 2009 për anëtarësimin në BE. Megjithatë, egzistojnë akoma sfida të rëndësishme për reforma institucionale dhe ekonomike, dhe Banka synon që të ndihmojë vendin për arritjen me sukses të këtyre sfidave gjatë periudhës së Strategjisë.

Mjedisi i favorshëm makroekonomik në vitet e fundit ka qënë një faktor i rritjes së qëndrueshme të PBB në 6 përqind çdo vit ndërmjet 2005 dhe 2008. Rritja është shkaktuar kryesisht nga sektoret e shërbimeve dhe ndërtimit. Politikat ekonomike të qëndrueshme dhe . Megjithatë, kriza financiare shkaktoi një ulje të eksporteve (minus 17 përqind në një periudhë një vjeçare në gjysmën e parë të vitit 2009), ulja e remitancave (afërsisht 10 përqind të PBB në tremujorin e parë të 2009 më pak se 15 përqind në 2007/08), dhe pakësimi i investimeve të huaja; të gjitha këto në një rritje ekonomike mjaft të ulët, por akoma pozitive, në vitin 2009-2010. Sektori bankar është ndikuar më pak, në krahasim me shtetet e tjera në sajë të nivelit të ulët të integritimit financiar të Shqipërisë, përmirësimet në sistemin rregullator dhe mbikqyrës, nivelit relativisht të limituar të integritimit të Shqipërisë në tregjet botërore dhe nivelit të lartë të likuiditetit dhe kapitalizimit. Në anën tjetër huadhënia është bërë më e kufizuar dhe bankat po tregojnë një shqetësim në lidhje me cilësinë e portofolit të huave që ka një ndikim negativ në mundësinë e financimit të bizneseve, veçanërisht për NVM-të.

Qeveria i është përgjigjur krizës nëpërmjet dispozitave të likuiditetit, masave rregullatore (si p.sh një rritje në tavanin e siguracionit të depozitave) dhe një investim të vazhdueshëm në infrastrukturë që po siguron një stimul ekonomik. Si rezultat i shpenzimeve më të mëdha, defiçiti i buxhetit në vitin 2008 u rrit deri në 5.5 përqind, më shumë sesa 3.8 përqind në vitin 2007, dhe mund të jetë shumë pak mbi këtë nivel në vitin 2009. Sfidat kryesore makroekonomike përfshijnë defiçitet tregëtare dhe llogaritë korrente (mbi 25 përqindëshi i PBB të kaluar) në një mjedis me remitanca dhe investime të huaja të ulëta. Risqet fiskale vazhdojnë të jenë të larta dhe janë të lidhura me të ardhurat më të ulëta se ato të parashikuara dhe vazhdimin e subvencioneve të larta qeveritare për shërbimet shtetërore me performancë të ulët – uji, prodhimi dhe transmetimi i energjisë.

Reformat politike dhe progresi në integrimin European kanë ndihmuar që të përmirësojnë imazhin e Shqipërisë si një vend për të investuar dhe kanë kontribuar për një pamje ekonomike të favorshme në një periudhë afatmesme. Megjithatë mjedisi i biznesit

vazhdon të vuajë nga një nivel i lartë korrupsioni, probleme serioze në sistemin ligjor si edhe kapacitete të dobëta institucionale dhe për zbatimin e ligjit. Megjithë investimet e mëdha në vitet e fundit, infrastruktura vazhdon të jetë një pengesë në zhvillimin e sektorit privat, duke përfshirë nevojën për përmirësimin e mëtejshëm të rrjetit të transportit, mungesën e furnizimit të qëndrueshëm me energji, vëmendja e limituar që i është kushtuar rrjedhojave mjedisore të një aktiviteti ekonomik i zgjeruar me shpejtësi. Megjithë zhvillimin e arritur që në vitin 2005, varfëria është e përhapur, veçanërisht në zonat rurale, që nxit emigrimin e vazhdueshëm.

Shqipëria ka bërë progres në rrugën e vet të tranzicionit që nga miratimi i Strategjisë së fundit, e treguar nga disa arritje të ndryshme të treguesve të tranzicionit të BERZH. Në vitin 2006, zbatimi i suksesshëm i procedurave të lehtësuara të regjistrimit të biznesit dhe pakësimin e mëtejshëm të subvencioneve të ndërmarrjeve sollën një përmirësim të qeverisjes në lidhje me ndërmarrjet dhe treguesit të ristrukturimit. Në vitin 2007, privatizimi i shoqërisë së telekomunikacionit të linjes fikse, Albtelekom, dhe përmirësime të rëndësishme në sistemin e rregullave sektoriale sollën një rritje të treguesit të telekomit. Në vitin 2008, privatizimi i shoqërisë ARMO të rafinerisë së naftës dhe shoqërisë së shperndarjes së energjisë elektrike sollën një rritje të treguesit privatizimit në shkallë të gjërë, ndërsa zbatimi i efektshëm i ligjit të ri bankar dhe rritja e transparencës në këtë sektor pas themelimit të një Regjistri të ri të Kredive solli një rritje të treguesit në reformën bankare.

Sfidat kryesore të tranzicionit gjatë periudhës së strategjisë tjetër janë:

- 1 Përforcimi i institucioneve shtetërore: administrata publike dhe reforma e shërbimit civil, veçanërisht përmirësimi i efikasitetit dhe paanshmërisë së gjyqësorit dhe lufta efektive dhe sistematike kundër korrupsionit; përmirësime të mëtejshme në sektorin e investimeve për shoqëritë vendase dhe të huaja, duke përfshirë vendimin mbi regjistrimin e tokave dhe pronësinë, dhe përmirësimin e procedurave të regjistrimit të tokës;
- 2 Investimi në infrastrukturë, duke përfshirë përmirësimin e rrjeteve rrugore kombëtare, rajonale dhe lokale, modernizimin dhe zgjerimin e porteve detare, dhe përmirësimin e sigurisë energjitike; rritjen e përpjekjeve për privatizimin e shërbimeve të ujësjellës dhe kanalizimeve si edhe transportin urban, duke i dhënë ndërkohë autonomi më të madhe fiskale bashkive që mund të planifikojnë dhe investojnë në këto sektorë; rritja e pavarësisë dhe kapaciteteve të rregullatorëve të shërbimeve kryesore (energji, telekom, dhe shoqëritë e ujësjellës kanalizimeve) për të nxitur konkurrencën dhe investimin;
- 3 Përforcimin e mëtejshëm të sistemit bankar, mbështetjen e NVM-ve/NMV-ve dhe financimin e bankar të këtyre shoqërive për rritjen e konkurrencës për të ulur varësinë e madhe që ka Shqipëria mbi mallrat e importuara dhe rritjen e mundësive të eksportit; dhe mbështetjen e zhvillimit të sektorit financiar jobankar, duke përfshirë rritjen e mëtejshme kapacitetin mbikqyrës së Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare.

Banka ka luajtur një rol në rritje dhe të rëndësishëm në procesin e tranzicionit në Shqipëri: Që nga fillimi i investimeve, financimet direkte të Bankës kanë qënë mbi 500 milion Euro, duke vazhduar me 1.1 miliard Euro të tjera nga sponsorë dhe bashkëfinancues. Banka, duke punuar në bashkëpunim të ngushtë me IFN të tjera dhe donatorë, do të përpiqet të rritë më tej aktivitetet e saj dhe të ndikojë gjatë periudhës së strategjisë duke u fokusuar veçanërisht në sfidat e përcaktuara. Banka është përgatitur ti përgjigjet ndikimit negativ të krizës financiare, veçanërisht duke siguruar financim me pjesëmarrje në kapital të vet dhe financim kredie në sistemin bankar si edhe produkte të ndarjes së riskut për të rritur huadhënien e bankave lokale për sektorin real. Gjithashtu Banka synon të vazhdojë mbështetjen e projekteve kryesore qeveritare të infrastrukturës. Për më tepër, Banka po siguron investim në aksione dhe investime me hua për ndërmarrjet lokale të drejtuara nga eksporti nëpërmjet produkteve të krijuara posaçërisht, si p.sh Linja e Financimit të BERZH-it dhe Qeverisë Italiane për Ndërmarrjet Lokale (LEF).

**Projektet e Infrastrukturës, Energjisë, Bashkiake dhe Mjedisore:** Banka do të vazhdojë të mbështesë investimet në transport dhe energji, duke u përqëndruar në lidhjet rajonale, integrimin rajonal dhe sigurimin e energjisë. Duke përdorur projektin e Aeroportit të Tiranës si një model, Banka do të inkurajojë qeverinë që të marrë në konsideratë PPP të tjera dhe koncensionet për të tërhequr kapitalin privat në projektet e energjisë, porte dhe shërbimet bashkiake (ujësjellës, kanalizime). Atje ku është e mundur, Banka do të financojë në fushën e infrastrukturës pas privatizimit, si p.sh në sektorët e energjitikës dhe telekomit. Gjithashtu, janë të nevojshme përmirësime të mëtejshme në infrastrukturë si në sektorin e rrugëve. Banka do të vazhdojë të mbështesë nismat e përbashkëta me donatorët dhe IFN-të.

**Sektori i Ndërmarrjeve:** Banka vazhdon të konsiderohet si një institucion drejtues për mbështetjen e bizneseve konkurrense dhe veçanërisht investitorët e mëdhenj, vendas dhe ndërkombëtarë. Banka do ti përgjigjet në mënyrë elastike për të mbështetur investitorët egzistues dhe ata të rinj dhe me cilësi të lartë të cilët nuk mund të jenë në gjendje të financojnë investimet e tyre për shkak të krizës financiare botërore. Për shkak të nivelit të ulët të investimeve të huaja direkte, Banka do të zgjerojë më tej përpjekjet e saj për të ndihmuar shoqëritë e vogla dhe mesatare ose në mënyrë direkte, nëpërmjet LEF dhe WeBSEDF, ose në bashkëpunim me bankat lokale nëpërmjet produkteve si Linja Mesatare Bashkëfinancuese (LMB) dhe Programi i Linjës së Kredisë për Eficencën e Energjisë së Qëndrueshme për Ballkanin Perëndimor (WeBSEELCF). Një vëmendje e veçantë do ti kushtohet shoqërive që po zbatojnë eficientësi të energjisë dhe/ose investimet mbi energjinë e qëndrueshme dhe gjithashtu ato që po zhvillohen në sektorin e Teknologjisë e Informacionit.

**Sektori Financiar:** Në kuadrin e krizës botërore financiare, Banka është përgatitur ti përgjigjet me produkte financiare sipas nevojave të bankave lokale, ku përfshihen linja të ndarjes së riskut, investim me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë ose thuhet të drejtpërdrejtë në kapital të vet, dhe investime kredie të shoqëruara kur është e mundur me burime të



varuara nga fondet donatore, për të mbështetur ndërmjet të tjerave zhvillimin e NVM dhe NMVM dhe efikasitetin e energjisë. Objektivi kryesor është përforcimi i kapitalizimit të bankave, mbështetja e aktiviteteve huadhënëse për ekonominë reale që po fillon të ndjejë efektin e uljes së kredihënies dhe risk më të lartë nga bankat lokale. Banka do të ndihmojë në zhvillimin e sektorit financiar jobankar.

Banka do të rritë përpjekjet për linjat e veprimit në të gjithë sektorët, duke u përqëndruar në shqyrtimin e çështjeve ligjore dhe rregullatore që lindin sipas eksperiencës së projekteve të veçanta. Si në të kaluarën, Banka do të bashkërendojë aktivitetet e saj me IFN dhe donatorë të tjerë, veçanërisht në kuadrin e Sistemit të ri të Investimit në Ballkanin Perëndimor (WBIF), bashkë me KE, BEI, BZHKE dhe donatorë dypalësh. Banka është mjaft aktive në përpjekjet e koordinimit të donatorëve dhe mbështet qëllimet e Deklaratës së Parisit mbi Efektivitetin e Ndihmës, që janë projektuar të përmirësojnë shpërndarjen e asistencës. Në këtë kuadër, Banka do të bashkëpunojë me donatorë dhe qeverinë për të bashkuar Bashkëpunimin Teknik dhe bashkëfinancimin e granteve në projektet e saj prioritare në transport, energjitike dhe projektet bashkiake.

Banka do të vijojë të kujdeset që të gjitha operacionet e BERZH-it në Shqipëri t'u nënshtrohen Politikave dhe Proçedurave Mjedisore të Bankës të vitit 2008 dhe të trupëzojnë, ku duhet, Plane Pune Mjedisore.

## **1. PORTOFOLI I BANKËS**

### ***1.1 Pamje e përgjithshme e veprimtarive të deritanishme***

Deri në fund të muajit qershor 2009, Banka kishte arritur një vëllim progresiv pune prej 594 milion Euro (duke përfshirë edhe pjesët rajonale të financimit), me një kosto totale të projekteve prej më tepër se 1.6 miliard Euro. Pas nënshkrimit të 89 milion Euro në investime të reja në vitin 2008, vëllimi më i madh vjetor i arritur ndonjëherë, Banka nënshkroi investim të tjera prej më shumë se 50 milion Euro në gjysmën e parë të vitit 2009.

Portofoli aktiv në fund të vitit 2008 ishte 339 milion Euro (në 32 projekte). Kjo shifër arriti 370 milion Euro në 30 qershor 2009. Rritja ka ndodhur në sektorin privat dhe publik, me përfshirjen e mëvonshme të të gjitha investimeve të reja në vitin 2008 dhe në gjashtë muajt e parë të vitit 2009. Megjithatë, pas rëndësisë së kushtuar për përmirësime të mëtejshme në infrastrukturë, Banka vazhdon të kryejë projektet e infrastrukturës publike dhe private.

Mjetet e lëvruara neto ishin 210 milion Euro në 30 qershor 2009, të rritura me 76 përqind që në vitin 2006, dhe përfaqësojnë 57 përqind të portofolit aktiv (më shumë se 47 përqind që ishte në kohën e Strategjisë së mëparshme). Banka vazhdon të përballet me një zbatim të ngadaltë të projekteve në sektorin publik (si Rruga Levan-Tepelenë, Përmirësimi i Nënstacioneve të Transmetimit të KESH-it dhe Terminali i Portit të Durrësit) ku disbursimet do të merren në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2009 dhe në vitin 2010.

**Tabela 1. Portofoli i Bankës në Shqipëri, deri në 30 qershor 2009**

Emri i Sektorit	SHUMA PROGRESIVE E PORTOFOLIT				PORTOFOLI I TANISHËM				
	Nr i Projekt eve	Kosto Gjithsej	Shuma e nënshkru ar nga BERZH	Pesha që zë sektori	Nr i Projekt eve	Portofoli	Pesha që zë sektori	Mjetet e Lëvruara neto	Raporti i Mjeteve të lëvruara neto
<b>Institucionet Financiare</b>	<b>13</b>	<b>74.8</b>	<b>55.4</b>	<b>10.2%</b>	<b>7</b>	<b>19.3</b>	<b>5.2%</b>	<b>18.1</b>	<b>93.8%</b>
Bankat	8	55.9	39.3	7.2%	3	14.2	3.8%	14.2	100.0%
Fondet e pjesëmarrjes në kapital <sup>1</sup>	4	9.7	7.3	1.3%	4	5.1	1.4%	3.9	76.5%
Jobankare	1	9.2	8.8	1.6%	0	0	0%	0	0%
<b>Infrastruktura</b>	<b>13</b>	<b>840.1</b>	<b>246.7</b>	<b>45.2%</b>	<b>11</b>	<b>205.4</b>	<b>55%</b>	<b>112.1</b>	<b>54.6%</b>
Energjia elektrike dhe energjitika	7	513.1	112.5	20.6%	5	78.7	21.1%	53.5	68%
Transporti	6	327	134.2	24.6%	6	126.7	33.9%	58.6	46.3%
<b>Industritë e Specializuara</b>	<b>12</b>	<b>330.3</b>	<b>136.6</b>	<b>25.1%</b>	<b>7</b>	<b>64.4</b>	<b>17.2%</b>	<b>31.4</b>	<b>48.8%</b>
Telekomunikacionet	5	217.7	68.2	12.5%	3	36.5	9.8%	27.5	75.3%
Agrobiznesi	4	31.3	13.4	2.5%	2	2	0.5%	2	100%
Pronat, Turizmi & Transporti i Mallrave	3	81.3	55	10.1%	2	25.9	6.9%	1.9	7.3%
<b>Industria e Përgjithshme</b>	<b>6</b>	<b>417.1</b>	<b>106.5</b>	<b>19.5%</b>	<b>6</b>	<b>84.1</b>	<b>22.6%</b>	<b>47.4</b>	<b>56.4%</b>
<b>Gjithsej për vendin</b>	<b>44</b>	<b>1,662.3</b>	<b>545.2</b>	<b>100.0%</b>	<b>31</b>	<b>373.2</b>	<b>100.0%</b>	<b>209.0</b>	<b>57%</b>

## ***1.2 Zbatimi i Strategjisë së Bankës së fundit***

Strategjia e kaluar për Shqipërinë u miratua në datën 4 prill 2006 dhe theksonte prioritetet e mëposhtme:

(i) projekte të zhvillimit të infrastrukturës, të energjistikës, të infrastrukturës bashkiake dhe mjedisore;

<sup>1</sup> Pjesëmarrje në Fondin e Kapitalit për Rindërtim të Shqipërisë (AREF e krijuar nga BERZH) si edhe investime në Shqipëri nga fonde të tjera rajonale me pjesëmarrje në kapital.

- (ii) privatizimin dhe ristrukturimin e ndërmarrjeve komunale shtetërore që kishin mbetur (psh, në sektorin e telekomit, energjisë) dhe komercializimin e ndërmarrjeve komunale të pushtetit vendor (psh ujësjellës-kanalizime);
- (iii) zhvillimin dhe konsolidimin e sektorit financiar;
- (iv) IHD për ndërmarrjet vendore me vëmendje të veçantë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme; dhe
- (v) dialog për politikat sidomos në fushat e rregullimit dhe të fuqizimit të tregjeve për infrastrukturën, duke përfshirë ngritjen e kapaciteteve dhe të institucioneve.

Që nga miratimi i Strategjisë, Banka ka investuar 178.1 milion Euro në 14 projekte të reja. Banka vazhdon të kryejë një rol të rëndësishëm dhe ka zgjeruar veprimtarinë e saj në fushat e saj të zbatimit.

Banka ka zbatuar projekte të reja në sektorin shtetëror – rrugë, porte dhe energji – duke i kushtuar vëmendje të madhe zbatimit të investimeve në infrastrukturë. Banka ka kontribuar në rindërtimin e rrjetit të transportit nëpërmjet financimit të projekteve rrugore Elbasan-Librazhd, Levan-Vlore and Levan-Tepelene dhe po punon për ndërtimin e terminalit të pasagjerëve në Portin e Durrësit. Gjithashtu, këto projekte janë të lidhura me reformën në sektor dhe fuqizimin institucional. Konçesioni i Aeroportit të Tiranës ishte projekti i parë i madh në Partneritetin Publik Privat (“PPP”) në Shqipëri që tregon qartë ndikimin e pjesëmarrësve të tjerë privatë në infrastrukturë. Edhe privatizimi i Albtelekomit ka qënë një shembull i suksesshëm i Bankës në mbështetjen e përfshirjes së sektorit privat në infrastrukturë.

Në sektorin e energjitkës, Banka ka bashkëpunuar me donatorë të tjerë për të mbështetur procesin e ndarjes i cili u finalizua me krijimin e shoqërisë së pavarur të shpërndarjes (DISCO), operatori i sistemit të transmetimit (OST) dhe shoqëria energjitike shqiptare (KESH). Pas financimit të rehabilitimit të rrjetit, ndërtimi i termocentralit të Vlorës (VPP) mbaroi, termocentrali i parë i ndërtuar në Shqipëri në më shumë se 25 vjet. Zbatimet për përmirësimin e sistemit të shpërndarjes janë në proces. Banka planifikon të mbështesë CEZ pasi shoqëria të blejë DISCO.

Megjithë këto suksese, pjesëmarrja e Bankës në sektorin publik është kufizuar nga kapacitetet huamarrëse dhe zbatuese të institucioneve publike. Për këtë arsye, Banka duhet të vazhdojë të punojë me donatorët dhe qeverinë për të patur më shumë efikasitet në zbatimin e projekteve. Linja e re e financimit, WBIF do të sigurojë platformën më të favorshme për IFN-të dhe koordinimin e donatorëve dhe për përmirësimin e dialogut të politikave.

Banka ka ndihmuar në zbatimin e investimeve të suksesshme private në Shqipëri dhe vitet e fundit ka qënë një partner në IHD-të më të mëdha. Këto investime kanë një efekt të rëndësishëm tregues dhe nxitin cilësinë drejt investimeve. Gjithashtu, Banka ka mbështetur investitorët vendas, si p.sh Euromax (shitje me pakicë), Bi-Invest (materiale ndërtimi) dhe Edipack (paketime). Çdo shoqëri vepron në standartet më të larta në sektorin përkatës në Shqipëri, duke vendosur standarte që investitorë të tjerë duhet të përpiqen ti arrijnë.

Gjatë periudhës së strategjisë së kaluar, Banka bëri investimet e saj të para në sektorin e Burimeve Natyrore. Banka bëri një investim me pjesëmarrje në kapital të vet dhe i siguroi dy hua shoqërisë Bankars Petroleum, Toronto.

Banka ka kontribuar në zhvillimin dhe ristrukturimin e sektorit financiar nëpërmjet investimit me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në kapital të vet në tre banka lokale dhe nënshkrimin e një marrëveshjeje bashkëfinancuese nën MCFF me një tërësi prej tyre. Megjithatë, Banka ka patur mundësi të limituar për të siguruar produktet normale të huasë, kryesisht si rezultat i përdorimit nga bankat lokale të fondeve më të ulëta në çmim nga depozitat dhe linjat e subvencionuara nga bankat mëmë. Për më tepër, ekonomia e gjërë informale lejon një numër të madh transaksionesh tregëtare që kryhen jashtë sektorit bankar, duke limituar interesin në produktet tregëtare-financiare të Bankës. Banka ka pasur një ndikim të kufizuar në sektorin financiar jobankar (IFJB). Megjithëse Banka mori pjesë në investimin direkt të INSIG, shoqërisë shtetërore të sigurimeve, nëpërmjet një investimi me pjesëmarrje në kapital të vet dhe asistencë teknike, ajo e mbylli këtë investim pas një privatizimi jo të suksesshëm në fundin e vitit 2008. Banka planifikon të vazhdojë mbështetjen për rregullatorin e sigurimeve dhe po zbaton një projekt për të krijuar ligjet dhe rregullat për sigurimet e obligacioneve të korporatave dhe bashkive.

Si rezultat i mundësive të kufizuara për sigurimin e huadhënies tradicionale për NVM nëpërmjet bankave lokale, Banka ka krijuar produkte të reja për të punuar me ndërmarrjet lokale (si. psh. LEF and WeBSEDF). Këto përpjekje kanë rezultuar të suksesshme pas nënshkrimit të disa investimeve të vogla të LEF.

### ***1.3 Efekti i tranzicionit dhe mësimet e nxjerra prej tij***

Një përmbledhje e operacioneve e kryer nga Zyra Ekonomike Kryesore (ZEK) dhe e monitoruar nëpërmjet Sistemi i Monitorimit për Efektin në Tranzicion (SMET) të Bankës tregon se projektet në Shqipëri kanë ndikim të lartë në tranzicion pas nënshkrimit. Nga viti 2005 deri në gjysmën e vitit 2009, 93 përqind e projekteve janë klasifikuar si Mirë dhe Shkëlqyer në lidhje me potencialin e efektit në tranzicion.

Gjatë kësaj periudhe, vetëm një projekt i monitoruar nga ZEK (Linja e Financimit të NVM-ve në Ballkanin Perëndimor – Banka Popullore) u vlerësua më ulët. Zakonisht, vlerësimet e ulëta karakterizohen nga risqe të larta për të arritur ndikimin në tranzicion. Megjithatë, në këtë rast, potenciali i ndikimit në tranzicion të projektit u ul në sajë të anulimit të Planit të Ndërtimit të Institucionit (PNI) që Banka kishte parashikuar fillimisht si pjesë e këtij projekti, duke vazhduar me marrjen e Bankës Popullore nga Société Générale (SG) dhe angazhimin e bankës së re mëmë për të zbatuar, si pjesë e integritit të bankës së re të blerë në Grupin SG, përmirësimet e nevojshme në standartet e biznesit dhe qeverisjes së korporatave që ishin në kundërshtim me PNI <sup>2</sup>. Për këtë arsye, monitorimi i ndikimeve në tranzicion nëpërmjet SMNT nuk tregon ndikime të drejtpërdrejta të krizës


---

<sup>2</sup> Linja e kredisë e NVM-ve për Bankën Popullore u anulua në fillim të vitit 2009, pas blerjes së bankës nga SG, banka kishte fonde të nevojshme nga banka e re mëmë dhe nuk kishte nevojë për fondet e Bankës.

ekonomike dhe financiare tek operacionet e Bankës deri në gjysmën e vitit 2009<sup>3</sup>.

Gjithashtu, është e mundur të analizohen linjat kryesore nëpërmjet të cilave efektet në tranzicion u arritën në Shqipëri gjatë periudhës së studiuar. Siç tregohet në Tabelen 2 më poshtë, Konkurrenca dhe arritja e *Standartëve në qeverisjen e shoqërive dhe drejtimin e biznesit* ishin fushat kryesore të efekteve. Konkurrenca ishte veçanërisht e rëndësishme në sektorët e Bankave dhe Shoqërive, ndërsa Qeverisja e Korporatave është drejtuesi kryesor i efekteve në tranzicion në sektorin e Energjisë dhe Infrastrukturës – veçanërisht në sektorin e Burimeve Natyrore.

**Tabela 2: Efektet e Tranzicionit të arritura nga projektet e BERZH-it - 2005-(3-mujori II) 2009**



Analiza në vazhdim të efektit të portofolit të Bankës dhe mësimet e nxjerra nga ajo mbështetet mbi të dhënat e mëparshme që gjenden në Raportet e Kaluara të Efektit të Tranzicionit (RET), të dhënat e fundit të ZEK mbi sfidat e mbetura, raportet e SMET dhe studime të kryera nga Departamenti i Vlerësimit në Bankë gjatë pesëmbëdhjetë vjetëve të fundit të aktiviteteve në Shqipëri:

### 1.3.1 Sektori i Ndërmarrjeve

**Agrobiznesi** – Në sajë të përmasave të pjesës më të madhe të shoqërive në këtë sektor, këto investime synojnë të financohen nga LEF ose në mënyrë indirekte nëpërmjet rrugëve financiare të mbështetura nga Banka. Gjithashtu, shoqëritë e agrobiznesit sigurojnë

<sup>3</sup> Nëse do të kishte, ndikime të tilla do të bëheshin të dukshme gjatë vitit, ndërsa cikli monitorues nuk mund ti kishte dalluar në sajë të intervaleve kohore ndërmjet raporteve monitoruese.

ndihmë nga programet e BAS dhe TAM. Kohët e fundit, duke përdorur LEF, Banka investoi në shoqërinë Beba, që tashmë prodhon letër të ricikluar dhe kuti kartoni që tregëtohen si materiale paketuuese për shoqëritë e agrobiznesit. Investimi i Bankës në prodhimin e vajit të ullirit thekson edhe njëherë vështirësitë që hasen në shoqëritë e para në menaxhimin në linjën e shitjeve me shumicë.

***Industria e Përgjithshme*** – Në vitin 2008, Banka nënshkroi investimin e saj të dytë në industrinë e çimentos me Titan në Greqi. Si një investim i parë në atë sektor, ky investim pritet të rritë standartet operative akoma më tej dhe do të krijojë një mjedis akoma më shumë konkurrues. Për më tepër, projekti do të kontribuojë për furnizuesit dhe kontraktorët. Nëpërmjet LEF, Banka investoi në shoqërinë Beba për riciklimin e letërës dhe një fabrikë asfalti, të dyja janë projekte të para në atë fushë-në kushtet e standarteve operacionale dhe mjedisore. Një sërë shoqërish kanë përfituar nga ndihma e TAM dhe BAS. Investimi i mëparshëm i Bankës në Fabrikën e Çimentos së Fushë-Krujës ishte një privatizim i suksesshëm duke kontribuar në përmirësime të rëndësishme operacionale dhe drejtuese.

Për sa i përket, mësimëve të nxjerra, projekti i Bankës me Fushë Krujën theksoi nevojën për të eksploruar më shumë mundësitë për shfrytëzimin e tregëtimit të lëshimit të karbonit (PE07-386).

***Prona dhe turizëm*** – Duke mbështetur hotelet e para me standarde ndërkombëtare – Hotel Tirana dhe Hotel Rogner – Banka ka pasur një ndikim të limituar në sektorin e pronave. Në fillimet e vitit 2009, Banka nënshkroi një investim të madh për qëndrën më të madhe tregëtare të ndërtuar në Tiranë. Investimi në turizëm është kufizuar në sajë të pasigurisë mbi të drejtat mbi pronën dhe lejet, si edhe nga infrastruktura e dobët. Ndërsa të dyja çështjet po zgjidhen ngadalë, investimi në projektet e pronave dhe veçanërisht turizmi bregdetar do të zhvillohen më shumë në vitet në vazhdim.

***Telekomunikacion*** – Banka ka patur një ndikim të madh në sektorin e telekomit, duke siguruar BT për rregullatorin dhe gjithashtu duke financuar dy nga tre operatorët më të mëdhenj. Investimi i fundit tek Albtelekom plotësoi procesin e zgjatur të privatizimit dhe nëpërmjet investimit të lidhur me Eagle Mobile, Banka ndihmoi rritjen e konkurrencës dhe si rezultat uljen e tarifave në linjën fikse dhe celulare të kësaj industrie. Është e nevojshme një reformë e mëtejshme rregullatore përpara se vendi të fillojë të përfitojë nga rritja e gjërë e përdorimit të produkteve si *broadband dhe WiMax*.

**Një mësim i nxjerrë** nga investimi i mëparshëm tek Vodafone tregoi edhe njëherë se telefonia GSM është një zgjidhje efektive kostoje në vendet ku ka një pamjaftueshmëri të madhe të shërbimeve kryesore telefonike dhe nivele të ardhurash relativisht të ulëta (PEX06-287).

Në përgjithësi, një efekt mesatar i tranzicionit është arritur në Sektorin e Ndërmarrjeve <sup>4</sup>.

---

<sup>4</sup> Përmbledhja e vlerësimit të EvD i referohet të dhënave hyrëse të mëposhtme: TIR, ATC, TIMS si edhe klasifikimet e OPER/XMRA

### 1.3.2 Sektori Financiar

*Investim në kapital të vet* – Banka ka marrë pjesë në katër investime të ndryshme në kapital të vet deri tani:

- (i) Banka investoi tek “Banca Italo-Albanese” (BIA) në vitin 1994. Investimi kishte një ndikim të rëndësishëm në tranzicion dhe një efekt tregues si investimi i parë i Bankës në sektorin privat në Shqipëri dhe për mbështetjen e bankës së parë me pronar të huaj në vend. Banka vazhdoi të mbështetë BIA-n nëpërmjet fazave të ndryshme të zhvillimit dhe konsolidimit, edhe gjatë shitjes së saj tel Sanpaolo IMI në vitin 2005 si edhe gjatë bashkimit me Bankën Amerikane të Shqipërisë (ABA) në vitin 2008 që solli krijimin e Bankës Intesa Sanpaolo në Shqipëri, banka e dytë më e madhe në vend.
- (ii) Banka mbështeti Bankën Kombëtare tregëtare (NCB ose BKT) gjatë një periudhe të gjatë kohore që nga privatizimi në vitin 2000 dhe në qershor 2009, Banka e mbylli financimin duke ia shitur aksionet e saj sponsorit, Calik Group, Turqi.
- (iii) Në vitin 2008, Banka investoi në aksione të vogla të Union Bank (UB), një bankë e re dhe e vogël lokale, e cila megjithë krizën financiare, pret të përfitojë nga operacionet në rritje të bizneseve me shumicë dhe të vogla. Përveç mbështetjes me pjesëmarrje në kapital të vet, Banka po mbështet UB me asistencë teknike për zbatimin e një programi të kuptueshëm për ndërtimin e institucionit.
- (iv) Banka mori pjesë si një investitor nismëtar tek ProCredit Bank, e cila mori një licencë të plotë bankare pasi u shndërua nga një institucion mikro financiar.

Për sa i përket, *mësimeve të nxjerra*, BIA tregoi nevojën e monitorimit të vazhdueshëm dhe të vëmendshëm të praktikave bankare dhe qeverisjes së korporatave. Banka lehtësoi privatizimin e BKT, ku megjithë strukturimit të transaksionit, Banka do të kishte përfituar nga një propozim mbi pronësinë e sponsorit (PEX02-165).

**IFJB** – Investimi i vetëm i Bankës në IFJB ka qënë në shoqërinë shtetërore të sigurimeve, INSIG, ku ajo siguroi një aksion të vogël nëpërmjet KFN në vitin 2003. Fatkeqësisht, megjithë mbështetjen e ndryshimeve në operacionet e INSIG, standartet strukturore dhe të qeverisjes së korporatave si edhe asistencë teknike për përmirësimin e aftësive menaxhuese dhe teknike, procesi i privatizimit dështoi në fundin e vitit 2008 (megjithëse qeveria mund ta rifillojë atë në një fazë të mëvonshme). Banka dhe KFN vendosën bashkë të mbyllnin investime për INSIG dhe ti kthenin aksionet e tyre qeverisë.

Nëpërmjet Grupit të Tranzicionit Ligjor (GTL), Banka është përfshirë në një BT të rëndësishëm duke siguruar mbështetje për rregullatorin e sigurimeve për përmirësimin e rregullave dhe kapaciteteve përforcuese, duke synuar rritjen e disiplinës së tregut. Gjithashtu, Banka po zbaton një projekt për zhvillimin e legjislacionit për sigurimin e obligacioneve të korporatave dhe atyre bashkiake.

*Aktivitetet huadhënëse* – Megjithë përpjekjet e hershme për zgjerimin e financimit të



NVM-ve – huatë për BIA dhe Tirana Bank dhe investimi për Procredit Bank Albania – u cilësuan të suksesshme për sigurimin e financimit. Zgjerimi i shpejtë i huadhënies së NVM-ve është bërë shqetësuese për Bankën e Shqipërisë dhe duhet të monitorohet nga afër (siç theksohet nga Departamenti i Vlerësimit të Bankës, PE03-255S). Ndërsa në vitet e fundit, Banka nuk ka qënë e aftë për të ofruar produktet e saj të huasë, ndikimi i krizës financiare botërore në sektorin bankar mund të shkaktojë rritjen e interesave në produktet huadhënëse. Kjo mund të jetë e lidhur me BT, si p.sh për efikasitetin e energjisë, numrin e kredive, NVM ose financimi i projektit nëpërmjet linjave bashkëfinancuese të MCFE.

**Fondet me pjesëmarrje në kapital të vet** – Banka vazhdon të jetë një nga burimet e vetme për angazhim në kapital në Shqipëri, megjithëse në disa vitet e fundit, Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve, Fondi për Financim në Ballkan dhe Kapitali Bedminster (ku dy të fundit janë pjesë e financimit të Bankës) investuan në Shqipëri. LEF është bërë tani burimi i vetëm për financimin me pjesëmarrje në kapital të vet dhe ka investuar deri tani në 6 shoqëri që janë në etapa të ndryshme të zbatimit. Shoqëritë më të vogla me investim me pjesëmarrje në kapital të vet kërkojnë mbështetje të rëndësishme, që sigurohet nëpërmjet BT të synuara nga Banka, TAM dhe BAS dhe nëpërmjet përfaqësuesve të përcaktuara nga Banka në bordin e drejtorëve.

Në përgjithësi, efekti i *Moderuar* i tranzicionit është arritur në *Sektorin Financiar*.

### 1.3.3 Infrastruktura

**Energjitika** – Një zhvillim i rëndësishëm është arritur në sektorin e energjitikës në vitet e fundit, me përpjekjet e përbashkëta nga Banka dhe komuniteti i donatorëve. Pas viteve të ndërprerjeve të herëpashershme të energjisë dhe rregullatorët e dobët, qeveria ka zbatuar reforma të rëndësishme, duke përfshirë ndarjen e shoqërive të prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes dhe privatizimin e të fundit tek shoqëria CEZ e Republikës së Çekisë. Gjithashtu, vendi nënshkroi një numër kontratash konçesionare për prodhimin e energjisë, veçanërisht për HPP. Banka po shqyrton financimin e mundshëm të investitorëve vendas dhe të huaj në këtë sektor.

**Një mësim i nxjerrë** nga Projektet e Bankës në Sektorin Energjitik është se edhe një nismë drejtuese dhe operacionale e BT është një zgjidhje më pak pozitive në krahasim me një kontratë bashkë-menaxhuese ose konçesionare që përfshin transferimin e të drejtave të biznesit dhe risqeve tek një investitor strategjik (PE08-432).

**Transport** – Zbatimi i tre projekteve të transportit në sektorin shtetëror të nënshkruara në disa vitet e fundit – Rruga Levan-Vlorë, Rruga Levan-Tepelenë dhe terminali i Portit të Durrësit kanë pasur vonesa në zbatim, kryesisht me vështirësitë në projektim, prokurim dhe shpronësim. Megjithatë, Projekti për Rehabilitimin e rrugës Fier Tepelenë ka sjellë përmirësime të rëndësishme në financimin e sektorit rrugor. Megjithëse ka pasur disa vonesa në arritjen e etapave të tranzicionit, u shfaqën disa elementë përmirëmbajtjen e rrugëve, si p.sh Master Plani Kombëtar i Transportit, përgatitja e një programi 3-vjeçar për mirëmbajtjen. Në anën tjetër, konçesioni i aeroportit të Tiranës, PPP e parë më e

madhe në rajon, u ndërtua në kohë dhe brenda buxhetit. Financimi i Bankës në fazën e dytë (që u mbyll në vitin 2008) gjithashtu paraqiti konceptin e rifinancimit të një projekti infrastrukture afatgjatë pasi ishin zvogëluar rreziqet fillestare të ndërtimit (në këtë rast pasi faza e parë e zhvillimit të aeroportit ishte ndërtuar plotësisht dhe ishte në gjendje pune).

**IBM** (Infrastruktura Bashkiake Mjedisore)– Operacioni i parë i IBM u nënshkrua në vitin 2006, në Projektin Publik të Transportit të Tiranës. Efekti i tranzicionit të këtij projekti lidhet me zbatimin e një Strategjie për Transportin, rregullat e përmirësuara për transportin urban dhe një Program për Përmirësimin e Creditworthiness që synon përmirësimin e autonomisë financiare të Bashkisë. Projekti po zhvillohet më tej në përputhje me planin. Përmasat e reformës janë në rrugën e duhur megjithëse pak të vonuara me planin. Megjithëse është akoma herët për të dhënë një gjykim të saktë, duket që bashkitë kanë fituar më shumë pavarësi, siç paraqitet në pjesën e Ligjit mbi Bashkitë 2008 që i jep autoritetin huamarrës për bashkitë për herë të parë, dhe shpresohet që projekti i parë do të ndiqet nga investime të tjera në këtë sektor.

Në përgjithësi, efekti i *Moderuar* i tranzicionit është arritur në *Sektorin* e Infrastrukturës.

### **1.3.4 Bashkëpunimi Teknik**

Në të gjitha operacionet e saj të BT, Banka ka bashkëpunuar me donatorë të tjerë për të siguruar një mbështetje të koordinuar. Në fakt, Shqipëria ka një system donatorësh të zgjeruar; Banka do të vazhdojë me partnerët e vet donatorë për përmirësimin e koordinimit dhe shpërndarjen e ndihmës siç rekomandohet në Deklaratën e Parisit mbi Efektivitetin e Ndihmës dhe e kërkuar nga autoritetet shqiptare në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013.

Programi TAM/BAS i Bankës vazhdon të sigurojë mbështetje për të ndihmuar përforcimin e shoqërive vendase.

Grupi i Tranzicionit Ligjor (GTL) të Bankës ka siguruar mbështetjen e politikave. Në lidhje me telekomin, Shqipëria ka kryer zhvillime të mëdha duke përshtatur në mënyrë formale sistemin e vet rregullator me praktikën më të mirë të BE. Projekti i BT në proces i Bankës me rregullatorin e telekomit e AKEP ka ndihmuar në disa fusha të veçanta teknike; megjithëse zbatimi i sistemit të ri vazhdon të jetë i pjesshëm. Në veçanti, kapaciteti institucional është i dobët, me vonesa të zhvillimeve të rëndësishme strategjike që shkaktohet nga qeverisjet e dobëta (duke përfshirë marrëdhëniet e paqarta ndërmjet nivelit drejtues dhe anëtarëve të bordit të AKEP). BT aktual i telekomit vazhdon deri në gjysëm të vitit 2010, në një kohë kur Banka do të konsiderojë nëse mbështetja e mëtejshme e BT (veçanërisht në anën institucionale) është e nevojshme për të siguruar zbatimin në kohë dhe efektiv të një sistemi të qëndrueshëm.

Gjithashtu, Banka siguroi një ndihmë teknike për Autoritetin Mbikqyrës Financiar

jobankare (AMF) për mbikqyrjen e shoqërive të sigurimit dhe në zhvillimin e një ligji të ri mbi obligacionet e korporatave dhe atyre bashkiake.

## **1.4 Raporti dhe cilësia e portofolit**

Nga portofoli aktual prej 373 milion Euro, përqindja e sektorit privat është afërsisht 50 përqind, në rritje nga 40 përqind që ishte në vitin 2006. Nga pikëpamja e numrit të projekteve, përqindja e sektorit privat në portofol është mbi 70 përqind. Pësia e sektorit publik qëndron e lartë, siç është paraqitur në Strategjinë e kaluar, si rezultat i diferencës së përmasave strukturore ndërmjet projekteve të sektorit privat dhe publik (ato të fundit janë shumë më të mëdha sepse akoma ka vetëm pak korporata private në vend). Megjithatë, investimet e fundit në Aeroportin e Tiranës, Albtelekom, Titan-Antea Cement, Bankars Petroleum dhe Tirana East Gate rritën përqindjen e sektorit privat në portofol.

Cilësia e portofolit ishte e mirë pa asete të dobëta në fund të vitit 2008. Megjithatë, përqindja e riskut të portofolit është e lartë me shumicën e projekteve të vlerësuara ndërmjet 6 dhe 7 (ku vlerësimi i riskut në vend është 6). Kriza e vazhdueshme financiare botërore nuk ka patur një ndikim të rëndësishëm në portofol, megjithëse kjo pritet të monitorohet nga afër. Banka duhet të përgatitet ti përgjigjet sipas nevojës kërkesave financiare individuale, sektoriale ose sistematike.

## **2. MJEDISI I PUNËS**

### **2.1 Mjedisi i përgjithshëm i reformave**

#### **2.1.1 Zhvillimet politike**

Partia Demokratike (PD) e djalhtë ka drejtuar qeverinë e koalicionit që në vitin 2005. Gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2007, Partia Socialiste (PS) partia kryesore e opozitës doli fituese në disa qytete kryesore, duke përfshirë Tiranën. Zgjedhjet parlamentare në 28 qershor 2009 sollën një rezultat shumë të afërt. Sipas rezultateve përfundimtare koalicioni i drejtuar nga PD fitoi gjysmën e vendeve në Parlament, një rezultat shumë i afërt me koalicionin e drejtuar nga PS dhe do të drejtojë qeverinë tjetër të koalicionit. Në mënyrë që të krijonte një qeveri më të qëndrueshme, PD fitoi jo vetëm partinë e vogla të koalicionit nga e djathta por edhe Lëvizjen Socialiste për Integrim (LSI), pjesë e Partisë Socialiste që drejtoi një koalicion të veçantë gjatë këtyre zgjedhjeve.

Qeveria e re pritet të ketë prioritetet e qeverisë së mëparshme, duke u fokusuar në reformat e tregut, luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe integrimin e mëtejshëm në institucionet Euro-Atlantike. Duhet theksuar se ka një konsensus të gjërë ndërmjet partive politike shqiptare, duke përfshirë edhe opozitën, në lidhje me këto

prioritete.

Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit (MSA) me BE në vitin 2006 e cila hyri në fuqi në prill 2009. Në 28 prill 2009, Shqipëria aplikon në mënyrë zyrtare për anëtarësimin në BE. Shqipëria u bë anëtare e rregullt e NATO-s në prill 2009. Tirana luan një rol të rëndësishëm në bashkëpunimin rajonal, dhe qeveria e re pritjet të mbështesë më tej projektet përtej kufijve dhe ato rajonale.

### **2.1.2 Mjedisi i biznesit**

Qeveria ka kryer një progres të rëndësishëm në përmirësimin e klimës së biznesit në vitet e fundit. Në vitin 2006 Qeveria miratoi nismën “Shqipëria Një Euro” për të tërhequr IHD-të dhe shpalli ndërtimin e zonave industriale dhe shitjen e tokës dhe pronave të tjera shtetërore me çmime simbolike. Në vitin 2007/08, qeveria shpalli nivelin prej 10 përqind të taksës së sheshtë mbi të ardhurat e korporatave dhe zbaton një sërë reformash administrative për të rritur të ardhurat nga taksat. Krijimi i një qendre të re për regjistrimin e biznesit në vitin 2007 zvogëloi kohën dhe koston që nevojitej për të hapur një biznes. Si rrjedhim, numri i bizneseve të reja të regjistruara u rrit me 34 përqind në vitin 2008. Ligjet e reja mbi koncensionet dhe mbi prokurimet publike u ndryshuan për t’iu afruar standarteve europiane. Bllokimet në procesin e falimentimit u zgjidhën nëpërmjet ndryshimeve në ligjin mbi falimentimet, megjithëse ligji nuk është testuar gjërësisht.

Në qershor 2009, u hap një qendër për lëshimin e licensave dhe lejeve dhe ndryshimet ligjore për të kursyer kohën për lëshimin e lejeve të ndërtimit nga 60 në 45 ditë u miratuan. Këto përmirësime u reflektuan në raportin e Bankës Botërore, Doing Business 2010 që e rendit Shqipërinë në vendin e 82-të nga 183 vende (më lart se në vendin e 135 në vitin 2008).

Megjithatë, zbatimet e dobëta të ligjit dhe nivelet e larta të korrupsionit vazhdojnë të jenë pengesa të rëndësishme në zhvillimin e biznesit. Megjithëse rastet e deklaruar të korrupsionit në gjykata dhe në shërbimet e doganave janë rritur vitet e fundit, firmat akoma raportojnë korrupsionin mbi nivelet mesatare, sipas Studimit të Mjedisit të Biznesit dhe Performancës së Ndërmarrjeve (BEEPS) nga BERZH. Rezultatet e BEEPS tregojnë probleme serioze ndërmjet drejtuesve të biznesit në fushën e të drejtave mbi pronat dhe pronësisë. Megjithë përmirësimet e fundit të Indeksit për Llogaritjen e Korrupsionit (CPI) nga Transparency International, Shqipëria akoma renditet në vendin e 85 nga 180 shtete, ndërmjet shteteve me nivelin më të ulët në Evropën Juglindore dhe dukshëm nën nivelin mesatar të OECD.

### **2.1.3 Çështjet sociale dhe të punës**

Rritja e lartë e PBB-së në 10 vitet e fundit, bashkë me një rritje mesatare (në terma realë) të rrogave me 36.5 përqind nga viti 2005 në vitin 2008, dhe 17.5 përqind për pensionet nga viti 2005 në vitin 2007, ka kontribuar në një ulje të rëndësishme të varfërisë. Shifrat e

fundit të deklaruara nga Banka Botërore tregojnë se vitin 2008 12.4 përqind e popullsisë ishin të varfër në krahasim me 18.5 përqind në vitin 2005 dhe 25.4 përqind në vitin 2002. Megjithatë, Shqipëria akoma renditet në nivele të ulëta në krahasim me shtetet e tjera në tranzicion të rajonit nga pikëpamja e treguesve të standarteve të zakonshme të jetesës dhe të zhvillimit të njerëzve. Sistemi i shëndetit publik ka mangësi si fragmentarizimi, mungesa e investimit, humbjen e punonjësve të kualifikuar mjekësor në sektorin privat dhe pakësimin në nivele të larta të punonjësve në zonat e largëta. Nivelet e vdekshmërisë foshnjore kanë rënë por akoma qëndrojnë të larta në krahasim me shtetet e tjera të Europës, dhe vdekshmëria e nënave akoma përbën një problem. Shqipëria ka nivelin më të ulët të frekuentimit të shkollave të mesme ndërmjet vendeve të rajonit (55 përqind në vitin 2006). Arsyeja kryesore e nivelit të lartë të arsimit të paplotësuar është varfëria ku familjet në zonat rurale detyrohen ti shfrytëzojnë fëmijët për punë.

Një analizë e ndarë sipas gjinive tregon se shumë gra vuajnë nga varfëria dhe kanë probleme shëndetësore dhe mungesë të shërbimeve sociale. Për më tepër, gjatë periudhës së tranzicionit, gratë kanë vuajtur nga dhuna dhe trafikimi për shfrytëzim seksual.

Forca punëtore vendase në vitin 2008 ishte 35.2 përqind të popullsisë. Niveli i papunësisë u ul në 12.68 përqind në vitin 2008 në krahasim me 13.78 përqind në vitin 2006. Sektorët me rritjen më të madhe në numër të punëtorëve ishin industria, transporti, telekomunikacioni, tregëtia, hotelet dhe restorantet. Për një analizë më të detajuar të çështjeve sociale dhe të punës, shihni Aneksin 5.

#### **2.1.4 Çështjet mjedisore**

Vendodhja strategjike e Shqipërisë në Evropën Jug-Lindore i jep mundësi për lidhje direkte me Detin Mesdhe. Vendi njihet për diversitetin e ekosistemeve (p.sh zonave bregdetare, mjedisve detare, kullotave dhe lëndinave alpine dhe nën-alpine), dhe mbi 3000 lloje specie bimësh dhe shumë specie të rralla dhe/ose të rrezikuara të kafshëve të egra. Burimet natyrore përfshijnë naftë, gaz natyror, qymyrguri, bokside, krom, bakër, hekur, nikel, kripë, lëndë druri dhe burime ujore për hidrocentrale.

Shqipëria ka realizuar reformat të rëndësishme kushtetuese në mënyrë që të përputhë legjislacionin e saj me atë të BE. Në vitin 2001, Agjensia Kombëtare Mjedisore u riorganizua për të krijuar Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave (MMPAU), me bazë kryesore në ligjet e Mbrojtjes Mjedisore (2002) dhe Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (2003). Gjithashtu u zbatua një Plan Veprimi kombëtar me njësi me pjesëmarrje nga publiku, pas rekomandimeve të Komitetit të Ankesave të Konventës Aarhus. Megjithëse Shqipëria ka bërë një zhvillim të mirë në legjislacion, akoma nevojiten përmirësime në kapacitetet përforcuese dhe administrative, veçanërisht në nivelet rajonale dhe lokale. Gjithashtu vendi përballet me sfida të rëndësishme mjedisore dhe sociale që lidhen me rritjen ekonomike të qëndrueshme, uljen e varfërisë, shpyllëzimin, ruajtjen e biodiversitetit dhe reformat mbi pronësinë e tokës.

Proçesi i harmonizimit mjedisor i Shqipërisë me BE lejon dialogun në reformat kryesore,

duke përfshirë:

- 1 Ndërtimi i Kapaciteteve: për përmirësimin e krijimit dhe zbatimit të politikës mjedisore, bashkë me bashkëpunimin dhe koordinimin ndër-institucional;
- 2 Problemi i cilësisë së ajrit: veçanërisht në zonat urbane ku nivelet e ndotjes janë ndër më të lartat në Europë. Legjislacioni egzistues mbi ndotjen industriale është jo i zhvilluar dhe zbatimi vazhdon të jetë i dobët.
- 3 Ruajtja e biodiversitetit: Zhvillimi urban, industrial dhe i turizmit po ndikojnë ekosistemet, veçanërisht zonat në kufi me bregdetin dhe bregdetare duke shkaktuar shkatërrimin e banesave shtazore dhe botës bimore. Zbatime të mëtejshme të legjislacioneve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare mund të zvogëlojë humbjen e biodiversitetit dhe të mbrojë speciet e rrezikuara.
- 4 Plani i Ndikimit të Katastrofave Natyrore u miratua në vitin 2000, me mbështetje nga Programi për Menaxhimin e Katastrofave dhe Përgatitjen e Urgjencave (PMKPU) të PNUD-it.
- 5 Hedhja dhe djegia e mbeturinave shkakton rreziqe të mëdha mjedisore dhe shëndetësore; Shqipëria nuk ka sisteme efektive për mbledhjen, hedhjen dhe riciklimin e mbeturinave;
- 6 Drejtimi dhe Ruajtja e ujrave: ujërat sipërfaqësorë janë të ndikuara shumë nga ndotjet urbane, shtëpiake dhe industriale. Skemat e furnizimit me ujë dhe higjienës publike vazhdojnë të jenë të vjetra; dhe
- 7 Rregullimet për Masat ndaj Derdhjeve: megjithëse në vitin 1993 u miratua një plan kombëtar emergjence dhe një system për ndotjet aksidentale, akoma nuk ka në përdorim një skemë zbatuese, një politikë të përcaktuar reaguese dhe pajisje të specializuara për ndotjen në dispozicion.

Me rrezikun e rritjes së temperaturave globale dhe rasteve ekstreme të motit, Programi për Njësinë e Ndryshimit Klimaterik (PNNK) në Shqipëri është strukturuar kohët e fundit duke u fokusuar në tre fusha kryesore: inventarin e Gazit të Efektit Serrë (GES), çënueshmëritë dhe miratimet dhe financimin për zvogëlimin e GES dhe karbonit. Shqipëria nënshkroi Protokollin e Kjosos por duhet që të përfshijë çështjet mbi ndryshimin klimaterik në procesin e saj të planifikimit kombëtar dhe të politikave. Në vazhdim të masave për uljen e GES, është e nevojshme të kryhet miratimi, kryesisht nën sektoret më të çënueshme, si burimet ujore, bujqësia, ruajtja e biodiversitetit dhe turizmit.

## **2.1.5 Mjedisi Ligjor**

Mjedisi ligjor në Shqipëri vazhdon të mbetet i komplikuar dhe i vështirë megjithë reformat e rëndësishme që janë ndërmarrë. Gjatë viteve të fundit ka pasur përmirësime të rëndësishme në fushat kryesore si tregjet e letrave me vlerë, ligjet mbi qeverisjen e korporatave dhe konçesioneve të cilat nevojiteshin të gjitha në mënyrë urgjente. Si rezultat, sistemi i përgjithshëm ligjor është përmirësuar rrënjësisht dhe masat e marra kanë lejuar zhvillime në vendosjen e një sistemi ligjor që përputhet më shumë me standartet ndërkombëtare. Zbatimi efektiv i këtyre reformave të fundit ka nevojë të testohet dhe vazhdon të jetë problematik. Gjithashtu, qeveria ka nevojë të përmirësojë

kapacitetin dhe si rrjedhojë të besojë në sistemin gjyqësor dhe të zhvillojë në përgjithësi një respect më të madh për rregullat e ligjit në vend. Disa fusha të veçanta ligjore – si zbatimi derisa hipotekat kanë lidhje me të – kanë akoma një nevojë urgjente për reforma. Një pamje më e plotë e reformave ligjore në Shqipëri jepet në Aneksin II.

## ***2.2 Ecuria në fushën e tranzicionit dhe reagimi i ekonomisë***

### **2.2.1 Kushtet Makroekonomike që lidhen me operacionet e Bankës**

Duke u bazuar në politikat e përgjithshme të ekonomive të qëndrueshme, Shqipëria ka arritur një rritje të qëndrueshme prej 6.3 përqind mesatarisht ndërmjet 2005 dhe 2008. Rritja e PBB është shkaktuar kryesisht nga sektoret e shërbimeve dhe ndërtimit, duke përfutur nga rritja e shpejtë e mundësive të kreditimit. Inflacioni vjetor mbi çmimet e konsumit qëndroi brenda nivelit të normave 2 deri në 4 përqind të vendosura nga Banka e Shqipërisë në pesë vjetët e fundit dhe arriti një mesatare prej 3.4 përqind në vitin 2008 me gjithë çmimet e larta të ushqimeve dhe energjisë. Në përgjigje të rënies së prurjes së monedhës së huaj dhe kufizimin e përgjithshëm të kushteve huadhënëse, Banka e Shqipërisë e uli nivelin e politikës së saj nga 6.25 në 5.75 përqind në janar 2009. Në vitin 2008, deficilit buxhetor u rrit në 5.5 përqind, më shumë se 3.5 përqind në vitin 2007, kryesisht në sajë të zhvillimit të projekteve të infrastrukturës (duke përfshirë autostradën Kukës-Durrës). Administrimi i të ardhurave dhe menaxhimi i borxhit publik u përforcuan dhe sollën rritjen e të ardhurave nga taksat në vitin 2008 megjithë një ulje prej 10 përqind të nivelit të taksës së korporatës dhe taksës së të ardhurave personale.

Integrimi akoma i limituar i Shqipërisë në tregjet botërore dhe niveli relativisht i ulët i eksporteve (eksportet e mallrave dhe shërbimeve si pjesë e PBB-së ishte afërsisht 10 përqind gjatë viteve 2007-2008 në krahasim me një mesatare prej 28 përqind në Europën Jug-Lindore) ndihmoi për zvogëlimin e efekteve negative të krizës botërore financiare në ekonomi. Megjithatë, kriza ndikoi në një ulje të konsiderueshme të depozitave bankare (prej më shumë se 10 përqind) në tremujorin e fundit të vitit 2008, një situatë që u stabilizua në tremujorin e parë të vitit 2009. Ndërsa bankat lokale duken të pozicionuara mirë në kapërcimin e krizes aktuale në sajë të kapitalizimit të qëndrueshëm, limitimin e financimit të shitjeve me shumicë dhe raportit akoma të ulët ndërmjet huave dhe depozitave, huadhënia është bërë më e kufizuar dhe bankat po tregojnë shqetësim në rritje në lidhje me cilësinë e portofoleve të huasë. Përgjigjia e qeverisë ndaj krizës përfshiu dispozitat në lidhje me likuiditetin si edhe masat rregullatore, duke përfshirë një limit (10 përqind) mbi sasinë e parave që bankat lokale me pronësi të huaj mund të investojnë ose të depozitojnë me institucionet mëmë jashtë vendit. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka përforcuar masat mbikqyrëse. Në mars 2009, qeveria e rriti tavanin për sigurimin e depozitave nga 700,000 Lekë në 2,500,000 Lekë (afërsisht 20,000 Euro). Pas një zhvlerësimi të lekur shqiptar me rreth 5 përqind në krahasim me Euron në fillim të vitit 2009, Banka e Shqipërisë ndërhyri vazhdueshëm në tregun e shkëmbimit valutor. Megjithatë, rezervat ndërkombëtare kanë vazhduar të jenë gjërësisht të qëndrueshme në rreth katër muaj të importeve si rezultat i një politike monetare të studiuar me kujdes dhe

nivelit fleksibël të kursit të këmbimit.

Ndikimi më i madh i krizës botërore është parë në ekonominë reale si rezultat i uljes së nivelit të eksporteve (minus 17.2 përqind për një vit në gjysmën e parë të vitit 2009), remitanca më të ulëta (minus 29 përqind në tremujorin e parë të vitit 2009) dhe më pak investime direkte të huaja ose hua në dispozicion për investime. Si rezultat pritet se ekonomia do të arrijë përqindje ekonomike shumë më të ulët - por akoma pozitive në vitet 2009-2010, me pak rritje në papunësi. Problemet më të rëndësishme makroekonomike përfshijnë defiçitin e madh tregëtar (26.7 përqind të PBB-së në vitin 2008) dhe një defiçit llogarie me dy shifra (rreth 14.9 përqind të PBB-së në vitin 2008).

Ndërsa borxhi i jashtëm është i menaxhueshëm në rreth 18 përqind të PBB-së, barra e borxhit qeveritar vazhdon të jetë e lartë, mbi 50 përqind, në 54.9 përqind të PBB-së. Risqet fiskale vazhdojnë ndërsa qeveria vazhdon të subvencionojë shërbimet shtetërore me performancë të ulët - ujin, prodhimin dhe transmetimin e energjisë- dhe shpesh të ardhurat nuk i mbulojnë dot shpenzimet e nevojshme të mirëmbajtjes dhe investimet. Afrimi i vazhdueshëm në BE, i cili u finalizua me një kërkesë formale për anëtarësim në BE, si edhe anëtarësimi i kohëve të fundit në NATO, kanë përmirësuar imazhin e Shqipërisë si një vend i mundshëm për investime dhe do të kontribuojnë në një rikthim të rritjes në gjysmën e dytë të vitit 2010.

Qeveria pritet të vazhdojë investimet sektorët kryesorë të infrastrukturës në sajë të ndikimit të madh pozitiv që krijojnë këto projekte në ekonomi. Për shembull, që në vitin 2009, vendi po sheh ndikime pozitive nga përfundimi i autostradës Durrës-Kukës, me një numër më të lartë të raportuar për turistët në bregdetin e Shqipërisë. Duke zvogëluar kohën e udhëtimit nga Kosova në Durrës ose Tiranë nga 7-8 orë në më pak se 3 orë, autostrada do të bëhet një nxitje kryesore për aktivitetin ekonomik me portet e Durrësit dhe Shëngjinit me mundësi të mëdha për tu bërë lidhje të rëndësishme për të gjithë rajonin e Ballkanit.

## 2.2.2 Suksesi dhe sfidat e tranzicionit

**Sektori i ndërmarrjeve dhe konkurrenca:** Një progres i madh është kryer në lidhje me privatizimin e ndërmarrjeve të mëdha, që ka shkaktuar rritjen e konkurrencës. Përveç shitjes së 76 përqind të aksioneve të shoqërisë së shpërndarjes elektrike (shihni seksionin e infrastrukturës më poshtë), gjithashtu qeveria shiti 85 përqind të aksioneve të Shoqëria Shqiptare e Rafinerisë së Naftës, ARMO. Në vitin 2007, operatori kombëtar i telekomit, Albtelekom (së bashku me një licencë të telefonisë celulare, e treta në vend) iu shitën Calik Group, Turqi. Vendi ndërkohë po përfiton shërbime më të mira dhe tarifa më të ulëta i mbështetur nga financimi i Bankës. Gjithashtu qeveria shiti aksionin e vet të vogël të mbetur tek AMC, operatori kryesor celular në Shqipëri.

Biznesi i vogël vazhdon të punësojë një pjesë të madhe të popullsisë dhe një pjesë e rëndësishme e aktivitetit të biznesit vazhdon të jetë informale (megjithse është e pamundur të llogaritet niveli i saktë). Qeveria ka punuar për angazhimin e shoqërive në



sektorin formal nëpërmjet prezantimit të një takse uniforme prej 10 përqind mbi shoqëritë e mëdha dhe të ardhurave personale si edhe rregullit që të gjitha pagesat, duke përfshirë edhe rrogat duhet të bëhen nëpërmjet bankave. Si rezultat, nga ekonomia formale po shihet një përqindje më e lartë e PBB-së. Investimet e Bankës nxitën këtë proces formaliteti duke mbështetur shoqëritë që tregonin gatishmërinë e tyre për të punuar në mënyrë formale. Megjithatë, në etapën e fundit të Studimit të Mjedisit të Biznesit dhe të Performancës së Ndërmarrjeve (BEEPS IV), shoqëritë vazhdojnë të raportojnë se konkurrenca me shoqëritë që veprojnë jo në mënyrë të ligjshme plotësisht është një pengesë serioze që ndikon në veprimtaritë e tyre. Shoqëritë vazhdojnë të raportojnë një zbatim të dobët të ligjit dhe korrupsion, duke përfshirë në gjykata, licencat dhe lejet si pengesat kryesore të zhvillimit të biznesit. Në sektorin e agrobiznesit ka mbaruar rishpërndarja e tokës shtetërore bujqësore, por akoma ka toka që nuk përfitojnë nga të drejtat e pronës - procedurat ligjore dhe administrative për zgjidhjen e pronësisë janë mjaft të dobëta dhe proceset e rikthimit janë të pambaruara. Në mënyrë për tu bërë më shumë konkurrues, fermerët duhet të konfirmojnë hartat e tokës së tyre.

**Përmirësimi i infrastrukturës:** Një arritje është kryer në zgjerimin e strukturave të tregut duke bërë ndarjen e ndërmarrjeve në sektorin privat. Në vitin 2007, sektorët e transmetimit dhe shpërndarjes së KESH, shoqërisë shtetërore energjitike u ndanë dhe u riorganizuan si shoqëri të veçanta aksionare. Në prill 2009, parlamenti miratoi shitjen e 76 përqind të aksioneve të shoqërisë të shpërndarjes së energjisë tek grupi çek i energjisë CEZ. Pjesëmarrja e sektorit privat për prodhimin e energjisë është rritur (dhe qeveria po punon për të miratuar konçesionet e HPP të vogla dhe të mëdha). Rregullat e tregut janë miratuar për të siguruar sistemin e nevojshëm për hapjen dhe funksionimin e tregut për shitje me shumicë dhe pakicë. Nga janari 2008, të gjithë konsumatorët jo vendas iu dha e drejta për të zgjedhur furnizuesit e tyre. Megjithatë, konkurrenca efektive është limituar deri tani dhe Autoriteti Rregullator i Energjisë sapo ka filluar të përforcohet si një rregullator efektiv dhe i pavarur. Në mars 2008, tarifat e energjisë elektrike u rritën me 15 përqind por ato akoma nuk mund të reflektojnë të gjitha kostot. Megjithatë, me krijimin e shoqërisë shpërndarëse DISCO të menaxhuar në mënyrë private dhe vendosjen e tarifave më të larta të energjisë, shoqëritë dhe individët janë më të interesuar për të ulur përdorimin e energjisë. Qeveria mund të bashkëpunojë me donatorët për gjetjen e mënyrave për të mbështetur nismat për efikasitetin e energjisë.

Në sektorin e transportit, ka pasur përpjekje për ristrukturim në vitet e fundit, dhe në vitin 2008 u miratua një plan ristrukturues për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve (DPRR). Qeveria ka bërë një arritje të rëndësishme në rindërtimin e rrjeteve rrugore megjithëse sektori ka nevojë për investime të mëtejshme. Përmirësimet e mëdha përfshijnë rrugën kryesore nga Aeroporti i Tiranës në Tiranë, si edhe autostradat në Veri (për në Shkodër) dhe në Jug (në Vlorë dhe Sarandë) dhe Jug-Perëndim (në Korçë dhe Pogradec). Ndërkohë qeveria ka investuar 800 milion Euro për rrugën e re në Kosovë, me shpresën e krijimit të rrugëve të reja të eksportit për të gjithë rajonin e Ballkanit nëpërmjet porteve të Durrësit dhe Shëngjinit. Përmirësimet e rrugës po shfaqin një ndikim në të gjithë sektorët e ekonomisë - turizëm, agrobiznes, industrinë e përgjithshme - duke e bërë më të lehtë transportin e njëzëre dhe të mallrave në tregjet e synuara.

Një zhvillim tjetër i rëndësishëm ishte konçesioni i dhënë për rehabilitimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës. Projekti tregoi përfitimet e përfshirjes së sektorit privat në zhvillimin e infrastrukturës publike. Deri tani, Banka ka financuar dy fazat e modernizimit dhe zgjerimit dhe projekti e kreu fazën e vet të zhvillimit më shpejt sesa ishte parashikuar. Gjithashtu qeveria diskutoi idenë e rritjes së pjesëmarrjes së sektorit privat në sektorin e porteve. Veprimtaritë private janë përfshirë në projektin e Porto Romano dhe në Vlorë të cilat po zhvillohen si terminale për importin e lëndëve djegëse. Gjithashtu, Durrësi dhe Vlora mund të zhvillohen si terminale për pasagjerët dhe ngarkesat, por Qeveria duhet të fokusohet më shumë në këtë sektor nëse këto mundësi realizohen. Investimi i Bankës në Terminalin e Durrësit po vazhdon, megjithëse me ngadalësi.

Ka patur reformë të limituar në sektorin e hekurudhave, megjithëse ristrukturimi i forcës punëtore ndryshoi numrin e punëtorëve nga 8,800 në vitin 1989 në 1,900 në vitin 2008. Ka mundësi për reformë të mëtejshme dhe investim dhe qeveria ka filluar diskutimet me KE nëpërmjet IPA dhe Bankës mbi financimin e sektorit në vitin 2010- 2011. Dispozitat për shërbimet efëçente bashkiake - transport, ujeshjellës dhe kanalizime - varen nga reforma të rëndësishme, duke përfshirë rritjen e tarifave, komercializimin dhe sistemin rregullator të duhur. Përfundimisht, autoritetet bashkiake në Tiranë planifikojnë investime në rrjetin kryesor rrugor për përmirësimin e qarkullimit dhe uljen e nivelit të mbingarkesës në qëndrën e qytetit.

**Zhvillimi i sektorit financiar:** Sektori bankar është zhvilluar shumë në vitet e fundit, të paktën para shfaqjes së krizës botërore financiare. Në fund të vitit 2008, mjetet e sektorit bankar ishin rreth 86 përqind të PBB megjithëse kreditë totale të bankare janë vetëm 37 përqind e PBB, që nënkupton një hapësirë të madhe për rritjen e huadhënies. Ka 16 banka tregëtare, prej të cilave 14 kanë pronësi të huaja në përmasa të rëndësishme, dhe dy të tjerat kanë pjesëmarrje në minoritet nga IFN. Sektori dominohet nga disa banka të mëdha ku përfshihen Raiffeisen International, Intesa Sanpaolo dhe Soci t  G n rale. Zbatimi i një ligji të ri bankar në vitin 2007 ndikoi në përmirësimin të mbikqyrjes, licensat dhe rregullat e degës së jashtme si edhe menaxhimin e kujdesshëm dhe menaxhimin e riskut. Përmirësimin të mëtejshme në transparencën e sistemit bankar rezultuan pas një krijimi të një regjistri të ri kredish i cili hyri në veprim në 1 janar 2008.

Kriza financiare botërore po ndikon në këtë sektor megjithëse në një nivel më të ulët sesa në vendet e tjera të rajonit, në sajë të nivelit të ulët të integritit të Shqipërisë dhe një niveli relativisht të lartë të likuiditetit dhe kapitalizimit. Banka e Shqipërisë ka bërë një punë të mirë për monitorimin e risqeve të kredisë dhe në 2008 lëshoi urdhra që ngadalësonin rritjen në një mënyrë, veçanërisht për huatë në valutën e huaj. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë zhvilloi më tej regjistrin e kredive që po ndihmon bankat të monitorojnë huamarrësit e tyre. Kjo do të jetë shumë e rëndësishme për rastet kur huamarrësit mund të preken nga kriza botërore financiare, që është parë ndërkohë në përkeqësimin e kapaciteteve të tyre pagueuse, me huatë e këqija (hua që kanë tejkaluar kohën e shlyerjes me më shumë se 90 ditë) dhe që dyfishohen në 12 muajt e fundit. Në përgjigje të krizës, tavanin e sigurimit të depozitave u rrit nga 700,000 Lekë në 2,500,000 Lekë në mars 2009.

Sektori financiar jobankar është akoma në hapat e para, duke përfshirë sektorin e sigurimeve ku sigurimi i mjeteve motorike përbën një pjesë të rëndësishme të tregut në përgjithësi. Ka pasur progres gjatë vitit të kaluar për zbatimin e masave për rritjen e kapacitetit mbikqyrës të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare ku kanë dhënë ndihmesë Banka dhe Banka Botërore. Banka dhe KFN hoqën aksionet e tyre tek INSIG para privatizimit të planifikuar. Ndërsa ky nuk u arrit, INSIG është përsëri pronë 100 përqind e qeverisë dhe mund të nxirret përsëri në shitje në një kohë tjetër. Nuk ka treg për rritjen e fondeve ose tregëtimin e obligacioneve dhe/ose aksioneve.

Në kuadrin e çështjeve të diskutuara më lart, **sfidat kryesore gjatë periudhës së strategjisë së re janë të:**

- 1 Përforcimi i institucioneve shtetërore (administrata publike dhe reforma e shërbimit civil), veçanërisht rritja e efikasitetit dhe paanshmërisë së gjyqësorit dhe një luftë efektive dhe sistematike kundër korrupsionit;
- 2 Përmirësime të mëtejshme në klimën e investimeve për shoqëritë vendase dhe të huaja, duke përfshirë vendimin mbi regjistrimin e tokave dhe pronësinë, dhe përmirësimin e procedurave të regjistrimit të tokës;
- 3 Investime të mëtejshme në infrastrukturë, duke përfshirë përmirësimin e rrjeteve rrugore kombëtare, rajonale dhe lokale, modernizimin dhe zgjerimin i porteve detare, dhe përmirësimin e sigurisë energjitike;
- 4 Rritja e përpjekjeve për privatizimin e shërbimeve të ujësjellës dhe kanalizimeve si edhe transportin urban, duke i dhënë ndërkohë autonomi më të madhe fiskale bashkive që mund të planifikojnë dhe investojnë në këto sektorë;
- 5 Rritja e pavarësisë dhe kapaciteteve të rregullatorëve të shërbimeve kryesore (energji, telekom, dhe shoqëritë e ujësjellës kanalizimeve) për të nxitur konkurrencën dhe investimin;
- 6 Përforcimin e mëtejshëm të sistemit bankar, mbështetjen e NVM-ve/NMV-ve dhe financimin e bankar të këtyre shoqërive për rritjen e konkurrencës për të ulur varësinë e madhe që ka Shqipëria mbi mallrat e importuara dhe rritjen e mundësive të eksportit; dhe mbështetjen e zhvillimit të sektorit financiar jobankar, duke përfshirë rritjen e mëtejshme kapacitetin mbikqyrës së Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare.
- 7 Qeveria dhe donatorët mund të punojnë bashkë për të siguruar nxitje për shoqëritë dhe individët që kërkojnë të ulin përdorimin e energjisë elektrike; dhe
- 8 Mbështetja e zhvillimit të sektorit financiar jobankar, duke përfshirë rritjen e mëtejshme të kapaciteteve mbikqyrëse të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare.

## **2.3 Mundësia e marrjes së kapitalit**

Shqipëria përfiton të ardhura të rëndësishme nga asistenca zyrtare ndërkombëtare, 3-4 përqind të PBB në vitet e fundit. Të ardhurat nga IHD janë akoma relativisht të vogla, 653 milion euro në vitin 2008 ose rreth 7 përqind të PBB, kryesisht në sajë të privatizimeve. Shuma progresive e **aksioneve** të IHD arriti 3.2 miliard USD në fund të vitit 2008, ose rreth 20 përqind e PBB që është më pak se gjysma e mesatares në Europën Jug-Lindore. Tregëtia me shumicë, veshjet, industria e këpucëve, agrobiznesi dhe ndërtimi përbëjnë pothuajse gjysmën e **aksioneve** të IHD, ndërsa industria prodhuese përbën rreth 40 përqind. Gjithashtu janë disa investitorë të huaj që veprojnë në sektorin e minierave dhe përpunimit të mineraleve me anën e konçesioneve afatgjata. Italia është burimi kryesor i IHD, që përbën më shumë se gjysmën, e ndjekur nga Greqia dhe Turqia.

Në qershor 2007, Moody i caktoi Shqipërisë vlerësimin e parë në vend 'Ba1' për obligacionet në valutë të huaj, e cila u konfirmua në janar 2009. Marrëveshja 3-vjeçare e Shqipërisë me FMN mbaroi në janar 2009. FMN tani po vazhdon të monitorojë zhvillimet ekonomike të Shqipërisë dhe të ofrojë këshilla, veçanërisht në lidhje me sistemin fiskal afatmesëm. Në vitin 2008 Shqipëria u riklasifikua si vend me të ardhura mesatare sipas standarteve të AZZH. Shqipëria nuk ka lëshuar Eurobond por ka marrë dy herë nga sindikata ndërkombëtare e bankave - në fillimin e vitit 2008 dhe në maj 2009 (kjo e fundit në shumën 250 milion Euro) për të financuar investimet publike.

Në Shqipëri nuk ka tregëti aksionesh dhe këmbimi bëhet vetëm me valutë dhe obligacione qeveritare. Një BT i Bankës është në proces për të ndihmuar të përmirësohet sistemi rregullator në lidhje me lëshimin e obligacioneve të korporatave dhe atyre bashkiake. Egziston një interes i limituar nga fondet me pjesëmarrje në kapital të vet në ndërmarrjet lokale, megjithëse disa janë duke vepruar mbi bazën e rasteve të veçanta.

Shqipëria ka përfituar nga remitancat e larta në vitet e fundit, që kanë ndihmuar financimin e investimeve të vogla veçanërisht në sektorin e pronave. Kriza financiare botërore mund të ndikojë në sektorin financiar dhe ekonominë më gjërë nëpërmjet uljes së remitancave, pakësimit të depozitave dhe një rritje e përgjithshme më e ngadaltë ekonomike megjithëse bankat nuk janë akoma të shqetësuara shumë në lidhje me likuiditetin.

## **3. ORIENTIMET STRATEGJIKE**

### ***3.1 Prioritetet e Bankës për peridhën e mbuluar nga strategjia***

Deri në gjysmën e 2009, ekonomia shqiptare është në nivele relativisht të mira në krahasim me vendet e tjera ku vepron BERZH pavarësisht nga ndikimi negativ i krizës financiare botërore. Megjithatë, gjatë Strategjisë aktuale, Banka duhet të përgatitet të zgjidhë çështje që lindin si rezultat i krizës, duke përfshirë ndikimin e niveleve të ulëta të remitancave dhe investimeve, si edhe një tërheqje më të madhe nga bankat për të zgjeruar huadhënien e tyre në ekonominë reale. Gjithashtu, Banka mund të përballet me një rritje të kërkesës nga sektori bankar dhe do të mbetet një nga burimet kryesore të kapitalit për ndërmarrjet ndërkombëtare dhe vendase. Në sajë të përmasave të mjaft shoqërive investuese, LEF do të vazhdojë të ketë rëndësi gjatë peridhës së strategjisë së re. Mbështetja e shoqërive mikro, të vogla dhe mesatare është mjaft e rëndësishme për zhvillimin e vazhdueshëm afatgjatë të Shqipërisë dhe veçanërisht për të zvogëluar varësinë e lartë nga importet dhe për të rritur konkurrencën e eksporteve.

Rritja e ekonomike varet gjithashtu nga investimet e mëtejshme në energjitikë, transport, sektorin bashkiak, sektorin mjedisor dhe telekom. Megjithatë, në sajë të hapësirës së limituar fiskale, një pjesë e madhe e këtyre investimeve duhet të ndërmerren nga sektori privat ose në mënyrë të pavarur ose nën PPP. Banka do të bashkëpunojë me donatorë të tjerë dhe IFN për të siguruar ndikimin më të plotë dhe përfitimin për ekonominë.

Në të gjithë projektet e saj dhe dialogun e politikave, Banka do të nxitë konkurrencën, transparencën dhe standartet e larta të qeverisjes së korporatave dhe drejtimit të biznesit si edhe praktikë të mirë mjedisore.

Për sa i përket më lart, operacionet e Bankës gjatë periudhës së strategjisë do të fokusohen në prioritetet kryesore të mëposhtme: (i) financimin e projekteve të transportit, bashkiake, energjitike dhe mjedisore; (ii) sigurimi i fondeve në sektorin financiar për huadhënie; (iii) financimet direkte për ndërmarrjet e huaja dhe lokale më përpjeke të vazhdueshme për të arritur NVM; dhe (iv) dialogun e politikës veçanërisht duke punuar me qeverinë e re për të zgjidhur problemet rregullatore dhe ato në infrastrukturë. Këto fusha prioriteti të operacioneve paraqiten më tej më poshtë.

## **3.2 Sfidat sektorale dhe objektivat e Bankës**

### **3.2.1 Infrastruktura dhe energjitika**

**Qëllimet e Tranzicionit:** Rritja e integritit rajonal të vendit në Ballkanin Perëndimor, duke u fokusuar në projektet kritike rajonale në transport (veçanërisht në korridoret kryesore pan-Europiane) dhe energji (në pikëpamjen e nevojës për të zhvilluar dhe zbatuar Komunitetin e Energjisë të Europës Jug-Lindore). Rritja e pjesëmarrjes së sektorit privat në këtë sektor dhe të sigurohet zbatimi i qëndrueshëm i konçesioneve të dhëna së fundmi për prodhimin e energjisë në mënyrë që të rritet siguria energjitike dhe të ulët varësia e vazhdueshme e Shqipërisë për importin e energjisë. Mbështetja e reformave mbi tarifën e energjisë elektrike në mënyrë që të zvogëlohen humbjet thuajse-fiskale dhe të lehtësohet hapja e tregut. Në sektorin bashkiak, të nxitet komercializimi i shërbimeve publike, prezantimi i skeme të duhur rregullatore dhe ti jepet autonomi më e madhe financiare bashkive nën sistemin rregullator efektiv. Përmirësimi i mëtejshëm i rrjetit të rrugëve të transportit, duke përfshirë përfundimin institucional, reformimin e menaxhimit financiar dhe mirëmbajtjen e rrjetit të rrugëve. Atje ku është e mundur dhe e realizueshme, të zhvillohet më tepër përfshirja e sektorit privat në çështjet e menaxhimit të rrugëve dhe përmirësimit të sektorit të porteve.

#### **Prioritetet Operacionale**

**Energjitika:** Në sajë të investimeve në rrjetin e transmisionit të financuar nga Banka, IFN-të e tjera dhe donatorë dypalësh, rrjeti i përgjithshëm është bërë më i qëndrueshëm. Pas blerjes të shoqërisë shpërndarëse, CEZ pritet të investojë për zvogëlimin e humbjeve dhe uljen e shpërndarjes së energjisë së pafaturuar. Investime të mëtejshme nevojiten për rehabilitimin e sistemit dhe për të ndihmuar në efikasitetin/zhvogëlimin e humbjeve në transmetim. Banka do të bashkëpunojë me qeverinë për të përmirësuar zbatimin e projekteve egzistuese, si për përmirësimin e nënstacioneve të energjisë dhe sistemeve të transmisionit dhe të financojë investimet e nevojshme për përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes, i cili do të zvogëlojë humbjet dhe do të rritë efikasitetin në të gjithë sistemin.

Banka do të vlerësojë punën me investitorët privatë për realizimin e konçesioneve të hidrocentraleve energjitike. Kjo përfshin investime të nevojshme prioritare dhe të sigurta në digat në lumenjtë Drin dhe Mat, ku Banka është përgatitur të financojë bashkë me IFN-të tjera dhe donatorë. Gjithashtu ajo do të konsiderojë mbështetjen e zbatimit të projekteve për zhvillimin e formave të tjera të energjisë së rinovueshme si p.sh era për të përmirësuar sigurimin e energjisë. Për më tepër, Banka kreu një studim për kërkesën e energjisë të shoqërive industriale në 2006, rezultatet e të cilës do të krijojnë të dhëna fillestare për zhvillimin e WeBSEDF që është krijuar për të përmirësuar efikasitetin e energjisë në të gjithë sektorin e biznesit.

Banka do të studiojë çështjet e ndryshimit të klimës në lidhje me energjinë dhe projektet e tjera si pjesë e *due diligence* dhe monitorimit.

**Transport:** Banka do të vazhdojë të mbështetë përmirësimin e rrjetit të transportit në Shqipëri duke u fokusuar në lidhjet rajonale dhe në integrimin rajonal, për të lehtësuar tregëtinë dhe rritjen ekonomike dhe gjithashtu do të rishikojë mundësitë për krijimin e aktiviteteve për lidhjen e mënyrave kryesore të transportit.

Banka do të vazhdojë të mbështesë përmirësimin dhe rehabilitimin e seksioneve prioritare të rrjeteve rrugore kombëtare, rajonale dhe lokale dhe do të vazhdojë të bashkëpunojë ngushtë me donatorë të tjerë dhe IFN që janë aktive në këtë sektor për të ndihmuar realizimin e zbatimit dhe të rritë fondet e përgjithshme në dispozicion në këtë sektor. Gjithashtu, banka mund të sigurojë bashkëpunim të mëtejshëm teknik për të mbështetur reformën në sektor, për shembull zhvillimin e sistemeve të planifikimit dhe buxhetore të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

Atje ku është e mundur dhe e realizueshme, Banka do të mbështetë përfshirjen më të gjërë të sektorit privat në zhvillimin e infrastrukturës së transportit, p.sh nëpërmjet PPP dhe formave të konçesionit për financim në sektorin e porteve dhe rrugëve. Gjithashtu, kjo do të përfshijë financimin e investimeve publike dhe/ose private në shërbimet që fokusohen në shpërdarjen dhe programet që lidhen me portet, rrugët dhe terminalët e hekurudhave. Operacione të tilla do të jenë veçanërisht të përshtatshme në Shqipëri në sajë të varësisë së saj të lartë ndaj importeve dhe nevojës për të mbështetur dhe shtuar shoqëritë e orientuara nga eksporti.

Duke vazhduar financimin për terminalin e pasagjerëve në Portin e Durrësit, Banka synon të vazhdojë dialogun e saj me qeverinë për strategjitë për portet e Durrësit, Vlorës, Porto Romanos dhe Sarandës, të cilat duhet të synojnë komercializimin e operacioneve të portit dhe të zgjerojnë përfshirjen në sektorin privat. Serisht, sektori i porteve është vendi i duhur për zhvillimin e reformave tregëtare dhe zgjerimin e përfshirjes të sektorit privat.

Gjithashtu, Banka do të zgjerojë dialogun e saj dhe të zbulojë mundësi të zhvillojë projekte ekonomikisht të suksesshme në sektorin e hekurudhave. Ky sektor mund të kontribuojë në mënyrë efektive në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të Shqipërisë duke mbështetur aktivitetet e importit dhe eksportit.

**Infrastruktura Bashkiake dhe Mjedisore:** Projektet e suksesshme si projekti i ujësjellësit në Korçë i financuar nga KfW dhe përmirësimi i venddepozitimit të Sharrës në Tiranë, janë të rralla. Megjithëse aftësia e Bankës dhe e huadhënësve lokalë për të financuar projekte në infrastrukurën bashkiake është e kufizuar në sajë të përmasave të projektit dhe gjithashtu nga mundësia financiare e autoriteteve dhe shërbimeve lokale (të cilat nuk kanë pavarësi/të ardhura buxhetore të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet), huatë nën-qeveritare për bashkitë, të lejuara vetëm në 2008, duhet të kryhen.

Pas kryerjes së huasë së parë shtetërore me Bashkinë e Tiranës, Banka po krijon një hua të dytë bashkiake për zhvillimin e rrugëve urbane. Kjo hua mund të realizohet pa garanci qeveritare që do të jetë një nga shembujt e parë në Shqipëri. Investimet në shërbimet

bashkiake si ujësjellësin dhe transportin publik mund të arrihen në vazhdim me përmirësimet rregullatore për të lejuar strukturat bankare në autoritetet nën-qeveritare.

Banka do të konsiderojë sërisht mundësinë për të punuar me bashkitë më të mëdha, Tirana, Shkodra, Vlora, Fier dhe bashki të tjera më të vogla për projekte prioritare - me një vëmendje të veçantë në sistemin e ujësjellës dhe kanalizimeve. Normalisht, hua të tilla do të kërkojnë mbështetjen e garancive qeveritare dhe gjithashtu të koordinohen me partnerët kryesorë shumëpalësh dhe dypalësh, të cilët punojnë në këtë sektor, duke përfshirë PNUD, Banka Botërore, Austria, Zvicra, Gjermania, Italia dhe të tjerë.

**Burimet Natyrore:** Banka do të vazhdojë të monitorojë sektorin e burimeve natyrore dhe të vlerësojë investimet private që përputhen me standartet e larta të qeverisjes dhe drejtimin e biznesit si edhe përdorimin e teknologjive dhe metodave me praktikën më të mira në sektorin e minierave. Përfshirja e shoqërive botërore të minierave në këtë sektor duhet të inkurajohet nëse shihet për të mbështetur rezultate të rëndësishme dhe të qëndrueshme mjedisore. Projektet e industrisë nxjerrëse do të jenë pjesë e due diligence mjedisore dhe sociale, në përputhje me Kërkesat e Performancës dhe Politikës, standartet e BE dhe Shqipërisë si edhe praktikën e mira ndërkombëtare. BERZH është pjesë e Iniciativës për Transparencë të Industrisë Nxjerrëse (ITIN) për të siguruar transparencën e pagesave të projekteve të industrisë nxjerrëse tek qeveria.

### 3.2.2 Sektori i Ndërmarrjeve

**Qëllimet e Tranzicionit:** Të rritet disponueshmëria e financimit me hua dhe pjesëmarrje në kapital të vet për ndërmarrjet vendase si rezultat i uljes së huadhënies nga bankat vendase dhe për të kontribuar në zgjerimin e eksportit të vendit, duke përfshirë edhe një rritje të përqindjes së mallrave me vlerë të shtuar më të lartë. Të mbështetë investimet pas privatizimit në sektorët e energjitikës, burimeve natyrore dhe telekomit dhe tërheqja e IHD në këtë sektorë dhe në sektorë të tjerë industrialë. Mbështetja e zgjerimit të tregut për prona moderne tregëtare në të gjithë nën-segmentët dhe rritja e potencialit afatgjatë të Shqipërisë si një destinacion për turizmin duke përfshirë edhe progresin e mëtejshëm në reformën e pronave.

#### Prioritetet Operacionale

Banka vazhdon të shihet si një institucion drejtues për mbështetjen e konkurrencës në ekonomi dhe të financojë investime më të mëdha, vendase dhe ndërkombëtare. Banka ka mbështetur shoqëritë e mëdha si Altelekom, përpara dhe pas privatizimit. Financimi i mëtejshëm i shoqërive të privatizuara, duke përfshirë shoqërinë shpërndarëse DISCO që iu shit CEZ-it të Republikës Çeke do të shqyrtohet. Është e njohur që mbështetja e Bankës do të jetë një burim kryesor për financimin e investitorëve të mëdhenj të intersuar të nxitin operacionet në Shqipëri. Banka do të nxitë sektorin privat nëpërmjet financimit të shoqërive egzistuese, projektet e kryera për herë të parë dhe/ose blerjen e projekteve. Në sajë të nivelit të ulët të investimeve të huaja direktë, Banka do të zgjerojë më tepër përpjekjet e saj për tu lidhur me shoqëritë e vogla dhe mesatare ose direkt, nëpërmjet LEF



dhe projektit të ri të BERZH Programi i Linjës së Kredisë për Eficencën e Energjisë së Qëndrueshme për Ballkanin Perëndimor (WeBSEECLF). Një fushë tjetër për zhvillimin e bizneseve do të jetë ndërmjet shoqërive rajonale që investojnë në Shqipëri dhe mbështetja e shoqërive shqiptare për tu zgjeruar në tregjet fqinje.

Banka do të përpiqet të zgjerojë aktivitetet e investimit të saj në sektorë ku Shqipëria ka avantazhe relative në eksportose atje ku është aktualisht e varur nga importet. Këto përfshijnë agrobiznesin (duke përfshirë përpunimet, programimin dhe shpërndarjen e mallrave me pakicë), tekstilet/përpunimet, burimet natyrore, prona dhe materiale ndërtimi. Sërisht, LEF dhe WeBSEDFD duhet të jenë mekanizma efektive për të financuar nëpërmjet ndërmarrjeve vendase. Produktet e reja do të krijohen për të financuar efikasitetin e energjisë dhe energjitë e qëndrueshme si edhe të mbështetin shoqëritë që po zhvillohen në sektorin e Teknologjisë së Informacionit.

Sektorin e pronave ka mundësi të tronditet sepse shoqëritë që po krijoheshin në mënyrë spekulative në sajë të gjetjes së financimit të lirë mund të mos jenë në gjendje të vazhdojnë operacionet. Megjithatë, ndërsa sektori nuk kishte mbi përdorim të huave si në vendet e tjera të rajonit, Banka duhet të jetë në gjendje të vazhdojë disa aktivitete tradicionale në sektorin e pronave. Në këtë mënyrë, Banka do të mbështetë projektet që rritin infrastrukturën e pasurive të patundshme, veçanërisht ato që përirësojnë efikasitetin e tregëtisë me pakicë (shitje me pakicë dhe përpunim) dhe efikasitetin e ndërmarrjeve. Në sektorin e turizmit, fusha për financim të mundshëm përfshijnë resorte turistike dhe projekte të tjera ku sponsorë me eksperiencë bashkëpunojnë me operatorë të fuqishëm.

Në fushën e telekomit, Banka do të vazhdojë të mbështetë operatorët e linjave fikse dhe telefonisë celulare, duke përfshirë operatorin e katërt të telefonisë celulare, dhe do të nxitë liberalizimin e mëtejshëm të rregullatorit për të lehtësuar prezantimin e teknologjive të reja, duke përfshirë *WiMax* dhe *broad band*, që do të ofrojnë mënyra të reja për shpërndarjen e informacionit dhe të dhënave. Për më tepër, Banka po krijon produkte të reja për të mbështetur efikasitetin e energjisë për operatorët e telefonisë celulare, duke u bazuar në modelet e prezantuara në vendet e tjera ku vepron Banka.

### **3.2.3 Sektori Financiar**

**Qëllimet e tranzicionit:** Përmirësimi i disponueshmërisë së kapitalit të riskut dhe financimit afatgjatë për bizneset private, duke synuar kryesisht sektorin e NMVM-ve dhe projektet mbi efikasitetin e energjisë dhe energjisë së rinovueshme. Përmirësimi i mëtejshëm i mjedisit rregullator, duke përfshirë regjistrin e kredive, agjensinë mbi siguracionin e depozitave dhe përmirësimin e mëtejshëm ligjin dhe procedurat mbi falimentimin. Shtrirja e sektorit të sigurimeve, veçanërisht për prodhimet jetike dhe zhvillimin e institucioneve financiare jobankare si shoqëritë e huadhënies së aktiveve (lizingu) si edhe tregjet e kapitalit duke përfshirë përforcimin e rregullatorit të tregut të letrave me vlerë. Në kuadrin e pasigurisë që vjen nga kriza financiare botërore dhe ndikimi i mundshëm në sistemin bankar, të sigurohet politika e duhur dhe fondet e nevojshme si përgjigje nëse bankat do të kërkojnë mbështetje.

## **Prioritetet Operacionale**

Banka po monitoron aktivisht partnerët egzistues bankarë dhe vazhdon të ketë bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë për të siguruar që do të ketë një reagim të shpejtë nëse do të ketë nevojë të madhe për financimi dhe/ose kapital. Veçanërisht, Bankës mund ti kërkohet të zgjerojë investimet me pjesëmarrje në kapital të vet, thuajse kapital të vet dhe huaje për bankat që deri tani janë mbështetur mbi rritjen e depozitave për të financuar rritjen e bilancit.

Bankat janë bërë më pak të prirura ndaj riskut dhe po kërkojnë diversifikim më të madh të portofoleve të tyre. Në këto kushte, Banka do të intensifikojë përpjekjet e saj për të ofruar Linja Mesatare Bashkëfinancuese (LMB) dhe produkte të tjera që ndajnë riskun të cilat synojnë sigurimin e huadhënies së vazhdueshme për ekonominë reale dhe në të njëjtën kohë përforcimin e profilit të riskut të bankave si edhe politikat dhe procedurat e tyre huadhënëse.

Ndërsa një nga sfidat më të mëdha do të jetë ruajtja e nivelit të huadhënies dhe si rezultat lehtësimi i ndikimit të krizës, Banka do të kërkojë të krijojë produktet e duhura huadhënëse, dhe atje ku është e mundur e bashkërenduar me burime të varura nga fonde donatorësh, për mbështetjen e zhvillimit të NVM-ve dhe NMVM-ve si edhe për projektet për efikasitetin e energjisë dhe energjisë së rinovueshme. Atëherë kur do jetë e nevojshme, këto investime do të shoqërohen me asistencë teknike për një mënyrë më efektive për dhënie dhe ndikimit të tranzicionit në situatën pas krizës.

Banka do të kontribuojë në zhvillimin e sektorit financiar jobankar. Banka i ka siguruar një BT Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare mbi çështjet si siguri dhe zhvillimi i infrastrukturës ligjore dhe teknike për lëshimin e obligacioneve. Ky projekt do të përfundojë dhe Banka mund të punojë me partnerët e vet bashkiakë dhe të korporatave për të testuar mundësinë e lëshimit të obligacioneve. Përfundimisht, Banka do të punojë me Bankën e Shqipërisë, për të siguruar këshilla mbi politikën për çështjet e synuara, si p.sh siguri i depozitave dhe mbikqyrja e sektorit financiar.

### 3.2.4 Dialogu për Politikat

Në lidhje me të gjithë sektorët e sipërpërmendur, Banka do të ruajë një dialog aktiv me qeverinë, Bankën e Shqipërisë, komunitetin e donatorëve si edhe komunitetin e bizneseve për përforcimin e mëtejshëm të institucioneve shqiptare dhe për të nxitur mjedisin e sektorit privat për të përparuar. Kjo mund të përfshijë çështje kryesore si reformat në sektorin e pronave dhe planifikimi bashkiak dhe/ose në infrastrukturë. Përmirësimet në sistemin rregullator për të mundësuar investimet në infrastrukturë do të vazhdojnë të jenë një objektivi kryesor i përpjekjeve për dialogun e politikave të Bankës. Fushat e veçanta ku Banka mund të fokusohet më plotësisht në periudhën e ardhshme janë:

- 1 Identifikimi i pengesave egzistuese në sektorin privat dhe veçanërisht në zhvillimin e NVM-ve dhe sigurimi i reagimit direkt mbi politikat dhe veprimet e qeverisë;
- 2 Sigurimi që reformat mjedisore dhe të efijences së energjise të përshtaten në nivelet e qeverisë dhe shoqërive;
- 3 Sigurimi që kërkesat për transparencë dhe përgjegjësi të përfshihen në projekte në përputhje me politikën e BERZH-it dhe vendimet e zbatueshme nën marrëveshjet ndërkombëtare;
- 4 Zgjerimi i përdorimit të koncensioneve private në infrastrukturë (p.sh të përpiqet të përsëritet sukcesi i Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës); dhe
- 5 Në fushën e telekomit, Banka do të vazhdojë mbështetjen me BT dhe gjithashtu do të rishikojë mundësinë për asistencë të mëtejshme specifike për autoritetet, duke përfshirë zhvillimin institucional, përhapja e internetit *broadband*, lehtësinë e futjes në zonat rurale dhe zhvillimin e sistemit rregullator (lehtësimin e përdorimit të teknologjisë dixhitale dhe mundësimi i Shqipërisë për të përfituar nga risitë në median dixhitale).

## 4. BASHKËPUNIMI ME DONATORËT DHE IFN TË TJERA

Banka bashkëpunon ngushtë me donatorët e tjerë për të ndihmuar realizimin e Strategjisë së Vendit në Shqipëri. Banka ka punuar me institucione dypalëshe dhe shumëpalëshe në sektoret e infrastrukturës kyçe, duke përfshirë transportin, energjitikën dhe telekomin si edhe sektorin bashkiak. Partnerët përfshijën Bankën Botërore, BEI, Bankën Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (BJBN), BE dhe qeveritë shumëpalëshe.

Pas një bashkëpunimi të suksesshëm në sektorin e rrugëve, Banka po punon me BE dhe BEI për të bashkëfinancuar një pjesë të projektit të kryesuar nga Banka Botërore mbi rehabilitimin e rrugëve rurale.

Pas dy operacioneve të suksesshme për financimin e projektit PPP për modernizimin dhe zgjerimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, ku Banka bashkëpunoi me "DEG-Deutsche Investitions- und Entwicklungsgesellschaft mbH" (Gjermani), Banka është përgatitur të marrë në konsideratë investime PPP të mëtejshme në infrastrukturë.

Përves bashkëfinancimit projekteve të rehabilitimit fizik, Banka po punon me donatorë të tjerë për të koordinuar dialogun e politikave në sektorët përkatës të infrastrukturës. Megjithatë, në disa vjetët e fundit, qeveris ka patur mjaft oferta për financimim dhe akoma nuk ka kategorizuar në mënyrën e duhur kërkesat e saj për investim. Një koordinim më i mirë do të ndihmojë zbatimin ku për fat të keq kapacitetet e qeverisë qëndrojnë mjaft të dobëta.

Banka, BE, BEI kanë bashkëpunuar mirë në sektorët e rrugëve, porteve dhe energjitikës dhe ky bashkëpunim mund të përfitojë vetëm nga krijimi i WBIF, i cili synon konsolidimin e instrumenteve financiarë të IFN-ve dhe burimeve në dispozicion për vendet e para hyrëse në Ballkanin Perëndimor. Një sistem i tillë siguron një bashkëpunim shumë të përmirësuar ndërmjet donatorëve europianë, duke u bazuar në një ndarje transparente të projekteve përkatëse, misionet e përbashkëta programuese në shtete të ndryshme, ndarjen e vendimeve mbi projektet prioritare të mundshme për të marrë një financim nga IFN-të dhe donatorët dhe një financim të përbashkët/paralel nga IFN-të pjesëmarrëse.

Fondet e donatorëve kanë qënë veçanërisht të rëndësishme për të mbështetur zhvillimin e nismave të TAM dhe BAS. Donatorët kryesorë që kanë financuar njërën nismë ose tjetrën janë Holanda, Portugalia, Kanadaja, Japonia dhe BE.

Në linjë me prioritetet e Bankës dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim të qeverisë 2007-2013, Banka do të ndjekë objektivat e mëposhtme:

- 1 Zbatimin e WBIF nëpërmjet projekteve bashkëfinancuese dhe tërheqja e granteve për ti mbështetur ato;
- 2 Ruajtja e bashkëpunimit të ngushtë me pjesëmarrësit e WBIF, Bankën Botërore dhe institucione të tjera në dialog për politikën e dialogut mbi përmirësimin e klimës investuese;
- 3 Koordinimi me Bankën Botërore/KFN dhe BE si edhe me agjensi të tjera të përfshira aktivisht në dialog për të nxitur investimet private për zhvillimin dhe funksionimin e infrastrukturës dhe të punojnë për të ndihmuar reformat sektorale.
- 4 Vazhdimi i bashkëpunimit me KFN atje ku është e duhur në sektorin bankar dhe të mbështetet IHD më të mëdha dhe më të rëndësishme;
- 5 Bashkëpunimi me qeverinë shqiptare për zbatimin e Plan Veprimit mbi Marrëveshjen e Pajtimit të Aarhus atje ku është e duhur;
- 6 Vazhdimi i bashkëpunimit me Bankën Botërore dhe donatorët shumëpalësh si p.sh USAID (Agjensia për Zhvillim Ndërkombëtar e SHBA-ve), SECO (Sektretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike), KfW dhe Agjensia Austriake për Zhvillim për ristrukturimin dhe rehabilitimin e sektorit të energjisë. Veçanërisht, financimi i investimeve prioritare në linjat e hidro centraleve të digave; dhe
- 7 Vazhdimi i bashkëpunimit të ngushtë me BE, BEI, Bankën Botërore dhe donatorë të tjerë të mundshëm në sektorin e infrastrukturës së transportit (si p.sh rrugë, porte dhe hekurudha).

Një informacion më i detajuar mbi aktivitete të tjera të IFN-ve dhe donatorëve

shumëpalësh në Shqipëri mund të gjenden në Aneksin 8.

## **ANEKSI 1 - Vlerësimi Politik**

Shqipëria është angazhuar dhe synon për parimet e demokracisë shumëpartiake, pluralizëm dhe ekonominë e tregut në përputhje me kushtet e specifikuar në Nenin 1 të Marrëveshjes së themelimit të Bankës.

Institucionet demokratike në Shqipëri janë mjaft të forta, me një ndarje funksionale të fuqive, kontrolleve dhe balancimeve në sistemin politik, megjithëse kulturës së dialogut të politikës i nevojitet një konsolidim i mëtejshëm. Në përgjithësi, zgjedhjet janë kryer në një mënyrë të caktuar nga OSBE dhe Këshilli i Europës për të qënë të lira dhe të ndershme. Megjithatë, ndërsa vihet re një tendencë për përmirësim të procesit elektoral në Shqipëri, shpesh zgjedhjet shoqërohen nga parregullsi serioze në procedurë dhe akoma nuk përmbushin standartet e plota ndërkombëtare për zgjedhje demokratike.

Përgjatë viteve të fundit, Shqipëria ka vazhduar të bëjë progres në reformat kryesore, që synojnë drejt afrimit në BE. Strukturat qeveritare janë përforcuar për të arritur angazhimet nën Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit me BE dhe të koordinojë punën drejt integritimit në BE. Sistemi politik i Shqipërisë është konsoliduar dhe stabiliteti i përgjithshëm politik është rritur. Tre zgjedhjet e fundit (zgjedhjet parlamentare në vitin 2005, lokale në vitin 2007 dhe parlamentare në vitin 2009) ishin të qeta, në kontrast me të shkuarën jo shumë të largët ku lufta politike ndërmjet Partisë Demokratike (PD) të djathtë dhe Partisë Socialiste (PS) të majtë shoqërohej shpesh me dhunë në rrugë. Këto parti politike të mëdha janë alternuar në drejtimin e vendit për pothuajse dy dekada, por kalimet e fundit të qeta të fuqisë japin shpresë që tashmë kjo është bërë një arritje e pakthyeshme.

Dobësitë kryesore qëndrojnë në fushat të zbatimit të ligjit, korrupsionit dhe krimit të organizuar si edhe në kapacitetin e përgjithshëm administrativ.

### **Zgjedhjet**

Sistemi ligjor, i cili përfitoi nga valë të ndryshme të reformave elektorale, mundëson një bazë të qëndrueshme për zgjedhje demokratike, mundësoi paritë politike të ushtrojnë dëshirën dhe aftësitë e tyre për ta zbatuar atë. Kjo e fundit mungonte shpesh në të kaluarën, ndërsa mangësi serioze vazhdimisht ndodhnin gjatë zgjedhjeve në Shqipëri, duke përfshirë dhunën elektorale dhe kërcënime. Megjithatë, zgjedhjet më të fundit u kryen në një atmosferë gjërësisht paqësore dhe në përgjithësi ishin të organizuara më mirë, megjithëse akoma ato nuk ishin të lira nga një sërë parregullsish proceduriale. Veçanërisht, zgjedhjet lokale në shkurt 2007 u shoqeruan nga parregullsi serioze dhe u vlerësuan nga Misioni i Observimit të Zgjedhjeve si "përmbushje e pjesëshme kushteve të OSBE dhe standarteve të tjera ndërkombëtare".

Zgjedhjet e fundit të përgjithshme, që u kryen në 28 qershor 2009 ishin një test i rëndësishëm për demokracinë e vendit dhe u monitoruan nga afër nga ndërkombëtarët edhe në sajë të kërkesës të anëtarësimit në BE që autoritetet shqiptare kishin aplikuar shumë pak

kohë përpara këtyre zgjedhjeve. Sipas vlerësimit paraprak të Zyrës së OSBE ODIHR (Zyra për Institucionet Demokratike dhe Të Drejtat për Njeriun) dhe Asamblesë Parlamentare e Këshillit Të Europës (APKE), zgjedhjet arritën një progres të qartë në lidhje me çështjet proceduriale. Dita e zgjedhjeve ishte përgjithësisht e qetë. Megjithëse vlerësimi final i ODHIR do të varet nga drejtimi i fazave pas zgjedhjeve të procesit zgjedhor, raporti i tij paraprak e vlerësoi të gjithë procesin më shumë pozitivisht sesa gjatë zgjedhjeve të mëparshme. Sidoqoftë, u vunë re një numër parregullsish, duke përfshirë përsëritjen e të ashtuquajturës "votim familjar", politizimit të punës së Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ) nga përfaqësuesit e dy partive kryesore politike, mungesën e pavarësisë editoriale dhe paragjykimet në disa media si edhe përpjekjet nga partitë politike për të përdorur çështje ligjore në mënyrë për t'u shmangur dispozitave të krijuara për të patur përfaqësimin nga femrat. Numërimi i votave u zgjat dhe shënoi një nivel të lartë mosbesimi ndërmjet partive politike, ndërsa KQZ shpesh zgjodhi të mos ndërhynte në problemet që lindnin në nivelin lokal. Kryesia e opozitës së PS deklaroi se nuk do të njohte rezultatet finale të zgjedhjeve dhe deri tani ka refuzuar hyrjen në parlamentin e ri të krijuar, i cili u mbledh në 7 shtator 2009.

Zgjedhjet parlamentare që u kryen në 28 qershor 2009 sollën fitoren e një koalicioni të udhëhequr nga PD, pasrtia e djathtë, që ka udhëhequr vendin që në vitin 2005 dhe mori në mandat të dytë për të drejtuar qeverinë e koalicionit. Zgjedhjet u kryen nën një sistem të ri, i cili përfshinte amendamente kushtetuese si edhe miratimin e një kodi elektoral të rishikuar në vitin 2008. Sistemi i ri, megjithëse jo ideal dhe i kritikuar veçanërisht nga partitë e vogla politike, kishte një avantazh të rëndësishëm që u miratua nga partitë më të mëdha politike, partia në fuqi, PD dhe opozita PS. Reforma e elektoralit u vlerësua pozitivisht nga Komisioni i Venecias të Këshillit të Europës. Sistemi i ri elektoral parashikoi një përfaqësim proporcional prej 140 anëtrësh të një parlamenti të zgjedhur në 12 zona elektorale. Ky sistem favorizon partitë e mëdha dhe detyron në mënyrë efektive partitë më të vogla politike të kërkojnë koalicione paraelectorale me dy partitë politike kryesore, PD dhe PS ose të bashkohen me to duke i hapur rrugë një partie më të konsoliduar. Gjatë zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2009 më shumë se 30 parti politike u regjistruan për forcat e përbashkëta zgjedhore me një nga katër koalicionet e formuara për këto zgjedhje.

## **Parimet Ligjore**

Reforma e sistemit gjyqësor po zhvillohet por është akoma në një fazë fillestare dhe mbetet akoma shumë për tu bërë për të siguruar pavarësinë e tij të plotë, transparencën dhe efikasitetin. Disa akte të rëndësishme ligjore janë miratuar duke përfshirë një ligj të ri në organizimin e gjyqësorit, e nënshkruar në vitin 2008, por zbatimi i tyre vazhdon të jetë i ngadalshëm. Një problem i rëndësishëm qëndron kthimi i pronave të konfiskuara gjatë regjimit komunist, të drejtat mbi pronat dhe pronësinë, një problem që ka ndikuar zhvillimin ekonomik dhe investimet e huaja prej vitesh.

Korrupsioni vazhdon të jetë një problem serioz. Në vitin 2004, APKE vlerësoi në një nga vendimet e saj mbi Shqipërinë se korrupsioni ishte "kërcënimi i vetëm dhe më i madh për institucionet demokratike dhe parimet ligjore në Shqipëri". Autoritetet kompetente kanë ndërmarrë masa të ndryshme për të luftuar korrupsionin, krimin e organizuar dhe

trafikimin. Sipas raportit të fundit nga Grupit të Shteteve Kundër Korrupsionit (GRECO), Shqipëria ka zbatuar mjaft nga rekomandimet e saj. Klasifikimi i Shqipërisë është përmirësuar ndjeshëm në publikimin vjetor të Indeksit për Llogaritjen e Korrupsionit (CPI) nga Transparency International - nga vendi 105 në vitin 2007 në vendin e 85 në vitin 2008, megjithëse është akoma një nga vlerësimet më të dobëta në Evropën Jug-Lindore. Qeveria miratoi një strategji të përgjithshme kundër korrupsionit për 2007-2013, por zbatimi i saj pritet të shihet.

## **Të drejtat e njeriut**

Shqipëria është pjesëmarrëse e të gjithë institucioneve më të mëdha ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut duke përfshirë Konventën Europiane mbi Të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore. Kushtetuta dhe ligjet përkatëse ndalojnë diskriminimin mbi bazën e gjinisë, racës, gjuhës, besimit, kombësisë ose origjinës sociale dhe statusin mbi të ardhurat dhe atë shoqëror. Kushtetuta garanton liritë themelore dhe të drejtat e qytetarëve që njihen në ligjin ndërkombëtar, ndërsa marrëveshjet ndërkombëtare janë të detyrueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë nga gjykatat vendase dhe pozicioni i tyre është superior mbi ligjin vendas. Garancitë kushtetuese mbi lirinë e mendimit, vetëdijes dhe besimit fetar respektohen në përgjithësi dhe Shqipëria vazhdon të sjellë shembullin e harmonisë ndërmjet besimeve fetare në rajon. Sipas Kushtetutës së Shqipërisë, nuk ka një besim fetar zyrtar për vendin dhe të gjitha të drejtat e komuniteteve fetare në vend (kryesoret janë Myslimanizmi në pjesën më të madhe Sunit dhe Bektashinjtë, dhe Kristianizmi në pjesën më të madhe Ortodoksët dhe Katolikët) garantohen në mënyrë të barabartë.

Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, pluralizmi në media është rritur në përgjithësi, por akoma vihet në dyshim pavarësia e tyre nga ndikimi politik. Ka më shumë se 250 linja transmetimi dhe gazeta që veprojnë në Shqipëri, me median elektronike që sundon në treg. Media më dominante është Radio-Televizioni Shqiptar (RTSH), të cilës i duhet akoma të transformohet nga një shërbim i kontrolluar nga shteti në një shërbim transmetues publik. Në përgjithësi, mediat kryesore të transmetimit dhe të shkruar konsiderohen se janë të drejtuara me një nga dy partitë politike kryesore në vend. Si rezultat i një numri të madh të mediave që konkurrojnë në një treg të limituar dhe në sajë të mungesës së transparencës së fondeve të tyre, vërejtësit e medias ngrejnë shqetësimin në lidhje me ndërhyrjen e tepërt nga interesat e biznesit. Shpifja vazhdon të jetë një shkelje kriminale në Shqipëri.

Shqipëria ka një përbërje etnike më pak të shumëllojshme sesa pjesa më e madhe e shteteve fqinjë në rajon. Grekët që përbëjnë minoritetin më të madh etnik janë, sipas llogaritjeve (regjistrimi më i fundit i përgjithshëm zyrtar i kryer në vitin 2001 nuk përfshiu pyetjet mbi etnicitetin), vetëm pak përqind e popullsisë. Sistemi ligjvënës mbi mbrojtjen e minoriteteve etnike është i miratuar, duke përfshirë edhe Konventën e UNESCO mbi Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Diversitetit të Shprehjes të Kulturave dhe iu janë garantuar të drejta të plota bazuar mbi Kushtetutën. Minoritetet etnike marrin pjesë në mënyrë aktive në jetën politike, kryesisht nëpërmjet partive të veta politike. Akoma më shumë përpjekje nevojiten për sigurimin e mbledhjes së të dhënave të sigurta mbi



përmasat dhe cënueshmëritë egzistuese të minoriteteve. Minoriteti rom, si në shumë shtete të tjera fqinjë, është më shumë i cënueshëm dhe vazhdon të përballet me vështirësitë për sigurimin e edukimit, strehimit dhe punësimit. Megjithëse është krijuar një strategji kombëtare mbi përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit rom, Shqipëria nuk merr pjesë në Dekadën e Përfshirjes së Komunitetit Rom.

Megjithëse janë aktive në nivelet themelore dhe kanë përfaqësuese në profile të larta në nivel kombëtar, roli i grave në jetën politike shqiptare vazhdon të jetë i limituar. Në parlamentin e viteve 2005-2009 vetëm 7 përqind e pjesëtarve të parlamentit ishin gra. Megjithë dispoziat e krijuara për të përmirësuar përfaqësimin e grave të ruajtura në kodin elektoral dhe legjislacione të tjera, si Ligji mbi Barazinë Gjinore në Shoqëri, i miratuar në vitin 2008, shpesh gratë përballen me vështirësitë për tu zgjedhur si kandidate dhe për të arritur pozicione drejtuese në partitë politike dhe në administratën publike.

Egziston një sistem ligjor i favorshëm për organizimet e shoqërisë civile. Megjithatë, OJQ-të në përgjithësi në Shqipëri vazhdojnë të jenë relativisht të dobëta dhe pjesëmarrja e tyre në krijimin e politikave duhet të përforcohet më tej.

Situata në lidhje me trafikimin e qënieve njerëzore në Shqipëri është e krahasueshme me atë në shtetet e tjera fqinjë në rajon. Shqipëria vazhdon të jetë një vend tranzit dhe një burim për gra dhe vajza të trafikuar për prostitucion me forcë. Qeveria po përpaket për të luftuar trafikimin si edhe të mbrojtë viktimat. Në vitin 2008, u miratua strategjia 3-vjeçare kombëtare për luftimin e trafikimit të qënieve njerëzore dhe plan veprimi kombëtar përkatës. Megjithatë, disa probleme kërkojnë akoma zgjidhje, duke përfshirë përpjekje të mëtejshme për ndjekjen penale në mënyrë efektive të trafikantëve dhe të mbrojtjen dhe integrimin e viktimave.

### **Hyrja në BE dhe integrimi Euro-Atlantik**

Integrimi i Shqipërisë në BE vazhdon të jetë burimi kryesor i jashtëm i stabilitetit për reformë dhe ka një konsensus të plotë ndërmjet të gjitha partive kryesore politike që kjo përbën prioritetin kryesor të vendit. Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit (MSA) me BE në vitin 2006 dhe duke u miratuar nga të gjithë shtetet pjesëmarrës (kjo e bën Shqipërinë një nga shtetet e para që kanë nënshkruar dhe që nuk ka një status formal për kandidat të BE), MSA hyri në fuqi në prill 2009. Në 28 prill 2009, Shqipëria aplikoi në mënyrë formale për anëtarësimin në BE. Gjithashtu, Shqipëria u bë anëtare e NATO-s me status të plotë në prill 2009, një nga shtetet e para bashkë me Kroacinë ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor. Tirana ka marëdhënie të mira me vendet fqinjë dhe luan një rol të rëndësishëm në bashkëpunimin rajonal, duke qënë një anëtare aktive, ndër të tjerash, të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal dhe Marrëveshjes për Tregëtinë e Lirë të Europës Qendrore (CEFTA).

Qeveria është e prirur të mbështetë projekte të mëtejshme përtej kufijve dhe rajonale.


## ANEKSI 2 – Vlerësimi i Ligjeve Shqiptare për Shoqëritë Tregëtare

BERZH-i ka përgatitur dhe përditëson rregullisht një sërë vlerësimesh të shndërrimit ligjor të vendeve ku ushtron aktivitet, duke e drejtuar vëmendjen në fushat e përzgjedhura të cilat lidhen me veprimtaritë e investimeve: tregjet e kapitaleve, ligjin për shoqëritë tregëtare dhe drejtimin e shoqërive aksionere, konçesionet, paaftësia paguese, transaksionet e sigurta dhe telekomunikacionet. Instrumentat egzistues bëjnë një vlerësim si të cilësisë së ligjeve në letër (që ndryshe quhet edhe "shkalla e mbulimit") ashtu edhe zbatimin në praktikë të këtyre ligjeve (që ndryshe quhet "shkalla e efektshmërisë"). Të gjitha rezultatet e këtyre vlerësimeve mund të shihen në adresën [www.ebrd.com/law](http://www.ebrd.com/law). Në këtë aneks paraqitet një përmbledhje e rezultateve për Shqipërinë, të shoqeruara me mendime kritike të ekspertëve ligjor të Bankës të cilët kanë kryer këto vlerësime.

### Ligjin për Shoqëritë Tregëtare dhe Drejtimin e Shoqërive Aksionere

Sistemi i drejtimit të shoqërive aksionere në Shqipëri funksionon në sajë të Ligjit Nr. 9901 i miratuar nga parlamenti shqiptar në 14 prill 2008 për "Shoqëritë Tregëtare dhe Sipërmarrjet" i cili hyri në fuqi në 21 maj 2008 dhe zëvendësoi ligjin e mëparshëm mbi organizatat e biznesit në Shqipëri (Ligjet Nr.7632/1992 dhe Nr. 7638/1992). Ligji i ri zbatohet për sipërmarrjet individuale dhe shoqëritë tregëtare. Në krahasim me ligjin e mëparshëm të shoqërive, ligji i 2008 përfshin gjithashtu përcaktimin e degëve dhe zyrave përfaqësuese të shoqërive të huaja dhe detajon dispozitat mbi grupet e shoqërive. Shoqëritë e përfshira nën klasifikimin e vjetër kanë në dispozicion një periudhë prej 3 vjetësh për të drejtuar strukturën e tyre organizative me ligjin e ri.

### Cilësia e legjislacionit për drejtimin e shoqërive tregëtare– Shqipëria (2008)



*Shënim:* Ekstremiteti i secilit aks përfaqëson pikët ideale, dmth u korrespondojnë Parimeve të Drejtimit të Shoqërive Tregëtare të OECD. Sa më e madhe të jetë "rrjeta" aq më shumë u afrohen këtyre parimeve ligjet e vendit për drejtimin e shoqërive tregëtare

*Burimi:* Vlerësimi i Sektorit të Drejtimit të Shoqërive Tregëtare, BERZH 2008

Sipas rezultateve të Vlerësimit të Sektorit të Drejtimit të Shoqërive Tregëtare të Bankës në vitin 2008, (shihni grafikun më sipër) i cili vlerësoi cilësinë e legjislacionit në fuqi mbi të vitit 2007, Shqipëria u cilësua si në "përmbushje të ulët" në lidhje me standartet ndërkombëtare përkatëse (Parimet e Drejtimit të Shoqërive Tregëtare të OECD). Ligji i ri i vitit 2008 ka zgjidhur disa nga mangësitë e theksuara në vlerësim dhe sistemi është përmirësuar tani.

Në vitin 2005, Banka analizoi efektshmërinë e drejtimit të shoqërive aksionere (si funksionojnë ligjet në praktikë). U hartua një rast studimor në lidhje me transaksionet me palët e lidhura. Rasti studimor hetonte statusin e një aksioneri me një pakicë aksionesh i cili kërkonte të merrte informacion për shoqërinë aksionere për të kuptuar nëse kishte kryer shoqëria transaksione me palë të lidhura dhe sa ishte i mundshëm dëmshpërblimi në rast se ishte shkaktuar ndonjë dëm. Më pas u mat efektshmëria e legjislacionit sipas katër ndryshoreve të parimeve: kompleksiteti, shpejtësia, mundësia e kontrollit të zbatimit të ligjit dhe mjedisi institucional. Kjo analizë zbuloi disa mangësi në Shqipëri. Proçedurat për të marrë informacion dhe dëmshpërblim janë të ndërlikuara, veçanërisht nëse shoqëria dhe/ose aksioneri kryesues nuk pranon të bashkëpunojë me vullnet të lirë. Për më tepër, mungesa e jurisprudencës që do të ofronte orientim për interpretimin e ligjit influencon negativisht në qartësinë e proçedurave. Koha që nevojitet për të marrë një gjykim të përmburueshëm mund të jetë diku afër 18 muajve, por pala e paditur e ka të lehtë ta vonojë proçesin. Në përgjithësi, informacioni i shoqërive nuk është i besueshëm dhe zakonisht audituesit ligjor nuk mund të punojnë në mënyrë të pavarur, cka e ul mundësinë e marrjes së informacionit të saktë. Në lidhje me dëmshpërblimin, rasti studimor tregoi se ka një mungesë përvoje dhe aftësie të gjykatave në lidhje me çështjet gjyqësore të shoqërive aksionere dhe nxorri në pah mundësinë e anshmërisë së tyre, sidomos në rastin e çështjeve ku i paditur është një palë e fuqishme.

Në vazhdim të ndryshimit të gjërë të sistemit ligjor mbi drejtimin e shoqërive aksionere në Shqipëri, autoritetet përkatëse duhet të sigurohen se sistemi ligjor përfundimtar është i harmonizuar dhe i zbatueshëm në mnyrë perfekte. Rritja e kapacitetit të institucioneve në zbatimin e efektshëm të ligjit nëpërmjet programeve të trainimit dhe përmirësimit të njohurive duhet të jetë një prioritet.

### **Konçesionet**

Megjithëse akoma mungon një sistem i përgjithshëm politikash në formë të shkruar për përmirësimin e mjedisit ligjor dhe përkrahjen e PPP-ve, përpjekjet e fundit të qeverisë në reformën e sistemit të konçesioneve tregon ineresimin e qeverisë për përkrahjen dhe përdorimin e PPP-ve në infrastrukturën dhe shërbimet e saj. Një Agjensi për Trajtimin e Konçesioneve është krijuar për të përmbushur mangësitë në sistemin institucional.


Ligji shqiptar mbi konçesionet 9663/2006 ("Ligji") është mjaft afër me rekomandimet e

Guidës UNCITRAL PFI (Sistemi i Politikës mbi Investimet nga Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin Ndërkombëtar të Tregëtisë) si edhe ka përmbajtje mjaft pozitive. Për shembull, Ligji është një nga ligjet e pakëta mbi drejtimin e konçesioneve në rajon që përmban në përcaktimin e saj transferimin e riskut tek konçesionari dhe konsiderimin e shpërblimit. Ai gjithashtu ka nevojë për një vlerësim të analizës së parave. Subjektet e përfshira dhe sektorët e interesuar janë lehtësisht të identifikueshëm. Sektorët e pranueshëm për PPP përfshijnë ndër të tjerave transportin, energjitikën, ujësjellësin, kanalizimet, mbetjet e ngurta, edukimin, kujdesin ndaj shëndetit dhe sektorët e burgjeve si edhe çdo sektor tjetër i miratuar nga vendimi i qeverisë.

Ligji përmban dispozita që sigurojnë një proces përzgjedhës të drejtë dhe transparent që përfshin procesin para zgjedhjes së ofruesve, procedurat për kërkimin e propozimeve me një ndryshim ndërmjet propozimeve teknike dhe financiare, mundësinë e procedurave në dy faza, publikimin e çmimit të konçesionit, përjashtime të limituara për çmimin e konçesionit pa procedura konkurruese, egzistenca e procedurave të rishikimit, parametrat mbi procesin e diskutimit etj. Dispozitat që rregullojnë marrëveshjet e projektit i japin një drejtim të qartë çështjeve kryesorë që duhen zgjidhur të cilat vazhdojnë të jenë akoma mjaft fleksibël dhe në këtë mënyrë i lejojnë palëve të diskutojnë kushtet e saj.

Ndër disavantazhet ka një veçanërisht të rëndësishëm: Ligji nuk konsideron letrat me vlerë qeveritare dhe çështjeve mbështetëse. Kjo mund të vijë si rezultat i faktit se qeveria është e interesuar për nivelin e borxhit publik dhe pasojat e mundshme të projekteve të PPP-ve në strukturën e financimit publik. Gjithashtu, megjithëse me një projekt ligj shumë të mirë, Ligji duhet të testohet në praktikë. Ndërmjet çështjeve praktike të identifikuar nga autoritetet janë rregullat e dhëna të propozimeve dhe si të vepohet me hyrjen e tyre.

**Cilësia e legjislacionit për konçesionet – Shqipëri (2007/8)**



*Shënim:* Ekstremitetet e secilit aks përfaqësojnë pikët ideale në përputhje me standartet ndërkombëtare siç është Guida Legjislative e UNCITRAL për projektet e Infrastrukturës me Financim Privat. Sa më e madhe "rrjeta" aq më shumë u afrohen këtyre standarteve ligjet e vendit për konçesionin.


## Paaftësia paguese

Paaftësia paguese në Shqipëri mbulohet kryesisht nga Ligji për Procedurat e Paaftësisë Paguese i vitit 2002 dhe i ndryshuar së fundmi në vitin 2008 ("Ligji për Paaftësinë Paguese"). Në Studimin Vlerësues mbi Paaftësinë Paguese e bërë nga Banka në 2006, e cila mat përputhjen e legjislacionit mbi paaftësinë paguese me standartet ndërkombëtare, Ligji mbi Paaftësinë Paguese ishte një nga ligjet e pakët në 30 vendet ku vepron Banka që u vlerësua me një rezultat të përgjithshëm "përputhshmëri të plotë".

Grafiku më poshte tregon nivelin e përputhjes të Ligjit për Paaftësinë Paguese në pesë fusha kritike të legjislacionit të paaftësisë paguese. Vija e jashtme e grafikut tregon një përputhje të plotë me standartet më të rëndësishme ndërkombëtare dhe vija e brendshme tregon vlerësimin e Ligjit mbi Paaftësinë Paguese.

Megjithatë, Ligji mbi Paaftësinë Paguese mund të përmirësohet në mënyrë të ndjeshme në disa mënyra: veçanërisht, ka disa pasiguri mbi të drejtat e kreditorëve të siguar për të përforcuar sigurimin e tyre kur procedurat e paaftësisë paguese kanë filuar. Ligji duhet të përmbajë më shumë tipare që i lejojnë shoqërive të riorganizohen. Për shembull, Ligji duhet të parandalojë mbylljen nga siguruesit e kontratave të rëndësishme ( si p.sh me elektricitetin, furnizimin me gaz, telekomunikacionin, etj.). Gjithashtu kreditorët do të përfitojnë nga rregullat më të detajuara në lidhje me rishikimin e tyre dhe planin e riorganizimit. Përfundimisht, Ligji duhet të përforcojë të drejtat e kreditorëve në lidhje me caktimin dhe zëvendësimin e drejtuesit të zyrës së paaftësisë paguese për të siguruar, për të siguruar një përgjegjësi më të mirë.

Cilësia e legjislacionit për paaftësinë paguese – Shqipëri (2006)



*Shënim:* Ekstremiteti i secilit aks përfaqëson një rezultat ideal, dmth u koresponдон standarteve ndërkombëtare siç janë Parimet dhe Orientimet e Bankës Botërore për Sisteme të Efektshme të Paaftësisë Pagueuse dhe të Drejtave të Kreditorëve, Grupi i Punës UNCITRAL për "Udhëzuesit Legjislativ për Ligjin për Paaftësinë Pagueuse" , dhe të tjera. Sa më e madhe "rrjeta" aq më shumë u afrohen këtyre standarteve ligjet e vendit për paaftësinë paguese.

*Burimi:* Projekti i BERZH-it për Vlerësimin Sektorial të Paaftësisë Pagueuse 2006

Ligji mbi Paaftësinë Pagueuse u miratua në vitin 2008 por është akoma shumë herët për të gjykuar ndikimin e reformës.

## **Transaksionet e Sigurta**

*Siguria e mjeteve të lëvizshme në Shqipëri mbulohet nga ligji i vitit 1999 mbi Barrët Sigurore, i cili u zbatua tërësisht në vitin 2001. Siguria apo garancia për mjetet e patundshme (hipoteka) mbulohet nga Kodi Civil (nenet 560-607). Taksat mbi pronat e patundshme duhet të regjistrohen në regjistrin vendor të pasurive të patundshme.*

Ligji për Barrët Sigurore zbatohet për “të gjitha transaksionet, pavarësisht formës apo klasifikimit të tyre, të cilat krijojnë një barrë sigurore, ose përmes kalimit të pronësisë, pasjes në zotërim si në rastin e një pengu, ose në forma të tjera”, në lidhje me sende të tundshme, pasuri të patrupëzuara ose të drejta, si edhe "mallrat me numër serie" siç janë makineritë bujqësore, mjetet lëvizëse ajrore, motorët e mjeteve lëvizëse ajrore, automobilët, barkat, makineritë e ndërtimit, motoçikletat, mjetet lëvizëse të motorizuara, maunet tokësore dhe mjetet lëvizëse me shina. Regjistri Qendror i Barrëve Sigurore filloi të vihej në funksionim në shkurt të vitit 2001. Në përgjithësi ligji është i qartë, i gjerësishëm dhe parashikon elasticitetin e duhur për transaksionet relativisht të sofistikuar. Përdoruesit e tij thonë se nuk kanë pasur probleme me regjistrimin e një barre sigurore në Regjistrin Qendror. Një mangësi e ligjit lidhet me prioritetin e kreditorëve të siguar meqënëse mund të mos kuptohet se kujt i takon prioriteti, deklarojnë sigurimet sociale dhe autoritetet qeveritare. Megjithatë, pika më e dobët e këtij regjimi ka lidhje me kontrollin zbatues.

Dispozitat ligjore synojnë të ofrojnë një sistem të shpejtë dhe eficient. Sipas këtyre dispozitave, në rast se debitori nuk i kryen detyrimet e veta, titullari i barrës sigurore ka të drejtën automatike për të kërkuar dhe marrë një urdhër gjykate, i cili i jep kompetencë përmbaruesit të marrë mjetet e vëna si barrë. Pastaj mund të ndodhë çlirimi i barrës sigurore ose përmes shitjes private ose përmes shitjes publike, duke përfshirë ankandin publik ose tenderin e mbyllur e shitur si një e tërë ose të shitura si njësi ose pjesë komerciale. Mirëpo, siç ka treguar edhe studimi i kryer gjatë vitit 2003 nën udhëheqjen e BERZH-it, përmbaruesit nuk janë aq të besueshëm dhe eficientë sa duhet. Edhe gjykatat thuhet se janë të ngadalëta dhe pa shumë përvojë në rastet e përmbarimit, me një risk të lartë korrupsioni.

Problemi mbi zbatimin është akoma më mprehtë për sa i përket hipotekave: bankat deklarojnë faktin se ato nuk janë në gjendje të rimarrin barrën sigurore në një nivel të kënaqshëm kthimi kur zbatojnë hipotekën e pronës. Në fakt, mendohet gjërësisht se

problemet që hasen gjatë procedurave të deklarimit përbëjnë një faktor të rëndësishëm për pengimin e zhvillimit të huave mbi hipotekat në Shqipëri. Problemi lind nga dispozitat e Kodit të Procedurave Civile (nenet 560-580) mbi "Zbatimin mbi pronat e patundshme, anijet dhe avionët". Zyra e Përmbarrimit (Zbatuesit) është përgjegjëse për organizimin e vlerësimit të vlerës së pronës (cili do të jetë çmimi fillesat për shitje) dhe përcaktimin e ankandeve publike ku do të shitet prona. Ligji lejon vetëm dy ankande dhe nëse asnjë blerës nuk përzgjidhet në fund të ankandit të dytë, mundësia e vetme e mbetur për kreditorin është të lejë pronën e patundshme në çmimin e ofruar (që është çmimi i vlerësimit i ulur me 20 përqind) për të kryer ripagimin. Nëse kreditori e refuzon këtë mundësi, procedura e deklarimit quhet e mbyllur dhe kreditori duhet të gjejë mënyra të tjera për të rimarrë vlerën e pretenduar. Në rastet kur prona është vlerësuar me një vlerë më të lartë se ajo që synohet, kreditori duhet ti paguajë debitorit diferencën. Probleme të tjera që përmenden janë:

1. Periudha e pacaktuar kohore e përmbarruesit për të njoftuar debitorin dhe si rezultat procesi zgjatet;
2. Subjektiviteti në përcaktimin e vlerës së pronës sepse nuk ka standarte të përcaktuara për vlerësimin e pronave të pasurive të patundshme;
3. Procedura të gjata dhe të papërshtatshme ankandi.

Nisma të ndryshme për zgjidhjen e këtyre çështjeve u deklaruan në fundin e vitit 2008 nën tryshninë e Shoqatës Shqiptare të Bankave, qeveria pranoi mbështetjen e refomës të Kodit të Procedurës Civile sipas së cilës tavani i ankandit të dytë do të ulej në 40 përqind.

Megjithatë, nuk besohet se kjo reformë do të jetë e mjaftueshme të zgjidhe problemin në thellësi të tij. Misioni i Asistencës Europiane për Sistemin Shqiptar të Drejtësisë ka studiuar çështjen dhe ka publikuar një program të plotë me rekomandime për përmirësimin e Kodit të Procedurës Civile duke u fokusuar në zbatimin e pasurive të patundshme, dhe kryesisht në mënyrën se si të përmirësohet organizimi dhe funksionimi i shërbimit të përmbarrimit. Po konsiderohet veçanërisht ideja e privatizimit të Zyrës së Përmbarrimit. Gjithashtu Banka ka vënë në zbatim rekomandimin për zgjidhjen e kësaj çështjeje duke siguruar mjete efektive ligjore nëpërmjet të cilave mund të zbatohen hipotekat pa kërkuar thirrjen e një ankandi publik si edhe përfshirjen e zyrës së përmbarrimit.

## **Tregjet e Kapitaleve**

Tregu i letrave me vlerë drejtohet në Shqipëri nga Ligji Nr.9879, i datës 21 shkurt 2008 "Ligji për Letrat me Vlerë". Ligji përcakton llojin e letrave me vlerë, kushtet për lëshimin e tyre, procedurat e tregëtimit dhe regjistrimit, kërkesat për ndërmjetësit, kushtet për organizimin e tregëtimit publik të letrave me vlerë, rregullat mbi mbrojtjen e investitorëve dhe pronarëve të letrave me vlerë, organizimi dhe funksionimi i regjistrave të letrave me vlerë dhe të tregut të aksioneve. Ky Ligj shënon një përmirësim të rëndësishëm nga regjimi i mëparshëm, i cili sipas Bankës nuk reflektonte praktikën më të mira ndërkombëtare, siç përcaktohen nga Objektivat dhe Parimet e Rregullave të Letrave me Vlerë e publikuar nga Organizata Ndërkombëtare për Komisionet e Letrave me Vlerë

(IOSCO). Për më tepër, tre fatura të reja mbi (i) fondet e pensionit, (ii) fondet e investimeve dhe (iii) bonove të korporatave dhe atyre bashkiake po përgatiten (kjo e fundit me asistencën e Bankës) dhe po diskutohen në parlament dhe duhet të miratohen në fund të vitit 2009.

Tregu i Letrave me Vlerë në Shqipëri mbikqyret nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF) i krijuar me Ligj Nr. 9572 i datës 3 korrik 2006, që zëvendëson Komisionin e Letrave me Vlerë. Gjithashtu AMF është përgjegjëse për tregun e siguracioneve, skemave të pensioneve si edhe aktivitete të tjera financiare jobankare, ndërsa Banka Qëndrore është përgjegjëse për sektorin Bankar. Bursa e Tiranës është operatori i vetëm i tregut që ka miratuar rregulla të brendshme në lidhje me anëtarësimin dhe listimin por ajo nuk është aktive. Si rezultat, aktualisht sistemi financiar shqiptar është përqëndruar mbi bankat.

Në mënyre për të vlerësuar se si legjislacioni i Letrave me Vlerë zbatohet në praktikë, Banka kreu një Kerkimi për Treguesit Ligjorë ("KTL") mbi tregjet e letrave me vlerë. Praktikuesve në rajon iu kërkua të komentonin mbi një rast studimi hipotetik, duke këshilluar një investitor i cili humbi kursimet e tij pasi bleu aksionet në Ofertën Fillestare Publike (IPO) të një shoqërie kombëtare, i corientuar nga informacioni i gabuar në përshkrimin e shoqërisë. Veçanërisht, kërkimi u përqëndrua në efektshmërinë e kërkesave të publikimit të përshkrimit të shoqërisë, mekanizmat e zbatimit privat dhe publik dhe autoritetin e rregullatorit të tregut. Shqipëria nuk kishte ekperiencë të mëparshme të IPO-s dhe përshkrimet e vetme të projekteve që ishin përgatitur ishin Memorandumet e informacionit gjatë procesit të privatizimit. Këto dokumente nuk u konsideruan si të besueshme. Tashmë, kërkesat ligjore për publikim janë përmirësuar, por ato nuk janë testuar asnjëherë në praktikë. Që në janar 2008, raportimi financiar i shoqërive të renditura duhet të jetë në përputhje me Standartet Financiare Ndërkombëtare (IFRS). Si rezultat i mosveprimit të bursës së aksioneve, efektshmëria e kësaj dispozite vlen për tu testuar. Mekanizmat privatë të zbatimit lejojnë një tërësi veprimesh, por efektshmëria e tyre është e ulët: procedurat janë komplekse dhe niveli i parashikuar i kthimit nga veprimet ligjore është i limituar. Institucionet e tregjeve të letrave me vlerë nuk kanë akoma eksperiencën e duhur për sigurimin e mbështetjes së nevojshme të veprimeve gjyqësore ndërsa eksperiencia e gjykatave dhe prokurorisë në rastet komplekse të ligjeve mbi letrat me vlerë duhet të testohet akoma në praktikë.

Në vazhdim të rishikimit të zgjeruar të sistemit ligjor të tregjeve të letrave me vlerë në Shqipëri i përmendur më lart, qeveria duhet të sigurojë që procedurat dhe instrumentat e rinj financiarë mund të zbatohen lehtësisht nga shoqëritë dhe të monitorojë zbatimin, për të krijuar një mundësi të suksesshme për financimin bankar.

## **Telekomunikacioni**

*Sistemi ligjor dhe institucional:* Një Ligj në Përputhje me Bashkimin Europian (BE) mbi Komunikimet Elektronike ("Ligji i vitit 2008") hyri në fuqi në 26 qershor 2008 duke përcaktuar sistemin institucional të këtij sektori. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për krijimin e politikave në sektor, skicimin e legjislacionit,




përgatijen e Planit Kombëtar mbi Frekuencë Radiove dhe miratimin të procedurave të tenderit për përcaktimin e frekuencave dhe përcaktimin e siguruesve universalë të shërbimit duke u bazuar mbi propozimet e rregullatorit. Ligji i vitit 2008 vendos Autoritetin Shqiptar të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) si autoritetin e ri rregullues, duke marrë përsipër detyrat dhe përgjegjësitë e rregullatorit të mëparshëm të telekomunikacionit (ERT). AKEP është një subjekt publik, i pavarur, jobuxhetor dhe ligjor përgjegjës për kryerjen e detyrave rregullatore të përcaktuara nën Ligjin e vitit 2008.

*Hyrja në treg dhe autorizimet:* Liberalizimi i shërbimeve dhe rrjeteve elektronike fikse të komunikimeve u prezantua gradualisht: duke filluar me rrjetet rurale lokale në vitin 2008, duke vazhduar me rrjetet me distancë të largët në vend në vitin 2003 dhe rrjetet ndërkombëtare në vitin 2005. Ligji i vitit 2008 prezantoi një regjim të përgjithshëm autorizimi ku rrjetet dhe shërbimet që nuk kërkojnë përdorimin e burimeve të limituara mund të sigurohen pa licenca individuale, pjesë e një autorizimi të përgjithshëm me një kërkesë të dërguar në AKEP. Vendimi për licencën e katërt të GSM është akoma në proces.

*Vlerësimi:* Në një vlerësim të vitit 2008 të sektorit të komunikimeve të vendeve ku vepron Banka, regjimi i sistemit rregullator në Shqipëri u përcaktua si në "Përputhshmëri të Plotë" i matur me praktikatat më të mira ndërkombëtare. Megjithatë, në kuadrin e përkeqësimit të drejtimit brenda AKEP në fillim të vitit 2009, ky vlerësim kërkon një rishikim dhe ka të ngajrë që të ketë ulje në vlerësim. Sistemi ligjor për rregullatorin e telekomunikacioneve në Shqipëri është në përputhje me sistemin rregullator të BE të vitit 2003 por zbatimi është i dobët. Ka patur probleme serioze në drejtimin e AKEP që kanë penguar zhvillimin e tij në një entitet plotësisht efektiv dhe profesional dhe kanë paralizuar marrjen e vendimeve. Rezultati është që dobësitë serioze qëndrojnë në zbatimin e SMP dhe ruajtjen e konkurrencës. Për më tepër, autoritetet shqiptare janë treguar të ngadalëta në hapjen e hapësirave për zhvillimin e një telefonie të tretë celulare dhe shërbimeve fikse të *wireless*.

## **Çliësia e Sistemeve Rregullatore të Telekomunikacionit – Shqipëri (2008)**



*Shënim: Diagrama tregon cilësinë e kombinuar të sistemit institucional, hyrjes në treg dhe mjedisit operacional e krahasuar me standartet ndërkombëtare të nxjerra nga Organizata Botërore e Tregëtisë (OBT) dhe Bashkimi Europian. Ekstremiteti i secilit aks përfaqëson një rezultat ideal prej 100 përqind, dmth në përputhje të plotë me standartet ndërkombëtare. Sa më e madhe "rrjeta" aq më shumë u afrohen këtyre standarteve sistemi i përgjithshëm rregullator i vendit për telekomunikacionet.*

**Burimi:** Vlerësimi i Rregullatorit të Telekomunikacionit, BERZH 2008

## **ANEKSI 3 – Sfidat e Tranzicionit**

Shqipëria përballlet me sfida të rëndësishme të tranzicionit në të gjithë sektorët. Vlerësimi i mëposhtëm bazohet në Vlerësimin e Sfidave të Tranzicionit i vitit 2009.

### **Sektori i Korporatave**

**Industria e Përgjithshme:** Vitet e fundit, reforma e industrisë së përgjithshme në Shqipëri është penguar nga zbatimi i dobët i ligjit dhe në progresin e ngadaltë për procesimin e lejave dhe pretendimeve të pronësisë. Megjithatë, në dy vitet e fundit, Shqipëria ka bërë një progres të rëndësishëm në përmirësimin e klimës së biznesit. Në qershor 2007, krijimi i qendre kombëtare të rë për regjistrimin e biznesit mundësoi zvogëlimin e kohës së nevojitur për regjistrimin e një biznesi nga tetë ditë në të kaluarën në një ditë tani. Në janar 2008, 10 përqind i taksës mbi të ardhurat tek korporatat u zëvendësua me një taksë 20 përqind mbi fitimin. Një tërësi privatizimesh të nivelit të lartë u përfunduan në vitin 2007 dhe 2008. Megjithatë, shumë sipërmarrje kanë akoma nevojë për tu rikonstruktuar si edhe standartet e drejtimit të shoqërive dhe drejtimit të biznesit qëndrojnë të ulëta.

**Agrobiznesi:** Megjithëse çmimet janë liberalizuar dhe kontrollet tregëtare po zvogëlohen gradualisht (nën kujdesin e marrëveshjes së MSA së BE të nënshkruar në vitin 2006), sektori vuan nga përmasa shumë të vogla të zotërimit mesatar të tokës, mungesës së infrastrukturës dhe aftësive të njohurive, prodhues jo të efektshëm të mallrave të agrobiznesit, të drejta të pakëta mbi pronësinë, standarte të ulëta cilësie dhe investime të limituara. Rishpërndarja e tokës bujqësore shtetërore u përfundua, por një pjesë e madhe e kësaj toke akoma nuk ka të drejta pronësie të sigurta dhe të qarta meqënëse procedurat ligjore dhe administrative që zgjidhin konfliktet mbi pronësinë vazhdojnë të jenë të dobëta. Shumë nga procesorët e agrobiznesit janë privatizuar. Në këtë sektor ka pasur investime të jashtme të limituara. Megjithatë, shoqëritë e agrobiznesit janë pengohen nga pajisjet e vjetëruara dhe standartet e ulëta të cilësisë. Megjithëse mundësia e marrjes së kredive nëpërmjet skemave të mikrokredive, ato vazhdojnë të jenë të limituara megjithëse ka shumë pak interes në investimin e aktivitetëve të agrobiznesit.

**Pronat dhe turizmi:** megjithë zhvillimin e shpejtë të sektorit të ndërtimeve private që në vitin 2005, tregu i pronave në Shqipëri karakterizohet nga një mungesë e ndjeshme e pronave moderne tregëtare në të gjitha nën-segmentet. Tregu i hipotekave të banesave është i pazhvilluar dhe ka një mungesë të financimit me hua në ndërtimet afatgjata. Ka një ndërhyrje të vogël shtetërore (nëpërmjet subvencioneve) në këtë sektor. Qeveria ka bërë një progres të rëndësishëm në lidhje me regjistrimin e pronave dhe mundësia e tokës nuk shihet si një problem i madh në sektorin privat. Ka shenja të një progresi të mëtejshëm në zbatimin e rregullave dhe ligjeve egzistuese, veçanërisht në kryeqytet, që nga rishikimi i fundit, por akoma ka mangësi në lidhje me efektshmërinë e zbatimit praktik të sistemit legjislativ dhe lejet e ndërtimit. Ka një mangësi të produkteve të reja dhe metodave të financimit në këtë sektor megjithë aktivitetet e rëndësishme në ndërtim nga NVM-të në rajonet kryesore bregdetare. Shitblerja e tokës në të vërtetë është e

limituar.

**Telekomunikacioni:** Pas disa përpjekjesh, linja fikse e Albtelekomit u privatizua në vitin 2007. Megjithëse tregu është liberalizuar, nuk egziston një konkurrencë serioze, me Albtelekom që ka një monopol virtual mbi tregjet e linjës fikse dhe internetit si edhe shërbimeve të internetit broadband ADSL. Tregu i telefonisë celulare është më i zhvilluar dhe ka më shumë konkurrencë, i cili u përmirësua me hyrjen e operatorit të tretë të rrjetit të telefonisë celulare GSM, Eagle Mobile në mars 2008 dhe nivelet e hyrjes së telefonisë celulare po rriten shpejt, megjithëse transferimi i numrit celular nuk është prezantuar akoma. Megjithatë, tregu i internetit dhe IT është i pazhvilluar dhe karakterizohet nga çmime të larta, mungesa e konkurrencës së fortë dhe lehtësia e përdorimit të broadband është e mundshme vetëm në pak vende. Ka patur një zhvillim të rëndësishëm në institucionet që mbështetin tregun me Ligjin e ri mbi Komunikimet Elektronike (maj 2008).

### **Energjitika dhe Infrastruktura**

**Sektori i energjitikës:** Është kryer një arritje në përmirësimin e strukturës së tregut pas përfundimit të ndarjes së sektorit të energjisë. Në vitin 2007, sektorët e transmetimit dhe shpërndarjes së KESH-it, shoqërisë shtetërore të energjisë, u riorganizuan si shoqëri të veçanta aksionere. Për më tepër, në prill 2009, parlamenti shqiptar miratoi shitjen e 74 përqind të aksioneve në shoqërinë lokale të shpërndarjes së energjisë. Ndërsa pjesëmarrja e sektorit privat në prodhimin e energjisë ka qënë e limituar deri tani, ajo pritet të rritet së fundmi nëpërmjet një procedure tenderimi publik për koncesionet e hidrocentraleve të mëdha, të vogla dhe mini. Rregullat e tregut janë miratuar për të siguruar sistemin e nevojshëm për hapjen dhe funksionimin e tregut me shumicë dhe pakicë. Nga janari 2008, të gjithë konsumatorët jo-shtëpiakë u kthyen në konsumatorë të cilëve iu dha e drejta të zgjidhnin furnizuesin e vet. Megjithatë, konkurrenca e efektshme është akoma e limituar. Cilësia e institucioneve shqiptare ka nevojë të përforcohet më tej. Një Autoritet i Rregullimit të Energjisë është krijuar por pavarësia e tij është e limituar dhe kapaciteti i tij institucional nevojitet të përforcohet më tej. Në mars 2008, tarifat e energjisë elektrike u rritën me 15 përqind por ato përsëri nuk reflektojnë koston e prodhimit.

**Sektori i Infrastrukturës Bashkiake dhe Medisore:** Drejtimi i infrastrukturës bashkiake u transferua formalisht tek bashkitë. Megjithatë, një sistem kontradiktor mbi të drejtat e pronës rezulton në ndërhyrje të strukturave qendrore të qeverisë në operacionet e infrastrukturës lokale. Pjesa më e madhe e shërbimeve bashkiake dhe shoqërive të transportit nuk janë kthyer akoma në shoqëri të pavarura. Arritjet financiare janë në përgjithësi të dobëta dhe ka pak interesim për arritjen e të ardhurave tregëtare si tarifat e ulëta, matjet e pamjaftueshme dhe mbledhja e pakët e të ardhurave nga tarifat vihet re në pjesën më të madhe të bashkive në vend. Kjo ka shkakuar që aktivitetet e infrastrukturës bashkiake të bazohen në investimet e granteve dhe të jenë shpesh subjekt i investimeve të pamjaftueshme. Pjesëmarrja e sektorit privat në sektorin e ujësjellësit është minimale dhe sistemi ligjor është nën optimale. Akoma ka disa përjashtime në marrëveshjen koncesionare të formës ndërto-vepro-transfero dhe marrëveshjeve të menaxhimit në sektorin e ujësjellësit. Transporti urban funksionon pjesërisht nga shoqëritë private me

mungesën e rregullave dhe koordinimit ndërmjet shërbimeve të transportit publik duke krijuar një situatë konkurrencë "në treg" sesa "për tregun", nën një proces të kontrolluar tenderimi i drejtuar nga departamente të rëndësishme të transportit bashkiak si rregullatorë. Ndërsa pronësia e makinave vazhdon të rritet me nivele të larta të ardhurash, investimi në rrugët lokale dhe drejtimin bazë të trafikut do të bëhet më shumë i nevojshëm.

Nuk ka një rregullator të pavarur për vlerësimin ose miratimin e tarifave ose planeve të biznesit. Në mungesë të një formule për vendosjen e tarifave ose një sistem të duhur kontraktor ndërmjet shërbimeve bashkiake dhe autoriteteve lokale, vendosja e tarifave dhe planifikimi operacional politizohet shumë shpesh dhe nuk është transparent. Sfidat e përgjithshme të tranzicionit për sektorin bashkiak janë të gjëra dhe përfshijnë reformat e tarifave, komercializimin e shërbimeve publike, prezantimin e një sistemi të duhur rregullator dhe dhënien e autonomisë më të madhe financiare për bashkitë nën rregullat efektive.

**Sektori i burimeve natyrore:** Industria e burimeve natyrore në Shqipëri është e vogël dhe përqëndrohet tek kromi, bitumi, bakri dhe nikeli. Nafta bruto nxirret në Shqipëri që në vitin 1918, por nafta e përpunuar e prodhuar në vend ka cilësi të ulët dhe plotëson vetëm një pjesë të kërkesës në vend. Produktet e naftës importohen kryesisht nga Greqia dhe në sasi të vogla nga Italia, Rusia dhe vende të tjera. Në Shqipëri veprojnë disa shoqëri të huaja të naftës në nxjerrjen dhe në përdorimin por sektori vazhdon të dominohet nga Albpetrol, shoqëria shtetërore e naftës dhe e gazit, e cila është ristrukturuar dhe kthyer në një shoqëri të pavarur, me linja të veçanta aktiviteti që veprojnë si shoqëri të veçanta nën një strukturë të përbashkët. Shitja e 85 përqind të aksioneve të shoqërisë më të madhe të rafinerisë së naftës në Shqipëri, ARMO, u përfundua në gusht 2008. Është arritur një progres në krijimin e institucioneve dhe legjislacionit për mbështetjen e tregut, veçanërisht në fushën e tregut të energjisë së brendshme. Një ligj mbi sektorin e gazeve u miratua në qershor 2008. Vendi është nënshkruar i Traktatit të Komunitetit të Energjisë së bashku me Bullgarinë, Bosnjë Hercegovinën, Republikën e Kroacisë, FYR e Maqedonisë, Mali i Zi, Rumania, Serbia dhe Kosova me pikëpamjen për krijimin e Organizatës për Tregun e Energjisë së Integruar në Europën Jug-Lindore. Megjithatë, Strategjia Kombëtare e Energjisë e rishikuar nuk është miratuar akoma dhe mbrojtja mjedisore vazhdon të jetë një shqetësim mjaft serioz. Megjithëse së fundmi ka fituar statusin për zbatimin e EITI (Nismës për Transparencë të Industrive Nxjerrëse), transparenca fiskale dhe përgjegjësia vazhdon të jetë e ulët dhe mbledhja e të ardhurave ka qënë tradicionalisht e ulët. Vendimet mbi licensimin e hidrokarbureve dhe monitorimi i detyrimeve kontraktuale kryhen nga Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore, e cila është një nëndarje e Ministrisë së Energjitikës, megjithëse nuk është plotësisht e pavarur.

**Energjia e Qëndrueshme:** Në vitin 2005 u miratua Ligji i ri mbi Efiçencën e Energjisë dhe u vendos fondi mbi Efiçencën e Energjisë. Qendra e Efiçencës së Energjisë ndërmjet Shqipërisë dhe BE e mbështetur nga KE është I vetmi institucioni specializuar në këtë fushë. Një Strategji Kombëtare për Energjinë me një plan veprimi të detajuar u miratua

në qershot 2003, por regjistri i zbatimit është i shumëllojshëm. Tarifat e energjisë elektrike janë rritur dhe janë afër kthimit të kostos por nuk përfshijnë kostot mjedisore. Si rezultat, treguesit e çmimeve sigurojnë nxitje të limituara për përdorimin e energjisë në mënyrë efektive dhe për të investuar projektet e burimeve të energjisë së rinovueshme (RES). Vjedhja e energjisë elektrike dhe faturat e papaguara të energjisë ofrojnë alternativën për të investuar në kursimin e energjisë. Mbi 90 përqind e prodhimit të energjisë elektrike vjen nga hidrocentralet e mëdha. Nxitjet rregullatore për zhvillimin e projekteve të reja të energji të rinovueshme nuk janë akoma të përcaktuara. Shqipëria miratoi Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimin e Klimës (UNFCCC) dhe protokollin e Kjotos ku ajo ka statusin e Partisë Non-Annex 1. Nuk janë miratuar politika ose synime mbi emetimin e gazeve të efekteve serrë. Kontributi i Shqipërisë në emetimin të gazeve të efektit serrë është relativisht e ulët në sajë të numrit të madh të hidrocentraleve dhe mbylljen e industrive me energji intensive. Sfidat e mbetura kryesore përfshijnë rritjen dhe zbatimin me të mirë të tarifave të energjisë, uljen e humbjeve tregëtare në rrjetin e energjisë (nga 38 përqind në vitin 2008), avancimin e axhendës së ndryshimit të klimës dhe krijimi i një sistemi institucional dhe ligjor për mbështetjen e projekteve të vogla mbi energjinë e rinovueshme.

**Transporti:** Sektori i transportit kërkon investime të rëndësishme për modernizimin e infrastruktures dhe afrimin me standartet europiane. Në sektorin e hekurudhave, zbatimi dhe funksionet e përcaktimit të politikave nuk janë të ndara dhe bizneset kryesore të hekurudhave (infrastruktura, pasagjerët, transporti i mallrave etj.) zbatohen nga i njëjti entitet. Në sektorin e rrugëve është kryer shitja dhe komercializimi i shoqërive të ndërtimit dhe kontratat mbi ndërtimin dhe mirëmbajtjen (me përjashtimin e një pjese të vogël në kontratat e mirëmbajtjes rutinë) janë lëshuar. Një zhvillim i rëndësishëm për reformën u sigurua nga konçesioni privat për rehabilitimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, i kryer nëpërmjet një procesi tenderimi ndërkombëtar transparent. Ky projekt vazhdoi në mënyrë të suksesshme fazën e dytë të zgjerimit në sajë të rritjes më të shpejtë të trafikut sesa ishte parashikuar fillimisht. Gjithashtu po realizohen disa terminale portesh nga shoqëri private.

Në sektorin e rrugëve janë kryer përpjekje për ristrukturim në vitet e fundit dhe një plan ristrukturues për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve (DPRR) u miratua në vitin 2008. Shitja dhe komercializimi i shoqërive të ndërtimit është në zhvillim dhe DPRR ka kontraktuar më shumë se 50 përqind të kontratave periodike të mirëmbajtjes në sektorin privat. Megjithatë, konkurrenca dhe pjesëmarrja e sektorit privat vazhdojnë të jenë të limituara. Financimi i sektorit të rrugëve vazhdon të jete gjërësisht i përfunduar. Ka nevojë për ristrukturim institucional dhe financiar që shpjegon mangësinë e madhe në politikën mbështetëse të tregut në institucione.

Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës (TIA) drejtohet mbi bazën e një PPP-je. Një kontratë konçesionare prej 20 vjetësh u miratua një partneriteti të përbërë nga disa institucione ndërkombëtare dhe vendase.

## **Institucionet Financiare**

**Sektori Bankar:** Sektori financiar është privatizuar plotësisht, me rreth 95 përqind të mjeteve bankare të kontrolluara nga investitore të huaj. Aktualisht ka 16 banka tregëtare që veprojnë në Shqipëri, prej të cilave 15 janë plotësisht ose pjesërisht me pronësi të huaj. Sektori bankar tregëtar dominohet nga disa banka të mëdha me pronësi të huaj. Sektori është zhvilluar me shpejtësi që në vitin 2005, megjithëse është ngadalësuar që në tremujorin e fundit të vitit 2008. Në fund të vitit 2008 huatë e sektorit bankar përbenin 36.5 përqind të PBB-së. Në fund të vitit 2008, raporti ndërmjet huave dhe depozitave qëndroi në mënyrë të arsyeshme në 62 përqind.

Sektori bankar vazhdon të jetë relativisht i konsoliduar me likuiditetin dhe i kapitalizuar, dhe megjithëse huadhënia në rajon është ngadalësuar materialisht me huadhënien e NVM-ve të zvogëluar nga nivelet e ulëta që ishin. Mbi 70 përqind e huave jepen në valutë të huaj, duke i ekspozuar bankat ndaj risqeve të huamarrësve të pambrojtur. Përqindja e huave të këqija në portofolin total të huave është ulur gjatë vitit 2008 por vazhdon të jetë relativisht mesatare në 6.6 përqind. Mjedisi rregullator u përforcua në mënyrë të ndjeshme gjatë viteve të fundit. Mbikqyrja bankare u përforcua kur hyri në fuqi një ligj i ri në sektorin bankar në qershor 2007, duke e afruar legjislacionin e vendit me afër me standartet e BE. Pritet që ligji të sjellë përmirësimet e shumëpritura në vëzhgimin dhe mbikqyrjen, licensimin, rregullat e degëve të huaja si edhe menaxhimin e riskut dhe menaxhimin e kujdesshëm. Një Regjistër i ri i Kredive u vu në zbatim në janar 2008.

**Shërbimet e sigurimeve dhe shërbimet financiare:** Tregu i sigurimeve vazhdon të jetë i vogël dhe ndërsa ligji i fundit i sigurimeve përforcoi mjedisin ligjor dhe rregullator, zbatimi i efektshëm vazhdon të jetë një sfidë. Përmirësime të mëtejshme do të mirëpritëshin në fushat e standarteve të financës, deklarimeve dhe auditimeve. Privatizimi i shoqërisë shtetërore të sigurimeve INSIG, e kryer me përfshirjen e Bankës dhe KFN-së është drejt plotësimit, megjithë disa mangësi procedurale. Nuk ka kufizime të hyrjeve të huaja në sektorin financiar jobankar. Fondet e pensioneve private po zbatohen por sektori është akoma i vogël. Sistemi për sektorin e huadhënies së aktiveve (lizingu) është vendosur dhe rregullatori është aktiv në monitorimin e tregut.

**NMVM:** Ka disa banka dhe institucione mikrofinanciare që ofrojnë kredi për sistemin e NMVM-ve. Banka Procredit në Shqipëri siguron huadhënie mikro për sektorin joformal dhe nxit shoqëritë në ekonomitë joformale të regjistruhen përpara rritjes së mëtejshme të kësteve të huave. Një regjistër i kredive ka qënë në veprim që në janar 2008. Bankat tregëtare janë të detyruara nga banka qëndrore të përditësojnë të dhenat mbi huatë e reja çdo ditë, dhe gjendjen e ripagimit të huasë çdo muaj. Regjistri përmban informacion mbi huamarrësit (shumën e huasë, pagesat e huave, shumat e vonuara, kolaterali i përdorur, të dhëna në linjën e kredisë kur huamarrësi është një person i afërt, dhe historinë e gjendjes së huasë gjatë dy viteve të fundit) dhe të dhënat mbahen për pesë vjet dhe janë në dispozicion të institucioneve financiare.

**Sektorët e fondeve private me pjesëmarrje në kapital të vet:** Legjislacioni i letrave me vlerë paraqiti një numër problemesh dhe efektshmëria ishte relativisht e dobët, megjithëse situatë ligjore po reformohet. Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF) ka hartuar kohët

e fundit projekte mbi ligje të ndryshme (p.sh ligjin mbi fondet private të pensioneve dhe mbi bonot e shoqërive dhe qeverisë lokale), të cilët duhet të sjellin një ndikim pozitiv në zhvillimin e tregut të letrave me vlerë në vend dhe për ta afruar më shumë me standartet e BE. Kërkesat për publikim në prospektet publike u konsideruan si të dobëta. Rregullatori i tregut të letrave me vlerë nuk mund të jetë në gjendje të ndjekë të gjitha rastet dhe ka nevojë që akoma të vendose autoritetin e duhur. Sektori privat tregëtar me pjesëmarrje në kapital të vet duhet të zhvillohet akoma dhe deri tani vendi nuk ka tërhequr interesin e fondeve ndërkombëtare me pjesëmarrje në kapital të vet. Një mjedis biznesi në zhvillim, mundësitë e limituara të investimit dhe parashikimi i dobët i të ardhmes ndikojnë kundër zhvillimit të këtij sektori.



## ANNEX 4 – Tregues të Përzgjedhur Ekonomik

	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
						Çmuarje	Parashikim
<b>Produkti dhe shpenzimet</b>	(ndryshimi në përqindje, në terma realë)						
PBB	5.8	5.7	5.7	5.4	6	7.2	1.2
Konsumi privat	11.1	9.4	6	7.2	11.5	na	na
Konsumi publik	-1.9	7.6	2.6	1.4	7.2	na	na
Formimi i kapitalit të qendrueshëm bruto	18	2.7	4.9	9.3	6.5	na	na
Eksporti i mallrave dhe i shërbimeve	19.5	16.6	18.1	14.9	15.8	na	na
Importi mallrave dhe i shërbimeve	12.7	6.4	14	7	18.5	na	na
Produkti industrial bruto	29	14.1	14.4	12.1	8.6	3.8	na
Produkti bujqësor bruto	2.9	6.3	0.9	3	-1.9	2.5	na
<b>Punësimi</b>	(ndryshimi në përqindje)						
Krahu i punës (në fund të vitit)	-0.3	-0.1	-0.3	0	-0.2	3.1	na
Punësimi (në fund të vitit)	0.7	0.5	0.1	0.3	3.3	0.9	na
Fapunesia (në fund të vitit)	15	14.4	14.1	13.8	13.2	12.7	na
<b>Çmimet dhe pagat</b>	(ndryshimi në përqindje)						
Çmimet e konsumatorit (mesatare vjetore)	2.4	2.9	2.4	2.4	2.9	3.4	2
Çmimet e konsumatorit (në fund të vitit)	3.3	2.2	2	2.5	3.1	2.2	3
Çmimet e prodhuesit (mesatare vjetore)	6.2	10.8	5.1	0.1	4.1	6.5	na
Çmimet e prodhuesit (në fund të vitit)	4.4	12.3	1.5	0.2	6.6	4.3	na
Të ardhurat mesatare bruto mujore në ekonomi (mesatare vjetore)	12	2.8	5	9.2	25.2	12	na
<b>Sektori qeveritar</b>	(përqind e PBB-së)						
Bilanci i përgjithshëm qeveritar	-4.9	-5.1	-3.5	-3.3	-3.5	-5.7	-6.3
Shpenzimet e përgjithshme qeveritare	29	29.6	28.5	29	29.1	33	na
Bonhi i përgjithshëm i qeverisë	60.7	57.7	58.2	56.1	53.2	55.9	na
<b>Sektori monetar</b>	(ndryshimi në përqindje)						
Oferta e gjerë monetare (agregati M2, në fund të vitit)	7.6	12	8.9	12.1	5.3	10.3	na
Kredita e brendshme (në fund të vitit)	8.7	8.8	16.1	19.6	24.1	18	na
Oferta e gjerë monetare (agregati M2, në fund të vitit)	50.4	52.1	52.3	53.6	51.3	52.2	na
<b>Normat e interesit dhe të këmbimit valutor</b>	(përqind për vit, në fund të vitit)						
Norma e rifinancimit	6.5	5.3	5	5.5	6.3	6.3	na
Norma e bonove të thesarit (me maturitet 3-mujor)	7.3	6.2	5.4	6.4	6.3	6.3	na
Norma e depozitave (1-vjeçare)	7.6	6	5.6	5.5	6	6.9	na
Norma e huadhënies (1-vjeçare)	10.5	13.7	12.2	11.2	13.6	11.1	na
	(Lek për 1 dollar amerikan)						
Norma e këmbimit (në fund të vitit)	106.4	92.6	98.1	94.1	82.9	87.9	na
Norma e këmbimit (mesatarja vjetore)	121.3	102.8	98.1	98.1	90.4	83.5	na
<b>Sektori i jashtëm</b>	(milion dollarë amerikanë)						
Llogaria korente (rrethëse)	-398	-427	-726	-1,024.40	-1,147.80	-1,523.80	-1,680.50
Bilanci i tregtar	-1,336.00	-1,583.00	-1,821.00	-2,089.50	-2,899.60	-3,551.90	-3,537.00
Eksportet	447	601	656	792.9	1,078.70	1,355.60	1,125.20
Importet	1,783.00	2,184.00	2,477.00	2,882.30	3,978.30	4,907.50	4,662.10
Investimet e huaja të drejtpërdrejta, neto	178	324	258	314.7	647.4	843.7	578.1
Rezervat bruto, pa florin (në fund të vitit)	995.3	1,340.40	1,386.50	1,748.70	2,080.20	2,289.30	na
Bonhi i jashtëm	1,253.50	1,519.40	1,752.10	1,807.60	1,950.80	2,600.60	na
	(muaj importe mallrash dhe shërbimesh)						
Rezervat bruto, pa florin (në fund të vitit)	4.6	5	4.3	4.4	4.2	3.8	na
	(përqind e eksporteve të mallrave dhe shërbimeve)						
Shërbimi i bonhit	3.1	3.1	2.8	3.1	2.4	4.2	na
<b>Tregues të përbërë</b>	(siç tregohet në kilopa, pas zërave)						
Popullsia (në fund të vitit, në milion)	3.1	3.1	3.1	3.2	3.2	3.2	na
PBB (në miliardë lek)	694.1	750.8	814.8	891	980.1	1,064.00	1,110.00
PBB për frymë (në dollarë amerikanë)	1,844.70	2,341.70	2,648.70	2,883.00	3,422.80	4,005.90	na
Pjesa që ze industria në PBB (në përqind)	8.7	10	10.6	11	10.3	10.4	na
Pjesa që ze bujqësia në PBB (në përqind)	23.5	22.3	20.7	19.8	21	21.5	na
Llogari korente/PBB (në përqind)	-7	-5.8	-8.7	-11.3	-10.6	-15.1	-14.5
Bonhi i jashtëm - rezervat (në milion dollarë amerikanë)	258.2	179.1	365.6	58.9	-129.4	311.3	na
Bonhi i jashtëm/PBB (në përqind)	21.9	20.8	21.1	19.9	18	20.4	na
Bonhi i jashtëm/eksporte të mallrave (në përqind)	107.4	95	94.7	80.4	64.5	67.8	na

## **ANEKSI 5 – Çështjet Mjedisore dhe Sociale**

### **5.1 Mjedisi**

Pas fillimit të procesit të tranzicionit në 1990, zhvillimi ekonomik i Shqipërisë ka qënë i konsiderueshëm. Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social (SKZHES) ka krijuar mekanizma për një ekonomi tregu dhe është vënë re një përmirësim në fushat si privatizimi dhe liberalizimi i tregëtisë. Shqipëria dorëzoi aplikimin e saj formal për anëtarësimin e saj në BE në 28 prill 2009. Në fushëm mjedisore mund të raportohet një zhvillim i mirë në sistemin ligjor megjithëse nevojiten përmirësime në zbatimin dhe kapacitetet administrative, veçanërisht në nivelet rajonale dhe lokale. Gjithashtu, Shqipëria përballlet me sfida të rëndësishme mjedisore dhe sociale që lidhen me rritjen e qëndrueshme ekonomike , uljen e varfërisë, shpyllëzimin, ruajtjen e biodiversitetit dhe reformat mbi pronësinë e tokave.

### **Legjislacioni Mjedisor, Politikat dhe Angazhimet Ndërkombëtare**

Në vitin 1998, vendi kreu një reformë të rëndësishme kushtetuese në mënyrë që të përputhë legjislacionin e saj me BE. Një pjesë e rëndësishme e kësaj reforme ishte prezantimi i përbërësve mjedisorë dhe socialë nën direktivat e saj. Në vitin 2001, Agjensia Kombëtare Mjedisore u riorganizua për tu kthyer në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujrave (MMPMU) në përgjigje të nevojës së planifikimit dhe investimit në infrastrukturën mjedisore, sistemet e drejtimit të kanalizimeve dhe mjedisit dhe së fundmi për të rritur ndërgjegjesimin e industrive dhe publikut në përgjithësi mbi rendësinë e praktikave të qëndrueshme mjedisore. MMPMU mbikqyr një tërësi aktivitetesh si pronësia e tokës, strehimi, pyjet dhe ndryshimi i klimes, cilësia e ajrit, mbetjet e ngurta, mjekësore dhe të rrezikshme, ndotja e ujit dhe ndotja akustike si edhe sigurimin që Shqipëria të arrijë standartet mjedisore ndërkombëtare. Zbatimi i Ligjit mbi Mbrojtjen Mjedisore (2002) dhe Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor (2003) janë aktivitetet kryesore të Ministrisë së bashku me Ligjin mbi Avokatin e Popullit dhe Ligjin mbi Urgjencat Civile po prekin disa nga çështjet mjedisore. Së fundmi, në përgjigje të Raportit të Rekomandimeve të Komitetit të Ankesave të Konventës Aarhus, Ministria ka ndërmarrë një tërësi hapash për zhvillimin dhe zbatimin e një plan veprimi që përcakton mekanizmat e pjesëmarrjes publike në planet, programet dhe strategjitë dhe brenda procesit të saj të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

Si pjesë e reformave ligjore dhe politike, Plan Veprimi Kombëtar Mjedisor (PVKM) i vitit 1994 u rishikua në vitin 2002, i ndjekur nga zhvillimi i një Plan Veprimi kombëtar mbi Biodiversitetin (PVB). Në vitin 2005 u plotësua një raport i tretë për Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social (SKZHES) dhe Shqipëria filloi të zbatojë Sistemin e Planifikimit të Integruar (SPI): një strategji kombëtare e krijuar për të përfshirë Udhëzimet Mjedisore të BE në legjislacionin e saj mjedisor nëpërmjet një procesi të arsyeshëm të zhvillimit të politikës dhe zbatimin e sistemeve planifikuese si p.sh Synimet e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (SZHM) dhe Parneriteti për Paqe i NATO-s.

SPI ndihmon në sinkronizimin e mëtejshëm të marrjes së vendimeve në investimet qeveritare dhe ato afatgjata, duke ndihmuar në përforcimin e koordinimit të donatorëve. Megjithë shenjat e hershme të progresit, koordinimi me shoqërinë civile akoma ka nevojë për përmirësime të rëndësishme.

Në lidhje me marrëveshjet ndërkombëtare, Shqipëria është pjesë e:

- 1 Ndotja e Ajrit: Protokolli për Konventën e 1979 mbi Ndotjen e Ajrit në Nivel të Gjërë Ndërkufitar në Lidhje me Kontrollin e Emetimit të Oksideve të Nitrogjenit ose Flukset e tyre Ndërkufitare
- 2 Biodiversiteti: Konventa mbi Diversitetin Biologjik
- 3 Marrëveshja mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në një Kontekst Ndërkufitar (Espoo, 1991)
- 4 Ndryshimi Klimatik : Konventa e Sistemit të BE mbi Ndryshimin e Klimës
- 5 Protokolli i Kjos-Ndryshimi i Klimës: Protokolli i Kjos mbi Konventën e Sistemit të BE mbi Ndryshimin e Klimës
- 6 Shkretëtirëzimi: Konventa e BE për të Luftuar Shkretëtirëzimin në Vendet që Vuajnë nga Thatësitat Serioze dhe/ose Shkretëtirëzimi
- 7 Speciet e Rrezikuara: Konventa për Tregëtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës së Egër (CITES)
- 8 Mbetjet e Rrezikshme: Konventa e Bazelit mbi Lëvizjen Ndërkufitare të Mbetjeve të Rrezikshme dhe Sistemimin dhe Asgjësimin e Tyre
- 9 Ligji i Detit: Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Detit (LOS)
- 10 Mbrojtja e Shtresës së Ozonit: Protokolli i Montrealit mbi Substancat që Dëmtojnë Shtresën e Ozonit
- 11 Pjesëmarrja Publike: Konventa UNECE mbi të Drejtën e Publikut mbi Informacion, Pjesëmarrje në Vendimarrje dhe e Drejta për t'u Drejtuar Gjykatës për Çështje që lidhen me Mjedisin (Aarhus)
- 12 Ligatinat: Konventa mbi Rëndësinë Ndërkombëtare të Vendbanimeve Mocalike (Ligatinat) (Ramsar)

Zyra të tjera shtetërore që lidhen me problemet mjedisore në Shqipëri janë Drejtoria e Lejeve dhe Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, Drejtoria e Politikave për Parandalimin e Ndotjeve, Sektori Ligjor Mjedisor dhe Drejtoria e Shërbimeve të Ndhmës.

### **Sfondi i Përgjithshëm Mjedisor**

Shqipëria ka një vendodhje strategjike në jug-lindje të Europës e kufizuar nga Mali i Zi dhe Kosova në veri, Greqia në jug dhe Maqedonia në lindje. E vendosur përgjatë ngushticës së Otrantos, ajo ka lidhje të drejtpërdrejta në detin Adriatik, Jon dhe Mesdhetar. Nga ana gjeografike, ajo është e ndarë në 12 qarqe: Berati, Dibra, Durrësi, Elbasani, Fieri, Gjirokastra, Korça, Kukësi, Lezha, Shkodra, Tirana, dhe Vlora. Me vetëm 362 km vijë bregdetare përgjatë deteve Adriatik dhe Jon, pjesa e mbetur prej 70 përqind e sipërfaqes së vendit ka reliev malor, të ashpër dhe gjërësisht të pakalueshëm.

Në përgjithësi, Shqipëria ka një klimë kontinentale me dimër të ftohtë, me re dhe me shi

dhe verë të nxehtë, të qartë dhe të thatë. Megjithatë, me ultësirën e saj përgjatë vijës së bregdetit dhe malësive në tokën e Ballkanit, Shqipëria ka kushte klimaterike të larmishme dhe një numër të madh të rajoneve klimaterike për një sipërfaqe kaq të vogël (28,748 Km<sup>2</sup> sipërfaqe totale).

Mbi një të tretat e territorit të vendit është e pyllëzuar me mbi 3000 lloje të ndryshme bimësh me një dendësi prej 113 specie për 1,000 km<sup>2</sup>. Sipas Federatës Botërore për Mbrojtjen e Natyrës (WWF), Shqipëria ndahet në tre ekorajone: Pyjet gjetherënëse të Ilirisë, Pyjet e shumëllojshme të Maleve të Pindit dhe pyjet e shumëllojshme të Maleve Dinarike. Gjithashtu, vendi njihet për diversitetin e lartë të ekosistemeve dhe mjediseve të kafshëve dhe bimëve, që renditen nga zonat bregdetare të ndjeshme, ekosistemet bregdetare, kullotat dhe livadhet alpine dhe nën-alpine si edhe ekosistemet e maleve të larta.

Për sa i përket kafshëve të egra, në Shqipëri egzistojnë shumë specie të rralla dhe/ose të rrezikuara ku përfshihen por jo limitohen ujçërit, arinjtë bojë kafe, derri i egër, dhia e egër, rrëqebulli, dreri, macja e egër, shqarthe i pishave dhe qelbësi; hardhucat dhe zvarranikët si kameleoni afrikan dhe krokodili i Nilit dhe boa e rërës. Gjithashtu mund të gjenden edhe shpendët e egra si shqiponja e artë, thëllëza e shkëmbinjve, kukuvajka shqiponjë dhe katër specie të rrezikuara për zhdukje në familjen e shpendëve si: pelikani Dalmatian, shqiponja e madhe me pika, pelikani i llojit pygmy cormorant dhe rosa me kokë të bardhë.

Strategjia e Biodiversitetit dhe Plani i Veprimit njej 15 Parqe Kombëtare, 5 Zona të Mbrojtura Peisazhesh, 4 Rezerva të Caktuara Natyrore, 26 Rezerva Natyrore të Drejtuara dhe zona të tjera të mbrojtura.

Përveç MPMU, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Drejtoria e Lejave dhe Vleresimit të Ndikimit në Mjedis, Shoqata Shqiptare për Mbrojtjen e Shpendëve dhe Gjitarëve (ASPB, 1999) janë mjaft aktive në ruajtjen e specieve të kafshëve në zhdukje. Për sa i përket botës bimore, Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit kryeson më Urdhërin Nr. 20 (20-05-97) “mbi mbrojtjen e specieve të kërcënuara për zhdukje dhe të rralla të florës shqiptare”.

Ka dy vende kryesore të mbrojtura nga UNESCO në Shqipëri: Butrinti dhe Qendrat Historike të Beratit dhe Gjirokastra. i banuar që në kohët prehistorike, Butrinti ka qënë një shtëpi për kolonite greke dhe një qytet romak; e krijuar nga Ministria Shqiptare e Kulturës dhe UNESCO, ICCROM dhe ICOMOS, ajo është konsideruar si një trashëgimi e rëndësishme kulturore që kombinon komunitetin vendas dhe institucionet kombëtare për të shërbyer si një model për parqe të tjera në Shqipëri. Berati dhe Gjirokastra përbëjnë shembuj të rrallë të arkitekturës otomane kryesisht nga shekulli i XIII megjithëse origjina e tij shënohet që në shekullin e IV, me shumë kisha Bizantine dhe disa xhami otomane. Shqipëria ka tre vende të mbrojtura nga Konventa e RAMSAR me një sipërfaqe totale prej 83,062 hektarësh: Butrinti, Laguna e Karavastasë, Liqeni i Shkodrës dhe Lumi i Bunës dhe 7 vende të tjera në diskutim.

Burimet natyrore në Shqipëri janë: nafta, gazi natyror, qymyrguri, boksidet, kromi, bakri, hekuri, nikeli, kripa, lënda e drurit dhe burimet hidrike. Një element tjetër i rëndësishëm në ekonominë shqiptare është sektori i turizmit i cili po zhvillohet shume shpejt. Kjo do të thotë së është mjaft e domosdoshme një ristrukturim i organizuar i këtij sektori sepse zonat bregdetare vuajnë nga një ndotje e lartë dhe aktivitete të parregullta ndërtimi. Për me tepër, mungesa serioze e infrastructures (p.sh rugët, uji dhe prodhimi i energjisë) pengon më tej zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm.

Çështjet mjedisore më shumë shqetësuese janë shpyllëzimi; erozioni i tokës; ndotja e ajrit nga derdhjet industriale dhe shtëpiake dhe humbja e biodiversitetit të ndjeshëm. Gjithashtu ndodhin katastrofa natyrore ku përfshihen tërmetet shkatërruese, cunamit përgjatë bregdetit jug-perëndimor, përmbytjet dhe thatësitat e mëdha.

### **Ndryshimi i klimës**

Shqipëria iu bashkua Konventës sipas Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimin e Klimës (UNFCCC) në vitin 1995 si një vend i jo-aneksuar i duke kryer me mbështetjen e UNDP-GEF hapa të rëndësishëm drejt zbatimit të saj si plotësimi i dokumentit të Komunikimit të Parë Ndërkombëtar (FNC – 1998/2002) dhe përgatitjen e Dokumentit të Komunikimit të Dytë Ndërkombëtar (SNC), zbatimin e Vlerësimit mbi Nevojat Teknologjike (VNT-2000/2004), përgatitjen e Projektit mbi Përmirësimin e Cilësisë së Inventarëve të GES për Europën lindore dhe CIS (2003/2006) dhe krijimin e një Plan Veprimi Kombëtar (PVK) për të zgjidhur problemet me ndryshimin e klimës. Mbi këto linja, Programi mbi Njësinë e Ndryshimit të Klimës (CCUP) u strukturua duke u fokusuar në tre fusha kryesore: inventaret e GES, dobësitë dhe ndryshimet si edhe financimi për uljen e nivelit të GES dhe karbonit. Gjithashtu Shqipëria nënshkroi Protokollin e Kjosës në vitin 2004.

Planifikimi i ardhshëm për Shqipërinë në lidhje me ndryshimin e klimës përfshin rritjen e temperaturave mesatare, rritja e rrezikut të nxehtësisë, përmbytjet e mëdha të rastësishme si edhe ulje të rreshjeve mesatare vjetore, zvogëlimin e burimeve të ujit dhe tokave të punueshme. Zonat më shumë të ekspozuara janë ato gjatë vijës bregdetare ndërsa sektorët e ndikuar përfshijnë burimet e ujit, turizmi, bujqësia dhe energjia. Ndërkohë Shqipëria ka probleme serioze në sektorin e energjitikës si ndërprerjet e vazhdueshme të energjisë, mjetet egzistuese të vjetëruara dhe jo të efektshme në fushën e energjitikës, ulja e rrjedhës së lumenjve/burimeve të ujit nga rreshjet dhe ulja e furnizimit me energji në sajë të kapaciteteve të limituara për prodhim të hidrocentraleve. Ushtrimi i Komunikimit Kombëtar ka vërtetuar që është nxitës për fillimin e projekteve dhe programeve të tjera mbi zbutjen dhe përshtatjen mbi ndryshimet e klimës si edhe për të rritur ndërgjegjësimin mbi problemet që lindin nga ndryshimi i klimës. FNC (2002) tërhoqi vëmendjen mbi dobësitë kryesore në sektorin e energjitikës duke përfshirë kërkesën për energji elektrike për ngrohjen/freskimin e vendbanimeve dhe ngrohjen/ftohjen e ujrave duke parashikuar se në vitin 2025 temperaturat më të lara mund të ulin kërkesën për energji elektrike me 12-16 përqind për ngrohjen e banesave ndërsa në mënyrë të kundërt, kërkesa për freskim do të rritet sepse parashikimet tregojnë se stina e verës po behet gjithnjë e më e nxehtë. Megjithatë, kërkesat për energji elektrike nuk do të ndikohen vetëm nga temperaturat por edhe nga nivelet e rreshjeve, shpejtësia e erës dhe dendësia e reve, sepse një pjesë e mirë

e energjisë së prodhuar në vend mundësohet nga hidrocentralet, dhe këto pajisje do të kushtëzohen nga një ulje e pritshme në vëllimin e rreshjeve dhe ndryshimet e shpejtësisë së erës.

Shqipëria ka bërë një progres të mirë në zbatimin e mjaft zgjedhjeve dhe rekomandimeve të FNC dhe TNA në NES të saj si edhe në Ligjin mbi Efiçencën e Energjisë dhe energjisë së Rinovueshme të miratuar nga parlamenti në vitin 2005. Në fillim të vitit 2009, Banka Botërore dhe Qeveria e Shqipërisë me fonde granti të siguruara nga Programi i Asistencës për Menaxhimin e Sektorit të Energjitikës dhe Fondi Trust mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm Mjedisore dhe Social, gjithashtu organizuan disa seminare mbi ndryshimin e klimës dhe dobësitë e sektorit të energjitikës për të vlerësuar mundësitë për mekanizmat ndihmues, kostot dhe përfitimet e tyre. Megjithë arritjet e fundit mbi problemet për ndryshimin e klimës, nevoja për ta kthyer atë në një politikë dhe planifikim kombëtar vazhdon të jetë e madhe. Përveç masave për uljen e niveleve të GEF, është e nevojshme të kryehen ndryshime sidomos në sektorët më të cënueshëm si burimet ujore, agrikultura, ruajtja e biodiversitetit dhe turizmi. Zyrtarizimi i procesit të Komunikimit Kombëtar është mjaft i rëndësishëm për të siguruar një raportim për veprim të qëndrueshëm dhe cilësor.

### **Fushat e Problemeve Mjedisore dhe Prioritetet**

Arritjet e Shqipërisë në reformat kryesore politike janë të konsiderueshme, me marrëveshjen e përkohshme të BE të zbatuar pa ndërprerje. Sfidat kryesore që mbeten fokusohen në zbatimin e ligjit dhe funksionimin e duhur të institucioneve shtetërore ku kapacitetet administrative dhe zbatuese janë pikat më të dobëta. Programi i harmonizimit të BE në vend mbi ligjet mjedisore mund të jetë një mjet i nevojshëm për kryerjen e reformës në për të përshpejtuar përmirësimet, veçanërisht nëpërmjet mekanizmave për një vlerësim të rregullt të progresit mjedisor. Fushat e prioritetit përfshijnë:

- 1 Ndërtimi i Kapaciteteve Institucionale: nevojiten përpjekje të mëtejshme për përforcimin e kapaciteteve administrative të zbatimit dhe krijimit të politikave mjedisore, së bashku me koordinimin dhe bashkëpunimin institucional. Programet për trainimin e punonjësve paralelisht me rritjen e numrit të punonjësve Brenda zyrave qeveritare u theksua si një problem kryesor nga shumë raporte të IFN-ve.
- 2 Cilësia e ajrit: cilësia e ajrit përbën një problem të madh veçanërisht në zonat urbane ku ndotja arrin nivelet më të larta në Europë. Megjithëse janë përdorur pajisje të përparuara teknologjike për monitorim dhe emetimet e industrive të mëdha janë zvogëluar pak, nuk ka një politikë të qartë dhe të qëndrueshme afatgjatë nga qeveria. Ligjet egzistuese mbi ndotjen industriale janë të pakëta dhe zbatimi vazhdon të jetë i dobët ku çështjet rreth emetimeve të gazrave të banesave dhe mjeteve të transportit si edhe cilësia e karburantit kërkojnë një vëmendje urgjente.
- 3 Ruajtja dhe mbrojtja e biodiversitetit: rritja e ndërtimeve urbane të pastruara po ndikon në mënyrë negative në ekosisteme, veçanërisht në zonat detare dhe bregdetare të cilat janë me deliakte. Për shembull, humbja e vendbanimeve bregdetare vlerësohet të jete 200 metra toke bregdetare në çdo 20 vjet. Të dhenat

- e fundit tregojnë se gjate 25 vjetëve të fundit, afersisht 122 specie vertebrorësh (27 gjitare, 89 shpendë dhe 6 peshq) dhe kater lloje humbën më shumë se 50 përqind të popullatës së tyre. Për më tepër, 2 lloje bimësh dhe 4 specie gjitarësh u zhdukën dhe 17 lloje shpendësh nuk ngrejnë fole ne vend. Zbatimet e mëtejshme të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe ligjet e forta pritet që të ulin nivelin e humbjeve të biodiversitetit dhe te ruajnë speciet e rrezikuara.
- 4 Plani i Ndikimit të Katastrofave Natyrore: politika kombetare mbi uljen e riskut të katastrofave natyrore u miratua ne vitin 2000. mekanizmat e zbatimit bazohen ne krijimin e një Departamenti të Përgjigjes dhe Planifikimit të Urgjencave Civile në Ministrinë e Qeverisë Lokale dhe Decentralizimit. Me një mbështetje të fuqishme nga Programi për Menaxhimin e Katastrofave dhe Përgatitjen e Urgjencave (PMKPU) nga PNUD-i, prioriteti është fokusuar në dy plane: Ulja e Riskut të Katastrofës (2002) dhe Plani Kombetar i Urgjencës Civile (pritet te miratohet që ne 2007). Arritjet mbi këto nisma mbeten të ngadalëta.
  - 5 Menaxhimi i Mbetjeve: Përveç zbatimit te disa rregullave për rehabilitimin e disa venddepozitimeve (p.sh programi për venddepozitimin e Sharrës u përmirësua në vitin 2007), dhe rehabilitimit të pikave kritike toksike, veçanërsht për Qendrën e Shkrijes së Bakrit në Rubik, Uzina per Polenizimin e Nitratit ne Fier, Uzina Kimike ne Durrës dhe rafineria e naftes ne Ballsh, ne menaxhimin e mbetjeve jane kryer arritje të vogla. Metodat aktuale per depozitimin dhe djegien përbejne rreziqe te medha mjedisore dhe shëndetësore, ndersa sistemet moderne të mbledhjes, depozitimit dhe prceseve te riciklimit nuk egzistojne akoma.
  - 6 Menaxhimi dhe Konservimi i Ujit: megjithese mundesimi i pergjithshëm me uje të pijshëm dhe sistemet e furnizimit me ujë janë përmirësuar, ujerat e sipërfaqes ndikohen ndjeshëm nga ndotja urbane, e vendbanimeve dhe industriale. Skemat mbi furnizimin e ujit dhe higjenes publike vazhdojnë të jene mjaft të vjetëruara. Deri në vitin 2007 nuk është miratuar akoma nje Strategji Kombetare per Ujesjellësin dhe Kanalizimet.
  - 7 Zhvillimi Urban dhe Turizmi: urbanizimi i shpejte dhe i paorganizuar dhe kërkesa në rritje për zhvillimin industrial dhe turizmin përmbajnë probleme mjedisore qe duhet te zgjidhen me shpejtësi duke përfshire investimet urgjente ne infrastrukturën mjedisore. Për shembull, ka një arritje te vogël ne ristrukturimin dhe zgjerimin ne sektorin e turizmit, megjithëse është vënë re pak progres, infrastrukturaa e përgjithshme – rrugët, uji, prodhimi i energjisë – është i prapambetur dhe pengon zhvillimin e turizmit. Zonat bregdetare gjithashtu kanë nivele të larta të ndotjes dhe aktiviteteve të parregullta të ndërtimeve.
  - 8 Masat Kundër Derdhjeve Ndotëse: Në vitin 1993 u miratua një plan kombëtar urgjence dhe një sistem kombëtar mbi ndotjen detare aksidentale, gatishmërinë dhe reagimin ndaj saj. Autoritetet lokale dhe industritë e naftës janë nxitur për krijimin e planeve kombëtare të urgjencës të koordinuara me planin kombëtar, megjithëse nuk ka një skemë për zbatimin, politika të përcaktuara reaguese dhe as pajisje të specializuara kundër ndotjes në vend.

### **Çështjet Mjedisore që lidhen me Prioritetet Operacionale në Shqipëri**

Strategjia e Vendit përcakton katër nivele të larta të prioriteteve operacionale në

aktivitetet e Bankës në Shqipëri për periudhën e strategjisë 2009-2011. Tabela e mëposhtme tregon në mënyrë të shkurtuar disa nga çështjet e rëndësishme mjedisore dhe sociale që lidhen me secilën nga këto prioritetet:

Prioriteti	Çështje të Rëndësishme Mjedisore dhe Sociale
Financimi i projekteve mjedisore, prodhimit të energjisë dhe të infrastrukturës.	<ul style="list-style-type: none"> <li>o1 Siguria dhe Gjendja shëndetësore në Punë: Mungesa e kapacitetit dhe standarteve të ulëta i kushteve të sigurisë dhe standarteve në punë është përsëritur nga shumë IFN.</li> <li>o2 Mungesa e burimeve dhe gatishmëria e dobët e IF dhe NVM për të zgjidhur çështjet mjedisore dhe sociale në bizneset kryesore si aktivitetet e derdhjeve dhe mbetjeve të ngurta.</li> <li>o3 Përdorimi i paqëndrueshëm i ujit për të rritur prodhimin/furnizimin me ujë</li> <li>o4 Pasojat ekologjike nga përdorimi jo i rregullt i burimeve (Uji, era, toka, biodiversiteti)</li> <li>o5 Mungesa e rregullave / kapaciteti për drejtimin e zëvendësimeve / procesit që lidhet me shpronësimet gjatë aktiviteteve të blerjes së tokës për zhvillimin e infrastrukturës (pajisjet e përpunimit, mullinjtë me erë etj).</li> <li>o6 Rritja e tarifave të shërbimeve bazë të sektorit më të varfër të popullsisë</li> <li>o7 Rritja e rrjedhave në infrastrukturë dhe efekteve të saj në mjedis.</li> <li>o8 Ndotja e ujit e shoqëruar me mbetjet bujqësore, përdorimit të plehërave kimikë dhe pesticideve.</li> <li>o9 Kushtet e sigurisë dhe shëndetësore në punë, veçanërisht në industrinë e ndërtimit</li> <li>o10 Public consultation processes, Aarhus convention.</li> </ul>
Financimi në sektorin financiar për huadhënien drejt konsolidimit/ristrukturimit të sektorit.	<ul style="list-style-type: none"> <li>o11 Trajtimi i mbetjeve të prodhimeve ushqimore dhe të gjitha ndikimet mjedisore që lidhen me të.</li> <li>o12 Çështjet e punës si puna e fëmijëve dhe rrogat minimale.</li> <li>o13 Çështjet mbi ruajtjen e tokës. Humbja e Biodiversitetit</li> <li>o14 Kushtet e Sigurisë dhe Shëndetësore në Punë</li> </ul>
Financim direkt për ndërmarrjet e huaja/lokae me përpjekje të vazhdueshme për të arritur NVM;	<ul style="list-style-type: none"> <li>o15 Mungesa e kapaciteteve në IF dhe NVM për zgjidhjen e çështjeve mjedisore, sociale dhe të punës.</li> <li>o16 Blerja/zëvendësimi i tokës për digat, rezervuaret dhe pajisjet e përpunimit</li> <li>o17 Proçesi i shkurtimeve në sektorin e shërbimeve publike</li> </ul>
Dialogu për Politikën (Qeveria e re për të zgjidhur mangësitë rregullatore dhe në infrastrukturë)	<ul style="list-style-type: none"> <li>o18 Përforcimi i Plan Veprimit Kombëtar (p.sh Biodiversiteti, Katastrofat Natyrore, Reagimet ndaj Derdhjeve të Rrezikshme etj.)</li> <li>o19 Këshillimet Publike të Pakëta me shoqërinë civile, Konventa e Aarhus</li> <li>o20 Kushtet e Sigurisë dhe Shëndetësore në Punë kryesisht në industrinë e ndërtimit</li> </ul>

Banka do të vazhdojë të punojë në sektorë të ndryshëm dhe atje ku është e zbatueshme do të identifikojë fushat për përmirësimin mjedisor dhe mundësitë e zhvillimit që përputhen me prioritetet e Bankës. Për shembull, Banka po punon aktualisht në vendosjen e prioritetëve për përmirësimin mjedisor të pikave kritike të Fushës së Naftës së Patos



Marinzës si një pjesë e një Grupi Punë ndërministror. Gjithashtu, Banka po punon me projektin e Bashkëpunimit Teknik mbi Shkurtime të Shoqërisë Shtetërore të Naftës AlbPetrol dhe do të vazhdojë të ofrojë programe trajnimi për ndërmjetësit financiarë që kërkojnë për zbatimin e procedurave të menaxhimit të riskut social dhe mjedisor të Bankës dhe si rrjedhim mbështetjen e një zhvillimi të qëndrueshëm mjedisor në sektorin e NVM-ve. Pjesëtarët e punonjësve të Bankës kanë marrë pjesë në trajnimin e autoriteteve rajonale mjedisore dhe shoqërive të sektorit privat mbi pjesëmarrjen publike dhe zbatimin e konventës së Aarhus, dhe do të vazhdojë të ndihmojë qeverinë shqiptare atje ku është e duhur në këto probleme.

Të gjitha aktivitetet e Bankës në Shqipëri i nënshtrohen politikës përkatëse mjedisore (ose Politikës Mjedisore 2003 ose Politikës Mjedisore dhe Sociale 2008) dhe përfshijnë atje ku është e duhur Planet e Veprimit Mjedisor dhe Social në dokumentat ligjore në mënyrë që të zgjidhin problemet që lindin gjatë due diligence në përputhje me urdhërin e Bankës për të mbështetur në mënyrë aktive zhvillimin e qëndrueshëm mjedisor nëpërmjet projekteve të saj investuese.

## 5.2 Çështjet Sociale

**Zhvillimi Shoqëror dhe Migrimi:** Shqipëria renditet në nivele të ulëta në krahasim me vendet e tjera në tranzicion të Europës Jug-Lindore dhe Qëndrore në lidhje me standartet normale të jetesës dhe treguesit e zhvillimit të shoqërisë. Sipas statistikave zyrtare, në vitin 2008 popullsia e Shqipërisë ishte 3,170,048 ose 3.5 përqind më e lartë se regjistrimi zyrtar në vitin 2001. Jetëgjatësia mesatare është 76.2 vjet. Emigracioni dhe nivelet e ulëta të lindjes kanë shkaktuar një ulje të madhe në përqindjen e popullsisë nën 34 vjet – nga 69.2 përqind në vitin 1969 në 58.2 përqind në vitin 2007. Sipas Qendrës Ndërkombëtare për Migracionin, pothuajse një e katërta e popullsisë së Shqipërisë është larguar nga vendi që në vitin 1990, kryesisht në vendet fqinjë Greqi dhe Itali së bashku me një migracion të madh nga zona urbane në atë rurale. Pjesa më e madhe e migracionit në Shqipëri ka karakter qarkullues, i ndikuar nga ekonomia dhe i përqëndruar në sektorët e ekonomisë joformale dhe me aftësi të ulëta (emigrantët shqiptarë punojnë kryesisht në sektorët e ndërtimit ose bujqësisë ndërsa gratë në punët shtëpiake). Megjithatë, migracioni është gjërësisht i përhapur edhe ndërmjet shqiptarëve të shkolluar. Studimet tregojnë se afërsisht 45 përqind e profesorëve dhe studiuesve të universiteteve dhe institucioneve janë larguar nga Shqipëria pas vitit 1990, dhe afërsisht 2,000 deri 4,000 studentë shqiptarë largohen nga vendlindja çdo vit për të ndjekur universitete jashtë vendit. Duke e quajtur këtë problem si “ikja e trurit”, në vitin 2006 qeveria nisi Programin e Thithjes së Trurit (<http://www.braingain.gov.al>), i cili mbështet krijimin e nismave të nevojshme dhe mekanizmave kombëtarë politikë që angazhojnë shqiptarët e diasporës në zhvillimin shkencor, administrative dhe ekonomik të vendit.

**Varfëria dhe Papunësia.** Rritja e lartë e PBB-së në Shqipëri në 10 vitet e fundit së bashku me një rritje mesatare (në terma realë) të rrogave prej 36.5 përqind ndërmjet vitit 2005 dhe 2008 dhe një rritje prej 17.5 përqind të pensioneve ndërmjet viteve 2005 dhe 2007 ka ndihmuar në një ulje të rëndësishme të varfërisë ndërmjet vitit 2005 dhe 2008. Rezultatet e një studimi të drejtuar nga një skuadër e përbashkët e INSTAT-it, PNUD-it

dhe Bankës Botërore tregojnë se në vitin 2008 12.4 përqind e popullsisë ishin të varfër – të përcaktuar se kishin të ardhura më pak se 5,722 Lekë për person në muaj – e krahasuar me 18.5 përqind në vitin 2005 dhe 25.4 përqind në vitin 2002. Kjo tregon se afërsisht gjysma e popullsisë së varfër në vitin 2002 dolën nga varfëria në vitin 2008. Si rezultat, konsumi mesatar për person është rritur me afërsisht 7 përqind që në vitin 2005. Ndërsa varfëria në zonat rurale u ul me afërsisht 47 përqind, fakt që tregon se varfëria mund të mos jetë më një problem kryesisht në zonat rurale. Për shembull, megjithëse Tirana ka nivelin më të ulët të varfërisë ndërmjet qarqeve, nuk ka patur ulje të mëtejshme në krahasim me vitin 2005. Forca punëtore vendase në vitin 2008 ishte 35 përqind e popullsisë së përgjithshme. Niveli i papunësisë u ul në 12.68 përqind në vitin 2008 në krahasim me 13.78 përqind në vitin 2006 sipas treguesve statistikorë zyrtarë. Sektorët me rritjen më të madhe të numrit të punonjësve ishin industria, transporti, telekomunikacioni, tregëtia, hotelet dhe restorantet. Në korrik 2008, qeveria rriti minimumin e rrogës mujore në 17,000 lekë (rreth 130 Euro), ndër më të ulëtat në rajon.

**Pabarazia gjinore.** Ndërsa gratë dhe vajzat kanë shumë liri të drejta si rezultat i ndryshimeve politike të 17 viteve të fundit në Shqipëri, shumë gra u kthyen në kryetare të familjeve kryesisht në sajë të emigrimit të burrave. Treguesi i Zhvillimit Gjinor (TZHGJ) për Shqipërinë është 0.80 duke e renditur të 68-ën ndërmjet 177 shteteve. Gjatë periudhës së tranzicionit, gratë vuajtën vështirësi të ndryshme nga dhuna dhe trafikimi për shfrytëzim seksual. Shumë gra vuajnë nga varfëria dhe mungesa e shërbimeve shëndetësore dhe sociale. Rrogat e grave janë ndërmjet 20 dhe 50 përqind e rrogës së burrave, ndërsa burrat zotërojnë 92 përqind të të gjithë pronave dhe marrin afërsisht 84 përqind të Prodhimit të Brenshtëm Bruto (PBB). Vetëm 7 përqind e parlamentarëve shqiptarë janë gra. Disa çështje shqetësuese përfshijnë mundësinë e edukimit themelor për vajzat veçanërisht për ato që jetojnë në zonat rurale si edhe pjesëmarrja e pakët e grave në politikë, si në nivelet qendrore dhe ato lokale.

**Të drejtat mbi pronën, kompesimi dhe rikthimi.** Reforma mbi fushën e të drejtave mbi pronën ka kryer hapa të rëndësishëm përpara. Agjencia për Rikthimin dhe Kompesimin e Pronës vazhdon procesin e rikthimit dhe kompesimit dhe është në fazën përfundimtare në krijimin e hartës së vlerësimit të trojeve, mbi bazën e të cilësdo të kryhet kompesimi. Ndërkohë, Agjencia për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Zonave me Ndërtime të Paligjshme po plotëson hartën dixhitale të të gjithë vendit. Gjithashtu, këto dy agjensi kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për të koordinuar këto dy procese dhe për të përshpejtuar reformën.

Në vitin 2006, Parlamenti i Shqipërisë miratoi ligjin mbi kompesimin dhe rikthimin e pronës i cili synon që të zgjidhë pretendimet mbi pronësinë e tokës nga shpronësimi i tokës gjatë kohës së komunizmit. Zbatimi i suksesshëm i procesit të rikthimit është një sfidë e rëndësishme e qeverisë dhe është parësore për zhvillimin e ardhshëm ekonomik. Në vitet 2007 dhe 2008, qeveria shpërnda një shumë prej 7 milion Euro për kompesimin financiar. Në vitin 2009 u miratua një buxhet prej 15 milion Euro i cili mund të jetë përsëri i pamjaftueshëm në sajë të numrit të lartë të kërkesave për kompesim. Struktura e plote e kërkesave të kompesimit dhe rikthimit të pronave nuk pritet të zgjidhet përpara vitit 2014.

**Arsimi.** Arsimi është i lirë dhe i detyrueshëm për fëmijët nga gjashtë deri në moshën katërbëdhjetë vjeç dhe i lirë deri në moshën 18 vjeç. Megjithatë, Shqipëria ka përqindjen më të ulët të frekuentimit të shkollës së mesme ndërmjet vendeve të rajonit (55 përqind në vitin 2006). Arsyeja kryesore për nivelin e lartë të mungesës së shkollimit të plotë është varfëria ndërkohë që familjet në zonat rurale janë të detyruar të që fëmijët të punojnë. Rritja e nivelit të frekuentimit të shkollës së mesme veçanërisht në zonat rurale dhe kryesisht për femrat është prioriteti i sistemit të Partneritetit Europian. Shpenzimet publike mbi arsimin u zvogëluan gjatë periudhës së tranzicionit, duke arritur në 3.1 përqind të PBB-së në vitin 2004 por kohët e fundit ka filluar të rritet për të zbatuar prioritetin që qeveria ka përcaktuar mbi arsimin në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013. Shkollat në qytete dhe në zonat periferike veprojnë përtej kapaciteteve të tyre. Në kontrast, disa zona rurale kanë raporte të ulëta student-nxënës por infrastruktura e pazhvilluar e transportit nuk lejon zhvillimin e shkollave. Në një periudhë dy vjeçare, qeveria krijoi laboratore për teknologjinë e informacionit në të gjitha shkollat e mesme dhe pritet që ato të pajisen me internet.

Në vitet e fundit, qeveria ka hapur universitete të reja në Shqipëri të cilat së bashku me universitetet e reja private rrit mundësinë e të gjithëve për të ndjekur universitetin. Për më tepër, numri i studentëve të cilët diplomohen jashtë vendit është rritur ndjeshëm, duke krijuar një brez të rinjsh me aftësi profesionale. Ligji i ri mbi arsimin e lartë rrit mundësitë për zhvillime të rëndësishme. Veçanërisht universitetet kanë liri akademike dhe organizative si edhe autonomi financiare. Megjithatë, institucionet e arsimit të lartë duhet ta zbatojnë në praktikë këtë autonomi. Ata nuk kanë një system të brendshëm drejtues dhe as një mekanizëm të jashtëm përgjegjësie. Nuk egzistojnë rregulla për administrimin e ecurisë së universitetit. Cilësia e infrastrukturës duhet të përmirësohet më tej sepse disa ndërtesa, pajisje dhe biblioteka nuk i përmbushin standartet ndërkombëtare. Ka pak transparencë në përdorimin e të ardhurave të universitetit. Mekanizmi i mbështetjes së studentëve më të ardhura të pakëta (bursat) nuk është i përcaktuar mirë. Shtrirja dhe cilësia e edukimit profesional nuk i përgjigjen kërkesave të tregut dhe vazhdon të ketë lidhje të dobëta me tregun e punës dhe partnerët shoqërorë.

## **Shëndetësia**

Sistemi i shëndetit publik vuan nga fragmentarizimi, mungesa e investimeve, largimi i personelit të kualifikuar mjekësor drejt sektorit privat si edhe një pakësim në nivel të gjërë të personelit në zonat e largëta. Gjatë fillimit të viteve 90, sistemi i centralizuar shëndetësor i Shqipërisë, i mbështetur në dhënie falas të shërbimeve në pikën e shërbimit (duke përfshirë edhe banorët e zonave të largëta) u shpërbë nën presionin e migrimit të pakontrolluar nga fshati në qytet. Në vitin 2007 financimi i shërbimeve kryesore të kujdesit ndaj shëndetit iu transferua Institutit të Sigurimit të Shëndetit (ISSH). Megjithatë, pagesat e shërbimeve shëndetësore të bazuara mbi taksat rezultojnë të jenë të padrejta në lidhje me shërbimet ofruara të kujdesit ndaj shëndetit. Mbulimi me sistemin e sigurimeve vazhdon të jetë i limituar në më pak se 40 përqind të popullsisë, të përqëndruar kryesisht në zonat urbane dhe me të ardhura mbi mesatare.

Vdekshmëria foshnjore ka rënë por vazhdon të mbetet e lartë në krahasim me vendet e tjera të Europës dhe vdekshmëria e nënave vazhdon të jetë një problem. Turbekulozi i cili ishte zhdukur gjatë kohës së komunizmit është rishfaqur si pasojë e varfërisë dhe mbipopullimit në qytetet kryesore. Sistemi i kujdesit të shëndetit po përballet me sfida të reja sepse profili epidemiologjik i popullsisë po ndryshon. Sëmundjet jo të transmetueshme, kryesisht sëmundjet kardiovaskulare dhe kanceri po bëhen shkaku kryesor i vdekjeve. Ndër faktorët kryesorë të riskut të shëndetit janë konsumimi i lartë i duhanit si edhe ndryshimi i dietave. Për këtë arsye, sistemi shëndetësor duhet të ndryshojë në trajtimet mjekesore të gjata dhe të kushtueshme në lidhje me këto sëmundje dhe të kujdesit shëndetësor parandalues dhe fushatave publike shëndetësore. Shpenzimet publike mbi shëndetësinë janë rritur në vitet e fundit në rreth 6 përqind të PBB-së, e cila përsëri qëndron nën nivelin e shteteve të tjera me të ardhura të ngjashme. Shëndetësia, si edhe arsimi, është një prioritet i autoriteteve por shpenzimet e buxhetit mbi shëndetësinë shpesh ndërpriten si rrjedhojë e mungesës së të ardhurave.

## ANEKSI 6 – Projektet e Bankës për Bashkëpunim Teknik 2006-2009

Burimi i Donatorit	Lloji i Kontratës	Burimi i Fondeve	Titulli i Kontratës	Shuma EUR Kont.	Sektori i NJSHK (Njësia e Shërbimit të Konsulencës)
	Call-Off	Buxheti i Bankës	Due Diligence mbi Integritetin	28,490	Finance (E Përgjithshme)
	Kandidat për Bord	Buxheti i Bankës	Kandidate për Bordin e Jashtëm për Procredit Bank Shqipëri	5,128	NVM
	Standarte	Buxheti i Bankës	Studim i Kërkesës për Linjën e Kredisë Mjedisore për Vendet ku vepron BERZH që Ndikojnë në Detin Mesdhe – Shqipëria dhe Koordinimi i Projektit – Faza 2	42,400	Reforma Mjedisore dhe Sociale
GRE	Standarte	BT (Jo-BE)	Mbështetje Këshillimore për Komisionin e Letrave me Vlerë Shqiptare mbi projektligjin e ri mbi obligacionet	159,978	Reforma Ligjore
	Call-Off	Buxheti i Bankës	Rishikim i Dokumentave të Tenderit për Mbikalimin e Kamzës	5,823	Transporti
	Standarte	Buxheti i Bankës	Vlerësim Ekonomik dhe Pamje e përgjithshme e reformës	15,151	Transporti
	Standarte	Buxheti i Bankës	Projekti i Rehabilitimit të Rrugës Levan-Vlore - Due Diligence Ekonomike	31,349	Transporti
ITA	Standarte	BT (Jo-BE)	Due Diligence Teknike për BI-INVEST Sh.p.k.	750	Industri dhe Prodhim
ICFF	Standarte	BT (Jo-BE)	Banka Popullore	499,684	Finance (E Përgjithshme)
ITA	Standarte	BT (Jo-BE)	BI Invest, DD Ligjore, ËBLEF	15,000	Industri dhe Prodhim
	Standarte	Buxheti i Bankës	Studim Marketingu mbi Tregun e Çimentos në Shqipëri dhe në shtetet fqinje	10,487	Industri dhe Prodhim
	Standarte	Buxheti i Bankës	Asistencë mbi Veprimtarinë dhe Menaxhimin e Riskut	39,700	Financë (E përgjithshme)
	Standarte	Buxheti i Bankës	Vlerësim i Biodiversitetit të Rrugës Levan - Vlore	5,000	Transport
	Standarte	Buxheti i Bankës	Due Diligence Ligjore e AGROTAL –LEF BP	20,000	Agrobiznes

ITA	Standarte	BT (Jo-BE)	Due Diligence Ligjore e AGROTAL –LEF BP	10,000	Agrobiznes
CEI	Grant	BT (Jo-BE)	Programi për Krijimin e Kreditore në Tiranë (CEP)	336,116	Financë (E përgjithshme)
	Standarte	Buxheti i Bankës	Vlerësimi i Biodiversitetit të Rrugës Levan - Vlorë	3,968	Transport
	Call-Off	Buxheti i Bankës	Shqipëri: Rruga Unaza e Madhe në Tiranë, Pjesa nga RR. Kavajës deri te RR. Elbasanit	6,554	Transport
	Grant	Buxheti i Bankës	Projekti i Rrugës Levan-Vlorë – Asistencë mbi Masat Zbutëse Mjedisore dhe Planit i Menaxhimit Mjedisor	19,328	Transport
	Standarte	Buxheti i Bankës	Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës – Faza B e Zhvillimit – Studimi i Fizibilitetit	12,000	Transport
	Standarte	Buxheti i Bankës	Konsulta mbi aktivitetet e Peshkimi dhe Turizmit në Vlorë	500	Reformë Mjedisore dhe Sociale
	Standarte	Buxheti i Bankës	Vlerësimi i Zbatimit të Planit të Veprimit të Mbi Strehimin	6,928	Transport
	Lender	Buxheti i Bankës	Monitorim Teknik i Huadhënësit	154,000	Reformë Mjedisore dhe Sociale
	Standarte	Buxheti i Bankës	Rruga Unaza e Madhe e Tiranës: Vlerësim dhe Monitorim i Zbatimit të Planit të Veprimit të Strehimit	49,930	Reformë Mjedisore dhe Sociale
	Standarte	Buxheti i Bankës	Asistent i DPK	9,789	NVM
	Standarte	Buxheti i Bankës	Drejtor i Programit Kombëtar	21,395	NVM
	Standarte	Buxheti i Bankës	Drejtues Projekti	14,302	NVM
	Standarte	Buxheti i Bankës	Drejtor i Programit	53,939	NVM
ICFF	Call-Off	BT (Jo-BE)	Auditim mbi Energjinë në Fushë Krujë dhe Elbasan, Shqipëri	36,630	Industri dhe Prodhim
ICFF	Grant	BT (Jo-BE)	Strategjia e Qëndrueshme e Transportit për Rrugët Bashkiake të Tiranës	273,450	Infrastruktura Bashkiake
	Call-Off	Buxheti i Bankës	Due Diligence e Integritetit të Terminalit Bregdetar të Vlorës	18,676	Transport
ITA	Standarte	BT (Jo-BE)	Asistencë Ligjore	20,000	Financë (Inv.me Pjesëmarrje në Kap. Vet nga Banka)
	Standarte	Buxheti i Bankës	Projekti i Rrugës së Unazës së Madhe Tiranë Analizë Fianciare e Bashkisë Tiranë	13,935	Infrastruktura Bashkiake

ECAL	Standarte	TC (EU)	Programi për Zhvillimin e Rregullatorit të Telecomit (Shqipëria III)	770,950	Reformë Ligjore
	Standarte	Buxheti i Bankës	Marketingu mbi Programin e Shërbimeve të Konsulencës për Biznes dhe Fushata e MP	5,879	NVM
	Call-Off	Buxheti i Bankës	Tirex – Kontrolli mbi Integritetin	13,778	Natural Resources
ITA	Standarte	BT (Jo-BE)	Due Diligence Teknike dhe Tregëtare	32,355	Industri dhe Prodhim
ITO3	Grant	BT (Jo-BE)	Studim Paraprak i Fizibilitetit mbi Burimet Ujore në Shqipërinë e Veriut	692,020	Infrastruktura Bashkiake
ITA	Standarte	BT (Jo-BE)	Due Diligence Ligjore	30,000	Industri dhe Prodhim
ËEBF	Grant	BT (Jo-BE)	Zhvillimi i Sistemit mbi Menaxhimin e Informacionit i Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare (AMF)	388,813	Financë (E përgjithshme)
	Kandidat për Bord	Buxheti i Bankës	Kandidat i BERZH për Bordin e Drejtorëve - INSIG	17,900	Financë (Inv.me Pjesëmarrje në Kap. Vet nga Banka)
	Standarte	Buxheti i Bankës	Due Diligence Teknike e Qëndrës Tregëtare Tiranë	7,000	Prona dhe Turizëm
	Standarte	Buxheti i Bankës	Due Diligence e Tregut e Qëndrës Tregëtare Tiranë	14,000	Prona dhe Turizëm
ËEBF	Grant	BT (Jo-BE)	Studim i Zhvillimit –Rruga Unaza e Madhe Tiranë	386,850	Infrastruktura Bashkiake
	Standarte	Buxheti i Bankës	Dispozita e Programit të Trajnimit “Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Ushqimeve”	7,076	NVM
ITA	Standarte	BT (Jo-BE)	Bonot e Korporatave RIA mbi Projekt Ligjin mbi Bonot e Korporatave dhe Bashkiake	24,750	Reformë Ligjore
ITA	Standarte	BT (Jo-BE)	Shqipëria: RIA Bashkiake mbi Projekt Ligjin mbi Bonot e Korporatave dhe Bashkiake	12,389	Reformë Ligjore
ICFF	Grant	BT (Jo-BE)	Strategjia mbi Transportin e Qëndrueshëm për Rrugët Bashkiake të Tiranës	26,550	Infrastruktura Bashkiake
	Standarte	Buxheti i Bankës	Krijimi dhe Përmirësimi i Portali Ëeb Këshillues	15,920	NVM
	Standarte	Buxheti i Bankës	Asistencë për Rindërimin e Sektorit Energjitik ne Shqipëri dhe Projektet për Rehabilitimin e Shperndarjes – Rishikimi i Vlerësimit të Performancës së Veprimtarisë (OPER)	15,148	Energjitikë
ITA	Standarte	BT (Jo-BE)	RIA Bashkiake mbi Projekt Ligjin mbi Bonot e Korporatave dhe Bashkiake	12,361	Reformë Ligjore

ËEBF	Grant	BT (Jo-BE)	Union Bank – Asistancë me Zbatimin e Programit për Ndërtimin Institucional (“IBP”)	205,865	Financë (Inv.me Pjesëmarrje në Kap. Vet nga Banka)
CEI	Call-Off	BT (Jo-BE)	Zhvillimi i Modelit për Zgjidhjet me Kosto të Ulët për Përmirësimin e Efiçencës së Energjisë të Inst. Arsimore të Bashkisë Tiranë	44,850	Energjitikë



## **ANEKSI 7 – Asistenca shumëpalëshe dhe dypalëshe**

### **I. ASISTENCA SHUMËPALËSHE**

#### **FONDI MONETAR NDËRKOMBETAR**

Që kur u bë anëtare në vitin 1991, Shqipëria është angazhuar në pesë programe të mbështetura nga FMN, të cilat kanë qënë të suksesshme në arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit makroekonomik. Në mungesë të politikave të tjera, programet e FMN-së janë konsideruar si një “garant” për stabilitetin ekonomik duke përfshirë institucione të tjera shumëpalëshe dhe dypalëshe që kanë ndihmuar Shqipërinë. Gjithashtu, në 18 vitet e fundit, Shqipëria ka përfituar nga asistenca teknike e FMN-së për të përforcuar projektin e saj të politikës, zhvillimin e kapaciteteve zbatuese dhe përmirësimin e krijimit të të dhënave statistikore.

Programi i fundit 3-vjeçar PRGF/EFF (Fondi i Reduktimit të Varferise dhe Rritjes Ekonomike dhe Fondi i Zgjeruar) perfundoi në janar 2009. Në atë kohë, qeveria vendosi të mos kërkojë një zgjatje të misionit të FMN, me arsyetimin se tani vendi ishte në gjendje të ruante stabilitetin ekonomik dhe ndikimi i krizës botërore financiare në Shqipëri është i limituar.

#### **GRUPI I BANKËS BOTËRORE/KFN**

Republika e Shqipërisë ka qënë një anëtare e Bankës Botërore dhe Korporatës Financiare Ndërkombëtare (KFN) që në vitin 1991. Që atëherë grupi i Bankës Botërore ka siguruar një mbështetje të madhe për Shqipërinë, duke përfshirë 73 hua kryesisht në projekte të SHNZH (Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim) me një total rreth 1021 milion dollarë, projekte të KFN-së rreth 125 milion dollarë dhe garanci të MIGA (Agjensia Shumëpalëshe e Garantimit të Investimeve) me një total rreth 8.6 milion dollarë. Cilësia e portofolit aktiv ka vazhduar të përmirësohet duke rritur përqëndrimin në kapacitetet afatgjata për zhvillim dhe zbatim nëpërmjet strukturave qeveritare.

Bordi i Bankës Botërore miratoi Strategjinë e Asistencës për Shqipërinë (CAS) për vitet fiskale 2006-2009 në janar 2006. CAS i ri prezantoi një program mbështetës për të vazhduar zhvillimin e mëtejshëm të drejtimit dhe progresit të përmirësuar makroekonomik në reformat strukturore që janë kryer që në vitin 2002. Ai synonte të mbështeste Strategjinë Kombëtare të Shqipërisë për Zhvillimin Ekonomik dhe Social (“SKZHES”) (më tej Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim) dhe procesin e Bashkimit European për Stabilizim Asocim (SAP) me objektivin e fundit të integritimit në BE dhe arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit. Grupi i Bankës Botërore është në procesin e përgatitjes së një Strategjie të re për Partneritetin e Vendit për Shqipërinë për periudhën 2010-2013.

Duke pasqyruar prioritetet e qeverisë, programi i CAS (2006-2009) synoi mbështetjen e përpjekjeve të Shqipërisë për përforsimin e qeverisjes, ruajtjen e rritjes së sektorit privat dhe përmirësimin e shpërndarjes së shërbimeve. CAS theksoi nevojën e kryerjes së përpjekjeve më koherente për të zgjidhur problemin e qeverisjes se dobët në Shqipëri dhe prezantoi një “Filtër Qeverisjeje” për të siguruar që çështjet e qeverisjes të përqëndrohen në të gjitha aktivitetet e Bankës. Programi i CAS u përqëndrua në dy shtylla:

**I. Rritja e Vazhduar Ekonomike Përmes Mbështetjes për Zhvillimin e Sektorit Privat,** me rezultatet e pritura që përfshijnë (a) stabilitetin makroekonomik; (b) përmirësimin e klimës së biznesit nëpërmjet rregullave të biznesit me cilësi më të mirë dhe dialogut të zhvilluar ndërmjet sektoreve publike e private; (c) zhvillimin e infrastrukturës publike (d) rritjen e efektshmërisë operationale të institucioneve financiare; (f) zhvillimin e qeverisjes së shoqërive; (g) rritjen e transparencës dhe efektshmërisë në drejtimin e shpenzimeve publike dhe institucioneve më të fuqishme për planifikimin, tenderimin dhe sigurimin e infrastrukturës dhe shërbimeve; (h) përgjegjësinë më të madhe në administrimin publik; dhe (i) menaxhim dhe planifikim më të mirë të burimeve në bregdetin e Shqipërisë.

**II. Përmirësimi i Realizimit të Shërbimeve, veçanërisht në Sektorët Socialë,** me rezultatet e pritura që përfshijnë; (a) përmirësimin e arritjeve në arsim dhe cilësia në arsimin bazë; (b) përmirësimin e efektshmërisë dhe financimin në shëndetësi; (c) cilësinë më të lartë në shëndetësi; (d) qëndrueshmërinë më të zhvilluar fiskale të sistemit të sigurimeve shoqërore dhe rritjen e mundësive për asistencë me synime të qarta, të qëndrueshme dhe të efektshme; dhe (e) përmirësimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.

Nën programin e CAS 2006-2009, Banka Botërore financoi rreth 260 milion dollarë në operacionet e reja huadhënëse, rreth gjysma të siguruara nga SHNZH dhe gjysma nga BNRZH. Në qershor 2008, Shqipëria mbaroi programin e SHNZH-së dhe tani ka të drejta të plota për huamarrje nga BNRZH. Portofoli aktual huadhënës nën zbatim është afërsisht 300 milion dollarë (duke përfshirë një Garanci të Pjesëshme Risku prej 78 milion dollarë) dhe përfshin 18 operacione (duke përfshirë 2 grante të plota të Linjës Globale të Financimit të Mjedisit). Portofoli është i shpërndarë në sektorët si vijon: 10 përqind në bujqësi dhe mjedis, 15 përqind në shërbimet sociale, 20 përqind në menaxhimin e tokës dhe mjedisit të biznesit (me disa shërbime në infrastrukturë), dhe 55 përqind në infrastrukturë, kryesisht në rrugë, energjitikë, ujësjellës dhe kanalizime. Banka Botërore dhe Banka kanë bashkëpunuar në disa projekte në sektorin e energjitikës.

Strategjia e KFN-së në Shqipëri përqëndrohet në mbështetjen e zhvillimit të sektorit privat dhe përmirësimin e mjedisit të biznesit. Përpjekjet e tyre fokusohen në nevojën e rritjes së investimeve të huaja direkte në vend dhe ndihmën për të prezantimit të konceptit të partneritetit privat-publik (PPP) në sektorët socialë dhe të infrastrukturës. KFN e shtrin përfshirjen e saj në: (i) Rritjen e mbështetjes për sektorin financiar dhe përforsimi i tregut financiar; (ii) Ndihmën për ristrukturimin dhe kërkimin e mundësive për investime në sektorët kryesorë: transport, energjitikë, furnizimi me ujë dhe telekomunikacioni; (iii)

Ndihmën për përforcimin e tregjeve përkatëse strategjike duke siguruar asistencë teknike për përmirësimin e aktivitetit të autoriteteve rregullatore në telekomunikacion dhe eneregjitikë; (iv) Sigurimin e shërvimeve të konsulencës për Partneritetet Private-Publike në sektorët strategjikë dhe socialë; (iv) Sigurimin e asistencës financiare dhe teknike për sipërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Shuma e investimeve të KFN-së në Shqipëri është 125 milion USD. Investimet përfshijnë sektorët si sektori financiar (7 përqind), industria e përgjithshme përpunuese (37 përqind), infrastruktura (33 përqind), dhe nafta dhe gazi (23 përqind). Përveç këtyre, KFN kreu 10 projekte për asistencë teknike duke përfshirë sigurimet, huadhënien e aktiveve (lizingu), mundësimin e informacioneve të NVM-ve, përgatitjen e shoqërive vendase për hyrjen në BE, pengesat administrative për investitorët dhe financimi i blerjes së shtëpive. KFN dhe BERZH kanë bashkëfinancuar projekte në sektorin financiar (Banka ProCredit, Banka Kombëtare Tregëtare, INSIG) dhe në sektorin privat të korporatave.

## **BANKA EUROPIANE E INVESTIMEVE**

BEI është një aktor kryesor në zbatimin e objektivave prioritare të BE-së në zonën e Ballkanit. Aktive në Shqipëri prej vitit 1994, BEI ka kontribuar me mbi 240 milion euro për projekte të një rëndësie kyce për ekonominë shqiptare siç janë investime të ndryshme në fushën e infrastrukturës duke përfshirë edhe energjitikën dhe transportin.

Gjatë periudhës 2000-2008, BEI ka dhënë hua të cilat përfshijnë 34 milion Euro për rehabilitimin e korridorit veri-jug, 30 milion Euro për transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë (e bashkëfinancuar nga BERZH, BB dhe donatorë të tjetër dypalësh), 17 milion Euro për rehabilitimin e Porit të Durrësit dhe 27 milion Euro për rehabilitimin e objekteve të ujësjellës-kanalizimeve në pesë qytete të Shqipërisë në kuadër të një skeme konçesionare nga KE dhe donatorë të tjerë, 40 milion Euro për financimin e termocentralit të Vlorës.

Strategjia afatmesme e BE për Ballkanin Perëndimor ka identifikuar si fusha prioritare investimesh infrastrukturën kombëtare, locale dhe bashkiake dhe mbështetjen e nërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Në përputhje me këto prioritete, BEI po bashkëpunon me BERZH për të bashkëfinancuar terminalin e trageteve në Portin e Durrësit.

## **BE**

Asistenca e BE-së për Shqipërinë filloi në vitin 1991 përmes Programit PHARE që përfshinte:

- 1 CARDS (Programi i Ndihmës nga Komuniteti për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim)+OBNOVA (1991-2000): EUR 528 million
- 2 CARDS (2000-2006): 316 milion Euro
- 3 IPA (2007-2011): 401 milion Euro
- 4 ECHO (Ndihmë humanitare) (1991-2000): 135 milion Euro
- 5 Të tjera (1991-2000): 249 milion Euro

Që në mars 2002, KE ka raportuar zhvillim për vendet e Ballkanit Perëndimor. Raporti përshkruan marëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe BE, analizon situatën në Shqipëri nga pikëpamja e kritereve politike dhe ekonomike për anëtarësim dhe rishikon kapacitetin e Shqipërisë për zbatimin e standarteve europiane që duhet ti afrohen gradualisht legjislacionit dhe politikave të BE të deritanishme, në përputhje me prioritetet e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA) dhe Partneritetit European (PE).

Shqipëria është një kandidate e mundshme për anëtarësimin në BE. Marrëveshja e Stabilizim Asocimit (MSA) u nënshkrua në qershor 2006. Shqipëria po merr pjesë në **Proçesin e Stabilizim Asocimit (PSA)**. **Partneriteti European** ndihmon në sigurimin e progresit në prioritetin e reformave nëpërmjet dialogut politik dhe ekonomik.

Pas hyrjes në fuqi e marrëveshjes ndërmjet KE dhe Shqipërisë mbi lehtësimin e vizave në janar 2008, takimi i parë i përbashkët i komisionit u krye në prill 2008. Marrëveshja për lehtësimin e vizave thjeshton procedurat për lëshimin e vizave për disa kategori qytetarësh në Shqipëri, ku përfshihen studentët, akademikët, biznesmenët, gazetarët dhe turistët. Sipas kushteve të kësaj marrëveshjeje, qytetarët e Shqipërisë ose paguajnë një kuotë më të ulët për vizat ose marrin një vizë pa pagesë.

Zbatimi i marrëveshjes së ripranimit që hyri në fuqi në vitin 2006 po kryhet në mënyrë të rregullt. Kjo marrëveshje përcakton qartë detyrimet dhe procedurat për autoritetet shqiptare dhe të Shteteve Anëtare të BE se ku dhe si të tërheqin mbrapsht personat që jetojnë në mënyrë ilegale në teritoret e tyre.

Që në vitin 2007, **asistenca financiare** për para-anëtarësimin për Shqipërinë është siguruar nën Instrumentin e Asistencës për Para-Anëtarësimin (IPA). KE caktoi një fond total prej 70.7 milion Euro në vitin 2008. Dokumenti Tregues Shume-Vjeçar Planifikues (MIPD) për vitet 2008-2010 për Shqipërinë nën IPA u miratua në shtator 2008. Fushat kryesore të përqëndrimit vazhdojnë të jenë drejtësia dhe punët e brendshme, ndërtimi i kapaciteteve administrative, zhvillimi ekonomik dhe social dhe stabiliteti demokratik. Asistenca e vazhduar e CARDS dhe IPA është zbatuar nga Delegacioni i Komisionit European në Tiranë. Menaxhimi i ndihmës mbi bazën e decentralizimit është një objektiv afatmesme për Shqipërinë. Marrëveshja e Sistemit të IPA-s u nënshkrua në 18 tetor 2007. Marrëveshja e financimit për Programin Kombëtar për vitin 2007 nën Asistencën e Tranzicionit dhe Pjesa e Ndërtimit Institucional u nënshkrua në 22 janar 2008 dhe zbatimi i programit ka filluar. Marrëveshjet e Financimit për programet e bashkëpunimit ndërkufitar u nënshkruan në prill 2008.

Në lidhje me mbështetjen e **shoqërisë civile**, u caktuan 4 milion Euro për projektet që rrisin rolin e shoqërisë civile dhe medias në proçesin e integritit european gjatë periudhës 2008-2010. Shqipëria është mbështetur nga shtetet anëtare të BE nëpërmjet Monitorimit dhe Qendrës së Informacionit për Mbrojtjen Civile (MIC) të BE për të ndihmuar të merren masat për pasojat e shpërthimit të Gërdecit në mars 2008.

Në lidhje më **programet e Komunitetit**, Shqipëria po merr pjesë në programin e Sistemin e Kërkimit të 7-të për të cilin është nënshkruar një memorandum mirëkuptimi

në dhjetor 2007. Gjithashtu, vendi po merr pjesë në Programin e Sistemit per Ndërmarrjet dhe Risitë, në vazhdim të nënshkrimit të memorandumit të mirëkuptimit në qershor 2008.

Datat kryesore në rrugën e Shqipërisë drejt BE:

- 1 **28 prill 2009** - Shqipëria paraqet aplikimin për anëtarësimin në BE
- 2 **Prill 2009** - Hyn në fuqi MSA
- 3 **Mars 2008** - Hapja e dialogut për liberalizimin e vizave
- 4 **Shkurt 2008** - Vendim i Këshillit mbi rishikimin e Partneritetit Europian
- 5 **Janar 2008** - Shqipëria dhe KE nënshkruajnë Marrëveshjen e Financimit të Programin e IPA 2007
- 6 **Janar 2007** - Hyn në fuqi instrumenti i ri për Asistencën e Para-Anëtarësimin (IPA)
- 7 **Dhjetor 2006** - Hyn në fuqi Marrëveshja e Përkohshme
- 8 **Qershor 2006** - Nënshkrimi i MSA
- 9 **Maj 2006** - Hyn në fuqi marrëveshja e ripranimit KE-Shqipëri
- 10 **Janar 2006** -Vendimi i Këshillit mbi rishikimin e Partneritetit Europian (PE) për Shqipërinë
- 11 **Qershor 2004** - Vendimi i këshillit mbi PE të parë për Shqipërinë
- 12 **Qershor 2003** - Në Këshillin Europian në Selanik, Proçesi i Stabilizim Asocimit (SAP) u konfirmua si politikë e BE për Ballkanin Perëndimor. Perspektiva e BE: vendet që marrin pjesë në SAP janë të pranueshme për hyrjen në BE dhe mund ti bashkohen BE kur të jenë gati.
- 13 **2001** - Viti i parë për Programin e Ndihmës nga Komuniteti për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim (CARDS)
- 14 **Nëntor 2000** - Samiti i Zagrebit fillon Proçesin per Stabilizim Asocim (SAP) për pesë vendet e Europës jug-lindore, duke përfshirë Shqipërinë.
- 15 **Qershor 2000** - Këshilli Europian konstaton se të gjitha shtetet e SAP jane “kandidate të mundshme” për anëtarësimin në BE
- 16 **2000** - Zgjerimi i hyrjes së *duty-free* në tregun e BE për produktet nga Shqipëria.
- 17 **1999** - Shqipëria përfiton nga Preferencat Autonome Tregëtare me BE
- 18 **1999** - BE propozon Proçesin e Stabilizim Asocimit (SAP) për pesë vende të Europës jug-lindore, duke përfshirë Shqipërinë.
- 19 **1997** - Regional Approach. The EU Council establishes political and economic conditionality for development of bilateral relations.
- 20 **1992** - Marrëveshja Tregëtare dhe Bashkëpunuese ndërmjet BE dhe Shqipërisë. Shqipëria konsiderohet e pranueshme për financim nën programin PHARE.

## II. ASISTENCA DYPALËSHE

Donatorët më të mëdhenj dypalësh në Shqipëri janë si më poshtë, të renditur sipas rendit alfabetik:

### Gjermania

Qeveria Gjermane, si njëri prej partnerëve më të rëndësishëm të Shqipërisë në bashkëpunimin për zhvillim, ka angazhuar deri tani një vlerë progresive prej rreth 476 milion Euro, nga të cilat 424 milion Euro në bashkëpunim financiar dhe 52 milion Euro

në asistencë teknike.

Gjatë periudhës 2008/2009, Gjermania ka dhënë 86 milion euro për bashkëpunimin financiar dhe 4.5 milion euro për bashkëpunimin teknik.

Projektet e bashkëpunimit financiar janë zbatuar nga KfW në emër të Qeverisë Federale Gjermane dhe janë përqendruar në sektorët e mëposhtëm:

1 *Ujësjellës dhe kanalizime dhe menaxhimin e mbetjeve* – përfshin projekte në disa qytete dhe në zonat rurale si për investime për rehabilitimin e sistemeve të ujësjellsave ashtu edhe për zbatimin e masave të mbështetjes institucionale në nivel njësie vendore.

2 *Sektori financiar* – projekti kryesor është Banka ProCredit, institucioni kryesues në Shqipëri për mikro kreditë, aksionerë të së cilës janë edhe BERZH-i dhe KFN-ja.

3 *Energjitikë* – projektet kryesore janë ndërtimi i linjës 400 kV nga Tirana në Podgoricë (Mal të Zi), i linjës 400 kV nga Shqipëria në Kosovë dhe linja e rrjetit 110 kV në Shqipërinë e jugut. Paralelisht, po bëhen edhe përmirësime institucionale dhe financiare në këtë sektor në bashkëpunim të ngushtë me IFN dhe donatorë të tjerë.

Programet e asistencës teknike zbatohen nga GTZ në emër të qeverisë federale dhe kanë në qendër të vëmendjes nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, si p.sh. trainimet profesionale, zhvillimin e sektorit privat dhe fuqizimin e sistemit ligjor si edhe mbështetjen institucionale në sektorin e ujësjellësit. Bashkëpunimi rajonal është arritur nëpërmjet Fondeve të Hapura Rajonale nga GTZ.

Gjatë vititeve 2008/2009 bashkëpunimi do të vazhdojë të ketë në qendër të vëmendjes sektorët e energjitikës dhe të ujësjellës-kanalizimeve dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Gjithashtu, një projekt mjedisor i Bashkëpunimit Financiar mbështet bashkëpunimin rajonal në rajonin e Prespës.

## **Italia**

Italia është donatori më i madh dypalësh i Shqipërisë me një vlerë progresive gjithsej të fondeve të lëvruara gjatë periudhës 1991-2004 mbi 650 milion Euro. Ndihma e Italisë për Shqipërinë është zhvilluar, nga një ndihmë për periudhën e emergjencës në fazat e para të tranzicionit politik dhe ekonomik në Shqipëri, në një qasje zhvillimi më afatgjatë dhe gjatë 15 viteve të fundit janë nënshkruar tre protokolle dypalëshe. Ai i fundit, i nënshkruar në vitin 2002 parashikon financimin e Italisë prej 202 milion Euro (42 milion Euro janë grante dhe 160 milion janë kredi të buta). Kredite të buta prej 25 milion Euro i janë caktuar sektorit të ujësjellësit dhe energjitikës. 120 milion Euro janë caktuar për nismat e zbatuara nga OJQ-të, agjensitë, institucioneve shqiptare dhe Bashkëpunimit Italian. Aktualisht janë 93 nisma që janë akoma në proces dhe fushat kryesore përfshijnë:

1. *Sektorin e energjisë elektrike* – kjo ka qenë fusha kryesore e mbështetjes qysh prej vitit 1994 ku përfshihen ndërhyrjet emergjente si edhe për rehabilitimin e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë. Italia po punon në këtë sektor bashkë

me BERZH-in, Bankën Botërore dhe donatorë të tjerë.

2. *Furnizimin me ujë* – financimi për këtë sektor ka pasur në qendër të vëmendjes zonën rreth Tiranës dhe përfshin asistencë për shoqërinë lokale të ujësjellësit.
3. *Transportin* – Italia është përfshirë në financimin e rehabilitimit të disa segmenteve rrugore urbane dhe kombëtare, BT për për përmirësime strukturore të Drejtorisë së Rrugëve dhe përmes mbështetjes për mirëmbajtjen dhe riparimin e rrugëve. Italia ka bashkëfinancuar projektin e emergjencës së rehabilitimit të rrugëve me BERZH-in.
4. *Shërbimet sociale*, shëndetësinë dhe arsimin – kjo përfshin rindërtimi i shkollave, programet e shkëmbimeve universitare, rehabilitimi i qendrave të kujdesit shëndetsor dhe mbështetja menaxheriale

Asistenca e Italisë ka ndryshuar në lidhje me ndryshimet e rritjes ekonomike në prioritetet e zhvillimit të vendosura nga qeveria. Në përputhje me programet mbështetëse të Bashkimit Europian të para-anëtarësimit me standartet ndërkombëtare, Bashkëpunimi Italian po ndryshon prioritetet e vendosura nga disbursimi i kredive të buta për infrastrukturën në disbursimin e ndihmës së synuar për mbështetjen e sektorit social dhe NVM-ve.

## **Japonia**

Një tjetër donator i rëndësishëm për Shqipërinë është edhe Japonia. Asistenca dypalëshe japoneze ka filluar në vitin 1990 dhe përfshin një sërë programesh, nga financimi me grante dhe kreditë deri te asistenca teknike përmes Agjensisë të Bashkëpunimit Ndërkombëtare Japoneze (JICA) si edhe Fondit të Besimit të BERZH-it dhe të Bankës Botërore. Sektorët kryesorë që kanë përfituar nga asistenca japoneze janë zhvillimi i infrastrukturës sociale dhe ekonomike si energjika (që përfshin edhe projektin e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë të bashkëfinancuar me BERZH-in), bujqësia dhe pyjet, ujësjellës-kanalizime, arsimit dhe shërbimet shëndetësore.

Një aritje e madhe në vitin 2008 ishte nënshkrimi i marrëveshjes për huanë prej 11 miliard Jen japonezë (81.7 milion Euro) për projektin e zhvillimit të Sistemit të Kanalizimeve në Tiranë. Totali i asistencës japoneze për Shqipërinë gjatë 2008 arriti për huatë në 18 miliard Jen (133.7 milion Euro), financim në grante në 4 miliard Jen (29.7 milion Euro) dhe asistencë teknike në 1.6 miliard Jen (11.9 milion Euro).

## **Mbretëria e Hollandës**

Aktivitetet dhe strategjitë kryesore të Mbretërisë së Hollandës për periudhën 2008-2011 janë paraqitur në një Plan Strategjie Shumëvjeçare. Në periudhën 2008-2011, Holanda do të përfshijë gradualisht bashkëpunimin dypalësh për zhvillim dhe do të ndryshojë pozicionin e saj me një përqëndrim më të madh në çështjet e integritit në BE/çështjet politike/të drejtat e njeriut, tregëtare, ekonomike dhe kulturore. Deri në vitin 2012 fondet do të jenë në dispozicion për të mbështetur zhvillimin e sektorit privat.

Vendimi për të përfshirë gradualisht bashkëpunimin për zhvillim në Shqipëri u shoqërua nga vendimi për ti dhënë Shqipërisë mundësinë e përdorimit të fondit “Matra” në mbështetje të proceseve transformuese në shoqëri duke përdorur masa dypalëshe ndërmjet organizatave shqiptare dhe organizatave europiane.

Në aktivitetet e saj bashkëpunuese, Ambasada e Mbretërisë së Hollandës është përqëndruar dhe do të vazhdojë të fokusohet për pjesën tjetër të mbetur të programit në fushën e mjedisit (rehabilitimi i pikave kritike, ndërgjegjësimi mjedisor, zhvillimi institucional), procesin e demokratizimit (fuqizimin e sektorit të OJP), qeverisjen e mirë (lokale) (si p.sh menaxhimin e financimit public), procesin e decentralizimit (p.sh Fuqizimi i Qeverisjes Lokale në Qarkun e Dibrës). Disa ndërhyrje të veçanta kanë filluar në mbështetje të pabarazisë gjinore dhe të drejtat e minoriteteve seksuale dhe fëmijëve.

## **Zvicra**

Shqipëria është mbështetur nga Zvicra qysh prej fillimit të bashkëpunimit me vendet e Evropës Lindore. Asistenca zvicerane ka qysh në vitin 1991 që zbatohet nga Sekretariati Shtetëror i Çështjeve Ekonomike (“SECO”), dhe nga viti 1995 përmes Agjencisë Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (“AZZHB”). Në fillim të vitit 1997, u hap në Tiranë Zyra Bashkërenduese për Bashkëpunim dhe Ndihmë Humanitare, e cila financohet në mënyrë të përbashkët nga AZZHB dhe SECO. Kjo zyrë ka për detyrë mbikqyrjen dhe monitorimin e programit të bashkëpunimit zviceran në Shqipëri.

Në maj 2007 u nënshkrua një strukturë e re marrëveshjeje në lidhje me bashkëpunimin teknik me Shqipërinë dhe kjo përfshin të gjithë aktivitetet e drejtuara nga AZZHB dhe SECO në Shqipëri. Kohëzgjatja e saj është e papërcaktuar dhe mund të përfundojë në çdo kohë nga njëra nga qeveritë. Çdo projekt është subjekt i një marrëveshjeje të veçantë me ministrinë përkatëse.

Strategjia e asistencës zviceriane është paraqitur në Strategjinë e Bashkëpunimit Zvicerian me Shqipërinë që mbulon një periudhë 2006-2009 dhe do të rinovohet për periudhën 2010-2013. Ndihma e asistencës zviceriane përfshin sektorët e demokratizimit dhe decentralizimit, përfshirjen sociale, arsimimin profesional, zhvillimin e sektorit privat, uji, energjika dhe fusha e mjedisit.

Asistenca totale zviceriane për periudhën 2010-2013 të strategjisë së re është 56 milion franga zviceriane.

## **SHBA**

Agjensia për Zhvillimin Ndërkombëtar e Qeverisë së SHBA (USAID) po zbaton programet amerikane për të huajt dhe ndihme ekonomike që në vitin 1961. USAID ushtron aktivitet në Shqipëri prej vitit 1992. Gjatë kësaj kohe USAID/Shqipëri, përmes Fondit në Mbështetje të Demokracisë në Evropën Lindore (“SEED”), ka lëvruar më shumë se 438 milion USD në mbështetje të tranzicionit dhe zhvillimit afatgjatë në Shqipëri.



Programi i asistencës i USAID synon ta ndihmojë Shqipërinë të ecë drejt një vendi brenda bashkësisë së vendeve demokratike të orientuara nga ekonomia e tregut dhe të bëhet një forcë shtytëse e paqes, stabilitetit dhe prosperitetit në mbarë Evropën Juglindore.

USAID/Shqipëri zbaton një program me gamë të gjerë i cili ka për synim nxitjen e rritjes ekonomike dhe të uljes së varfërisë, fuqizimin e institucioneve demokratike dhe shoqërisë civile, përmirësimin e sistemit ligjor dhe uljen e korrupsionit, rritjen e efikasitetit të sistemit të kujdesit shëndetsor dhe nismat e posaçme të cilat përfshijnë energjitikën dhe trafikimin e qenieve njerëzore.

USAID/Shqipëri ka një staf prej 31 punonjësish: 8 punonjës amerikanë dhe 18 punonjës shqiptarë. USAID bashkëpunon ngushtë me organizatat amerikane joqeveritare, institucione vendase, bizneset amerikane dhe agjensi të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.

Portofoli aktual përbëhet nga 24 aktivitete, disa prej të cilave renditen më poshtë:

- 1 Programi i Konkurrueshmërisë Bujqësore Shqiptare (zhvillimi bujqësor)
- 2 Programi për Zhvillimin e Ndërmarrjeve Konkurruese (zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme)
- 3 Projekti i Pushtetit Vendor në Shqipëri
- 4 Programi i Zbatimit të Ligjit (anti korrupsion)
- 5 Pro Shëndetit (Kujdesi parësor Shëndetësor)
- 6 Aksioni Transnacional Kundër Trafikimit të Fëmijëve
- 7 Koordinimi i Veprimeve Kundër Trafikimit Njerëzor
- 8 Marrëveshja Prag e Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë

Informacion në lidhje me USAID/Shqipëri gjendet në <http://albania.usaid.gov> ose në adresën Ambasada Amerikane, Rr. Elbasanit, Nr. 103, Tirana, Albania, Tel. +355 4 224 7285.

## **ANEKSI 8 – Aktiviteti i TAM/BAS në Shqipëri**

### **Eksperiencia e mëparshme në Shqipëri**

Programi TAM/BAS mbështet tranzicionin ekonomik nëpërmjet arritjes së ndryshimit të ndërmarrjeve të suksesshme mikro, të vogla dhe mesatare në vendet ku vepron Banka. Deri tani, katër shoqëri që iu është ofruar ndihma e TAM/BAS në Shqipëri kanë tërhequr pesë investime të Bankës ose ndërmjetësve të tjerë financiarë me një vlerë të përgjithshme projekti prej 17 milion Euro. Për më tepër, trajnimi i TAM/BAS mbi efikasitetin e energjisë i përgatit shoqëritë për linjat e financimit të kredive të Bankës mbi efikasitetin e energjisë, që janë në proces për tu ofruar.

**TAM** mbështet prezantimin e praktikave më të mira ndërkombëtare në NVM-të me mundësinë për tu bërë drejtues të ardhshëm në tregun e tyre nëpërmjet caktimit të konsulentëve me eksperiencë. Gjithashtu, Programi kryen aktivitete seminari dhe trainimi për prezantimin e praktikave më të mira ndërkombëtare duke paraqitur studime-rasti të suksesshme të ndërmarrjeve.

Që prej fillimit në vitin 1996, TAM ka kryer një total prej 37 projektesh në Shqipëri, në sektorët e industrisë dhe e shpërndarë edhe në NVM dhe mikro. Projektet janë të shpërndara në kryeqytet, në Tiranë dhe në qytete të tjera.

**BAS** ka efekt ndihmues për përdorimin e konsulentëve vendas dhe privatë nga NMVM-të për të siguruar shërbime. BAS punon në anën e kërkesës dhe sigurimit. Duke ndihmuar ndërmarrjet për të punuar me konsulentë lokalë në projekte të veçanta specifike me shlyerje të shpejtë, Programi nxit kërkesën dhe pranimin e përfitimeve duke përdorur konsulentë të jashtëm. Gjithashtu, ai rrit në mënyrë direkte sigurimin dhe cilësinë e shërbimeve konsulente lokale nëpërmjet aktiviteteve për zhvillimin e tregjeve të synuara.

Programi BAS u krijua në qershor 2006 me fonde të siguruar nga Holanda dhe më vonë siguroi fonde nga Banka, ESSF, Luksemburgu dhe Portugalia. Deri në qershor 2009, BAS ka kryer 121 projekte në total me NMVM-të, duke përfshirë 66 konsulentë lokalë. Përveç projekteve standarte të BAS, gjithashtu Programi ka zhvilluar trainime për konsulentët lokalë.

### **NMVM-të në një mjedis biznesi në përmirësim gradual**

Elementë të rëndësishëm të rritjes ekonomike në Shqipëri që në vitin 1997 ka qënë zgjerimi i shpejtë i konsumimit privat nga ana e kërkesës dhe rritja e prespektivës së ndërtimeve. Megjithatë, rritja e ekonomike e vendit dhe konkurrenca vazhdojnë të jenë të kufizuara nga nivelet e ulëta të eksportit dhe investimet private dhe të huaja, qeverisja e dobët dhe pengesat strukturore në sektorët e infrastrukturës.

Në Shqipëri ka shumë pak ndërmarrje të mëdha. Në fakt, sektori i NMVM-ve (që punëson më pak se 80 persona sipas përcaktimit të Institutit Shqiptar të Statistikave)

përbën 99.6 përqind të ndërmarrjeve, 70 përqind të qarkullimit total të ndërmarrjeve private dhe 58 përqind të punësimit të ndërmarrjeve private. Megjithatë, shpërndarja e tyre në klasat sipas përmasave dhe rajoneve është shumë e pabarabartë. Sektori i NMVM-ve karakterizohet nga një aktivitet i ulët eksporti, hyrje të ulëta të IHD-ve dhe zhvillim i ulët zhvillimi të biznesit.

Qeveria shqiptare po zbaton reforma ambicioze për mbështetjen e NMVM-ve dhe duhet të sigurojë një zbatim transparent dhe efektiv. NMVM-të kanë problemin e procedurave gjyqësore të gjata dhe jo transparente, korrupsioni dhe mungesa e infrastrukturës. Shumë pak ndërmjetës financiarë janë përfshirë në huadhënie të qëndrueshme dhe fitimprurëse të NMVM-ve. Megjithëse është prezantuar një regjim taksash i veçantë për ndërmarrjet e vogla, pajtimi me taksat vazhdon të jetë i vështirë. Përfundimisht, nivelet e ulëta profesionale dhe arsimit të punëtorëve shkaktojnë probleme serioze për ndërmarrjet; trainimet varen shumë në mbështetjen e donatorëve, që shkakton riskun e mungesës së qëndrueshmërisë së tërheqjes së interesit të donatorëve.

### **Nevoja e madhe e TAM/BAS**

Në mënyrë që të bëhen konkurrues, bizneseve shqiptare iu nevojitet një ndryshim në pozicionin dhe orientimin e biznesit. Asistenca këshilluese është veçanërisht e rëndësishme në fushat e menaxhimit dhe organizimit të burimeve njerëzore dhe marketing. Donatorë të ndryshëm ndërkombëtarë sigurojnë mbështetje për projektet pilot që synojnë sektorin e NMVM-ve, donatorë të ndryshëm fokusohen në konkurrencën dhe zhvillimin e ndërmarrjeve me raste të ndryshme suksesi. Megjithatë, qëndrueshmëria e këtyre programeve nuk sigurohet derisa të tërhiqet interesi i donatorëve.

Ka gjithmonë një nevojë të vazhdueshme për të përmirësuar mekanizmat e dialogut me sektorin privat. Megjithëse tregu i konsulencave private po rritet, përmirësime të mëtejshme janë të nevojshme në lidhje me sigurimin e informacionit, garancitë cilësore, çmimet dhe disponueshmëria e një niveli të duhur shërbimesh. Në përgjithësi, infrastruktura e mbështetjes së biznesit është e pjesshme dhe mbështetet shumë në përkrahjen e donatorëve.

### **Udhëzime për ndërhyrjet e TAM në të ardhmen**

Bazuar mbi intervista me pronarë lokalë, ka një interes të madh për të vazhduar aktivitetet në Shqipëri në periudhën 2009-2011. Pengesat kryesore që hasen nga NMVM-të, që mund të zgjidhen nga ndihma e programit TAM, lidhen me aftësitë e dobëta organizative dhe drejtuese, planifikimin e biznesit, teknikave të marketingut dhe mangësive në lidhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. TAM duhet të përqëndrohet kryesisht në industrinë e përpunimit të ushqimit, industrinë përpunuese dhe turizëm që janë cilësuar si industritë kryesore me mundësi të larta për zhvillim. Gjithashtu TAM duhet të synojë bashkëpunimin në fushën e riciklimit, shoqërive të ujësjellësit dhe kanalizimeve me vëmendje në çështjet mjedisore dhe identifikimi i shoqërive me mundësi për tu bërë drejtues në qendrën e ndryshimit të biznesit në BE. Shoqëritë që klasifikohen si “të mëdha” dhe NMVM-të që kryejnë projektet e TAM përtej mesatares

së 18 muajve dhe buxhetit mesatar prej 57,500 Euro duhet të paguajnë për shërbimet.

### **Udhëzime për ndërhyrjet e BAS në të ardhmen**

Pronarët në sektorin e sipërmarrjeve besojnë se sipërmarrësit shqiptarë duhet të përfitojnë shumë nga shërbimet e konsulencës për biznes. Përparësia kryesore e BAS është ndihma e tij në krijimin e infrastrukturës së zbatueshme të mbështetjes së biznesit duke vepruar në fushën e kërkesës dhe sigurimit. Granti i dhënë nga BAS duhet të vazhdojë të jetë një pjesë e rëndësishme e asistencës së BAS. Megjithatë, aktivitetet e zhvillimit të tregut të synuar duhet të jenë një pjesë e rëndësishme e asistencës së BAS në Shqipëri.

Një Model Udhëzues për Grante është propozuar në mënyrë për të vendosur një prioritet për aktivitetet për të evituar ndihmën e dyfishtë nga donatorët ndërkombëtarë. Grante më të mëdha duhet ti jepen: ndërmarrjeve më të vogla; ndërmarrjet me vendodhje jashtë kryeqytetit; projekte që synojnë përmirësimin e menaxhimit cilësor, prezantimin e drejtimit të burimeve njerëzore, planifikimin financiar dhe strategjik; projekte në sektorin e agro-përpunimit dhe të turizmit dhe me synimin e përmirësimit të menaxhimit mjedisor.

### **Aktivite të Tjera të Zhvillimit të Tregut**

Rekomandohet që asistencë e TAM/BAS të plotësohet me aktivitetet e mëposhtme të zhvillimit të tregut për të maksimizuar efektin e tranzicionit:

- 1 *Paraqitja dhe përhapja:* Hapa të mëtejshëm për të ndihmuar zbatimin e shërbimeve të konsulencës për biznes. TAM mund të organizojë seminare dhe trajnime që prezantojnë praktikën më të mira ndërkombëtare
- 2 *NMVM dhe trajnimet e konsulencës:* BAS duhet të vazhdojë të zgjidhë mangësitë egzistuese mbi sigurimin e shërbimeve duke organizuar seminare dhe trajnime që mbulojnë teknika të veçanta të industrisë dhe këshilla mbi prodhimin, ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e politikave të Burimeve Njerëzore, ndihmë ndaj shoqërive për përgatitjen e aplikimeve për huatë, dhe rritjen e përdorimit të praktikave më të mira ndërkombëtare dhe dokumentimet/GMS.
- 3 *Mbështetja dhe zhvillimi i institucioneve egzistuese lokale- veçanërisht në lidhje me tregun për shërbimet e konsulencës për bizneset lokale.* Megjithëse siguresit për shërbimet e biznesit janë shtuar në vitet e fundit, vetëm pak prej tyre kanë kapacitetet e për të siguruar shërbimet e specializuara rreth nevojave specifike të ndërmarrjeve. Tregu i lokal i shërbimeve të konsulencës ka nevojë të madhe për ndihmë në mënyrë që të arrijë standartet ndërkombëtare. Megjithatë, krijimi i një Shoqate Konsulentësh duhet të zhvillohet nga njësitë më të vogla për të qënë më i qëndrueshëm. BAS mund të ndihmojë konsulentët në këtë nismë.

Në mënyrë që të zgjidhen çështjet e rëndësishme në lidhje me sektorin e NMVM-ve në Shqipëri, Programi i TAM/BAS duhet të ndihmojë për marrjen e masave për rritjen e efikasitetit të energjisë në prodhim dhe zvogëlimin e ndotjes mjedisore. TAM duhet të fillojë projektet me shoqëritë e sistemit dhe furnizimit me ujë. Ndërsa respektimi i standarteve mjedisore rrit mundësinë e bizneseve për tu bërë pjesë e tregjeve të BE, TAM duhet të nxitë më tej zhvillimin e teknologjisë për mjetet e trajtimit të ujit në fabrikat e

lëkurëve. BAS duhet të nxitë më tej realizimin e planifikimit strategjik afatgjatë dhe zhvillimin duke konsideruar standartet dhe rregullat mjedisore të BE. Megjithatë këto masa do të jenë të suksesshme vetëm nëse sipërmarrësit fillojnë të kuptojnë rëndësinë e pagimit për këto shërbime në të ardhmen dhe të mos veprojnë vetëm nën nxitjen e donatorëve. Gjithashtu, TAM/BAS duhet ti kushtojë vëmendje mbështetjes së sipërmarrëseve femra dhe nxitjen e përfshirjes së grave në pozicionet drejtuese mesatare dhe kryesore veçanërisht në Shqipërinë e veriut të karakterizuar nga relieve malor. Bashkëpunimi me zonat jashtë kryeqytetit duhet të vazhdojë të jetë prioriteti kryesor për TAM/BAS. Sipërmarrjet duhet të mbështeten nëpërmjet programeve praktikuese dhe këshilluese që i sigurojnë studentëve dhe konsulentëve të rinj mundësinë për të bashkëpunuar me konsulentët e BAS ose ekspertët e TAM.

Duke analizuar plotësisht mjedisin e biznesit dhe duke përcaktuar qartë sfidat që përballet sektori i NMVM-ve, ky përshkrim përforcon më tej politikën e dialogut të BERZH. Gjithashtu, janë përcaktuar sfida të tjera me qeverinë (ndërmjet të tjerave) si përmirësimi i zbatimit të ligjit, ulja e pabarazisë së trajtimit dhe korrupsionit administrative, përmirësimin e administrimit të taksave dhe përmirësimin e sistemit arsimor.

Në përputhje me Planin e Strategjisë së TAM/BAS për vitin 2008-2010, TAM/BAS do të vazhdojë të ndihmojë Bankën të arrijë objektivat e saj për krijimin e një programi projektësh të zbatueshme për investime direkte nga Banka që do të jenë ndërmjetës në tre mënyra:

i) duke identifikuar plane të mundshme për projekte (para-investues); ii) duke siguruar shërbime konsulence dhe biznesi për përgatitjen dhe mbështetjen e projekteve të ndërmarrjeve të financuara nga Banka dhe për vetë ndërmarrjet; iii) sigurimi i kandidatëve për pozicionet e naëtarëve jo-ekzekutivë të bordit. Për më tepër, Programi duhet të lidhë NMVM-të që kanë nevojë për financim me institucionet financiare vendase të mbështetura nga Linja e Financimi të NVM nga BE/BERZH dhe nga Linja e Financimit të BERZH-it dhe Qeverisë Italiane për Ndërmarrjet Lokale (LEF). Kjo do të fuqizojë ndikimin e Bankës në sektorin e ndërmarrjeve, siç përcaktohet në Strategjinë e BERZH-it për Shqipërinë.